	KONTROLLI I LARTË I SHTETIT **Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Skrapar**

RAPORT PËRFUNDIMTAR "PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË" TË USHTRUAR NË BASHKINË SKRAPAR

Maj 2020

PËRMBEJTJA	Faqe
Përmbajtja e lëndës dhe shkurtimet	1-1
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE *a. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.* *b.Përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve.* *c. Konkluzioni dhe opinioni i auditimit.*	2-10
II. HYRJA *Objektivat dhe qëllimi.....* *Identifikimi i çështjes.....* *Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....* *Përgjegjësitë e audituesve.....* *Kriteret e vlerësimit.....* *Standardet e auditimit.....*	10-14
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	14
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET (Përmbajtja e punës së kryer) A. Mbi vlerësimin e kontrollit të brendshëm	15-18
B.1. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit	18-22
B.2.Burimi i krijimit të të ardhurave dhe vlerësimi i mbledhjes së tyre	22-31
C. Vlerësimi i Raportimit Financiar (Pasqyrat financiare)	31-46
D.1. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike.	47-80
D.2. Hartimi dhe zbatimi i kontratave të punimeve	80-90
E. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.	90-93
V. Masat për përmirësimin e gjendjes (Rekomandimet)	93-109
VI. ANEKSET	110-149

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë sëFinancave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.

	KONTROLLI I LARTË I SHTETIT **Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Skrapar**

VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standart Ndërkombëtar i Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave të Ndërtimeve Informale.
IT	Teknologjia e Informacionit.
NJA	Njësi Administrative.
SHA	Shoqëri Anonimë.
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.
OE	Operator Ekonomik.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.a. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH", në zbatim të Programit të Auditimit *nr. 1049/1 prot., datë 26.12.2019* miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 26.12.2019 deri më datën 28.02.2020, në Institucionin Bashkia Skrapar u krye auditimi "Financiar dhe i përputhshmërisë". Auditimi mbuloi periudhën prej 01.01.2017 deri më datën 31.12.2019.

Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:
1. B. M., përgjegjës grupi
2. H. A., anëtar grupi
3. G. H., anëtar grupi
4. A. Z., anëtar grupi
5. S. M., anëtar grupi

Auditimi u krye me zgjedhje, mbi bazën e riskut dhe materialitetit.

Fushat mbi të cilat është shtrirë auditimi, sipas programit të auditimit, janë pasqyrat financiare, për të cilat u auditua rregjistrimi i të dhënave dhe mbajtjen e kontabilitetit, saktësia e pasqyrave financiare, aplikimin e parimeve kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe parimet për një qeverisje të mirë në përmbushje të objektivave të institucionit, ngritja dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, vlerësimin e njësisë së auditit të brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, planifikimi për të ardhurat dhe masat e marra për arkëtimin e tyre, zbatimin e kuadrit rregullator në fuqi për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik dhe zbatimin e kontratave të punimeve, zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.
Për këto u analizuan evidencat e marra nga subjekti i audituar, si dhe u përdorën testet e nevojshme si pjesë e procedurës së auditimit.
Për pasqyrat financiare, auditimi u krye për pasqyrat e vitit 2017, 2018 dhe 2019.

Pasqyrat financiare të vitit 2019 deri në datën 28.02.2020, datë në të cilën ka përfunduar puna audituese në teren, nuk kanë përfunduar. Ato i janë dërguar grupit të auditimit me e-mail dhe të skanuara në datën 4 prill 2020.
Për gjetjet e konstatuara nga grupi i auditimit janë mbajtur 20 akte konstatimi dhe një akt verifikim,të cilët janë dorëzuar në protokollin e subjektit të auditimit brenda afatit të periudhës së auditimit.
Nga grupi i auditimit janë shqyrtuar kundërshtitë e bëra nga subjekti i audituar, mbi aktet e konstatimit dhe projektraportin dhe janë marrë në konsideratë ato kundërshti të cilat janë të mbështetura nga ana ligjore, apo është paraqitur dokumentacion shtesë, ndërsa për rastet e tjera të cilat nuk gjejnë argumentim, mangësitë gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, i cili i dërgohet subjektit për njohje dhe marrjen e masave për përmirësimin e gjendjes.
Mbështeturnë punën audituese në teren (subjekt), në evidencat e marra të cilat sipas mendimit tonë kanë qenë të përshtatshme,të mjaftueshme dhe të besueshme për punën audituese, mbështetur në Projektraportin e auditimit, komentet e subjektit të audituar, qëndrimin e grupit të auditimit ndaj komenteve të subjektit, rezultatet kryesore të punës audituese përfshihen në këtë përmbledhje ekzekutive të Raportit Përfundimtar të Auditimit si më poshtë

I.b. Përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve, sipas tabelës së mëposhtme:

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Referenca në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
1	**Gjetje nga auditimi:** Llogaria 215 "Mjete transporti" për vitin 2017 ka vlerën 85,652,568 lekë, për vitin 2018 ka vlerën 36,938,529 lekë dhe për vitin 2019 vlerën 20,145,397 lekë (vlerë neto kontabël). Për periudhën e auditur 2017-2019 kjo llogari nuk pasqyron saktë vlerën e mjeteve të transportit për arsye se në këtë llogari është paraqitur edhe vlera bruto 8,106,500 lekë (vlerë neto 2,178,637 lekë për vitin 2019), që përfaqëson 4 mjete transporti të cilat nuk ekzistojë, nuk ka fletë inventari, nuk ka person përgjegjës material. Këto aktive për vitin 2017 dhe 2018 nuk i janë nënshtruar procesit të inventarizimit. Bazuar në rezultatet e komisionit të inventarizimit për vitin 2019 (detyrë që është kryer gjatë vitit 2020), këto mjete nuk gjenden, nuk ekzistojnë. Gjithashtu nga sektori i aseteve raportohet se njësia vendore ka 16 mjete të transporti të dëmtuara në vlerën historike 33,060,842 lekë, por ky klasifikim është jo argumentues, sepse nuk u paraqit dokumentacion që të vërtetojë se këto mjete i janë nënshtruar vlerësimit të tyre nga komisioni i vlerësimit të aktiveve, i			**<u>Rekomandim</u>:** Kryetari i Bashkisë Skrapar të vlerësoj me komision gjendjen e 16 mjete të transporti të dëmtuara në vlerën historike 33,060,842 lekë dhe pas përfundimit të vlerësimit të përcaktojë listën e mjeteve të dëmtuara. Pas kësaj për mjetet të cilat rezultojnë se nuk mund të rikthehen në gjendje pune për shkak të kostove të larta të riparimit, të vazhdohet me procedurat e mëtejshme të nxjerrjes jashtë përdorimit e shitjen e tyre për skrap. Ky proces të përshpejtohet, me qëllim që të mos mbahen mjete të dëmtuara nën ruajtje, në kushtet kur për to nuk ka vende të posaçme dhe persona përgjegjës për ruajtjen e tyre për 24 orë dhe, në këtë mënyrë mjetet pavarësisht gjendjes që kanë, bëhen objekt i humbjes apo i vjedhjes.Për katër mjetet e transportit të cilat nuk gjenden, pasi të bëhen

	cili ka tagrin e një përcaktimi të tillë. U konstatuan mos rakordime midis gjendjes së aktiveve që disponon në mënyrë shkresore Sektori i Aseteve dhe gjendjes që disponon Nëpunësi Zbatues. Veprimet dhe mos veprimet e mësipërme, përbëjnë mungesë përgjegjësie nga ana e nëpunësit zbatues, përgjegjësit të sektorit të aseteve dhe komisioneve të inventarizimit për vitin 2017 dhe 2018, si dhe janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*", kapitulli II, pika 11, aneksi 1,pika 2/1,Trajtimi kontabël dhe rastet e daljeve të aktiveve afat gjata, germat "e" dhe "f" dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pikat 12, 26, 27, 30, 31,74, 81, 85 *(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 28-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*			zhdëmtimet nga personat përgjegjës (trajtuar më gjerë te rubrika e dëmit ekonomik), të bëhen rregullimet përkatëse në librat kontabël. Regjistri i aseteve të mbahet si nga Sektori i aseteve edhe nga Drejtori ekonomik dhe në mënyrë periodike të rakordohet mes tyre për saktësinë e tij.
2	**Gjetje nga auditimi**: Bazuar në pasqyrat financiare të vitit 2019,në datën 31.12.2019, llogaria 210 "Toka, troje, terrene" ka vlerën 2,843,818 lekë, ndërsa llogaria nr. 211 "Pyje, kullota, plantacione", ka vlerën 6,851,988 lekë. Vlerat e këtyre llogarive nuk pasqyrojnë saktë pasurisë reale të njësisë vendore për shkak se nuk janë të përfshira një numër i konsiderueshëm asetesh të njësisë vendore, të cilat me VKM të posaçme kanë kaluar në pronësi të saj. Njësia vendore nuk ka marrë masa për regjistrimin e këtyre pasurive në ZVRPP dhe mungesa e certifikatave të pronësisë, ka sjellë edhe pamundësinë për pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare. Nga njësia vendore për këto prona nuk është hartuar regjistër i aktiveve, nuk ka një listë përfundimtare se cili është numri i tyre të cilat janë të pa	28-47	E lartë	**<u>Rekomandim</u>:** Titullari i njësisë vendore dhe Drejtori Ekonomik, të marrin masa për sistemimin e llogarisë 210 "Toka, Troje, Terrene*"* dhe llogarisë nr**.** 211 "Pyje, kullota, plantacione, duke bërë që në këto llogari të paraqitet vlera e saktë e pasurisë së njësisë vendore. Të inventarizohen këto prona, duke krijuar regjistrin e aktiveve me të gjitha të dhënat e nevojshme (vendndodhje, sipërfaqja etj.). Të merren masa për regjistrimin e këtyre aseteve në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës.

	regjistruara në ZVRPP. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, neni 15, pika 1 dhe 2, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", kapitulli IV. pika 74 dhe 96 dhe të UMF nr. 8 datë 9.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*" *(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 28-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*			
3	**Gjetje nga auditimi**: Bashkia Skrapar në datën 31.12.2019 ka detyrime të prapambetura për faturat e pa likuiduara në vlerën 42,810 mijë lekë, nga e cila vlera prej 28,092 mijë lekë i përket Bashkisë dhe vlera prej14,718 mijë lekë i përket Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike. Vlera 28,092 mijë lekë (vetëm Bashkia) përbëhet nga detyrime për investime në vlerën 8,005 mijë lekë, detyrime për shërbime në vlerën 471 mijë lekë, për mirëmbajtje në vlerën 2,839 mijë lekë, detyrime të tjera 8,523 mijë lekë, detyrime për vendimet gjyqësore të cilat kanë marrë formën e prerë për vlerën 8,252 mijë lekë. Nga shuma e mësipërme prej 28,092 mijë lekë, vlera prej 17,113 mijë lekë i përket faturave të pa likuiduara (kreditorëve) për periudhën janar 2017-dhjetor 2019. Për vlerën 14,718 mijë lekë, detyrim i prapambetur më 31.12.2019, e cila i përket Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, peshën specifike e zënë detyrimet për energjinë elektrike, në vlerën 9,770 mijë lekë, ose 66% të totalit të të gjithë detyrimeve, nga i cili vlera prej 6,386 mijë lekë është principal, ndërsa vlera prej 6,555 mijë lekë është kamat-vonesë. Ky detyrim i mbartur i përket periudhës	15-19	E larte	**Rekomandim:** Nga Kryetari i Bashkisë Skrapar të analizohet situata e detyrimeve të prapambetura dhe të nxirren përgjegjësitë për këtë situatë. Të mos marren anagazhime te reja buxhetore (shpenzime të reja), pa paguar detyrimet e prapambetura, si dhe në vazhdim të mos krijohen detyrimeve të reja të prapambetura. Kjo të realizohet duke mos marrë angazhime buxhetore, pa pasur fonde në dispozicion në llogarinë e thesarit. Për detyrimet e prapambetura, të hartohet një grafik për likuidimin e tyre, duke zbatuar radhën e pagesave sipas kronologjisë së tyre. Të paraqitet në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara si dhe planin për likuidimin e tyre.

	dy vjeçare 2010-2011 dhe vjen si rezultat i mos kryerjes në kohë të pagesave për 17 kontrata të energjisë elektrike për ndriçimin rrugor të qytetit. Nga auditimi konstatohet se nuk janë marrë të gjitha masat e duhura për likuidimin e detyrimeve të prapambetura. *(Më hollësisht trajtuar në pikën B.1, faqe 15-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*			
4	**Gjetje nga auditimi**: Bashkia Skrapar nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Nuk janë hartuar rregulla për ruajtjen e aktiveve, përfshirë këtu edhe mbrojtjen dhe ruajtjen e të dhënave elektronike (sistem rezervë back-up), rregulla për dorëzimin e detyrës në rastet e largimit të punonjësve nga puna. Pasojë e mungesë së këtyre rregullave shprehet edhe humbjen e katër mjeteve të transportit të pa evidentuar nga Njësia Vendore. Nuk është hartuar lista e proceseve të punës, gjurma e auditimit nga asnjë sektor dhe drejtori. Në fund të çdo viti vlerësimi i funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit nuk është bërë si duhet nga menaxherët kryesor, duke mos përcaktuar pikat e dobëta të këtij sistemi e marrjen e masave për përmirësimin e tij. Nga stafi nuk njihet mjaftueshëm ligji 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", si dhe manuali përkatës në zbatim të këtij ligji. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"dhe nenin32, të ligjit nr. 68/2017" Për financat e vetëqeverisjes vendore"	15-18	E mesme	**Rekomandim:**Titullari i njësisë vendore, njësia e auditit të brendshëm dhe menaxherët kryesor të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësinë vendore. Të hartohen rregulla për ruajtjen e aktiveve, duke përfshirë edhe ruajtjen dhe sigurinë e informacionit elektronik, duke siguruar sisteme rezervë të IT (back-up). Të hartohet gjurma e auditimit dhe lista e proceseve të punës për secilin sektor dhe në nivel institucioni.
5.	**Gjetje nga auditimi**: Nga puna e pa mjaftueshme e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë	19-28	E lartë	**Rekomandimi:** Drejtoria ekonomike, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore,

	Skrapar, në fund të vitit 2019 janë krijuar debitorë për taksat dhe tarifa vendore në vlerën totale **83,543,320 lekë**, e ardhur e munguar për buxhetin e njësisë vendore. Kjo vlerë përbëhet nga: -detyrimi prej 67,619,642 lekë nga debitorët e subjekteve fizik/juridik dhe debitorët familjarë për taksat e tokës bujqësore dhe tarifat familjare, të bashkisë qyteti Çorovodë dhe tetë Njësitë Administrative. -detyrimi prej 15,923,678 lekë nga debitorët e konstatuar nga kontrolle të ndryshme para datës 31.12.2016, të bashkisë qyteti Çorovodë dhe tetë Njësitë Administrative. Nga auditimi konstatohet se njësia vendore nuk ka shifra të qarta dhe përfundimtare për debitorët nga taksat dhe tarifat vendore, pasi këto shifra kanë qënë kontradiktore në fazën e projektraportit dhe të raportit. Gjithashtu nuk administrohet nga njësia vendore një ndarje e qartë midis vlerës së debitorve të taksapaguesve privat dhe atyre familjar, gjë e cila bën që të mos pasqyrohet edhe në këtë gjetje. Mos arkëtimi i plotë i detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, përveçse është mos përmbushje e detyrimeve ligjore, sipas detyrës funksionale të punonjësve të kësaj strukture, krijon mungesa financiare në buxhet dhe për pasojë ulë nivelin e investimeve dhe të shpenzimeve të tjera që njësia vendore ka parashikuar në favor të komunitetit. Mungesa e të ardhurave është ndikim i drejtëpërdrejtë në mosrealizimin e buxhetit në zërin e shpenzimeve për periudhën 2017-2019. Nga Bashkia Skrapar nuk janë ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme ligjore, në rend shterues, për arkëtimin e debitorëve, veprim në kundërshtim me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006			Bashkia Skrapar, bazuar në nenin 70 pika 3 "E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, *për të gjitha subjektet e private* për vlerën e detyrimit 67,619,642 lekë të nxjerrë njoftim vlerësimet tatimore dhe në vazhdim të marren masat për arkëtimin e këtij detyrimi, në bazë të procedurave të përcaktuara nëligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Gjithashtu të marrë masa edh epër arkëtimin e vlerës 15,923,678 lekë nga debitorët e konstatuar nga kontrolle të ndryshme në bashki.

	"Për sistemin e taksave vendore", nenet 91, të ligjit nr. 9920 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe nenin 12 të Udhëzimit te Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore*(Më hollësisht trajtuar në pikën B.2, faqe 22-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*			
6.	**Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit me objekt: "*Blerje kamioni për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, Bashkia Skrapar*", me fond limit 1,250,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më 04.05.2017, kanë marrë pjesë dy operatorë ekonomik:"A. G." SHPK me vlerë të ofertës ekonomike 1,200,000 lekë dhe "Q. 0." SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 1,248,000 lekë. Nga KVO është skualifikuar OE "A. G." SHPK, i cili i plotëson kriteret e vendosura në DST, por me argumentin se nuk ka paraqitur mjetin pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike për vlerësimin e tij fizikisht nga ana e KVO. Kjo detyrë nuk është e KVO dhe ky kriter nuk ka qenë i vendosur në DST. Skualifikimi i padrejtë i OE "A. G." SHPK dhe kualifikimi i OE "Q. 0." SHPK, i cili ka paraqitur dokumente për një mjet të vitit 1977, me vlerë të ofertës ekonomike **1,248,000 lekë**, ka sjellë si pasojë përdorimin e këtyre fondeve publike për një mall i cili nuk është objekti i procedurës së prokurimit publik për të cilën është zhvilluar tenderi. Përveç se këto fonde janë përdorur në paligjshmëri, ato janë fonde të përdorura pa ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet, kjo edhe për faktin e kohës së amortizimit maksimal të mjetit, e cila është pasqyruar edhe në shpenzimet e mirëmbajtjes së tij, të cilat për periudhën 2017-2019 kanë një vlerë prej 574,720 lekë.			Për arsye se fondi limit në vlerën 1,250,000 lekë pa TVSH nga AK është llogaritur për një mjet të vitit të prodhimit 1990 e mbrapa, por në fakt është marrë në dorëzim një mjet i vitit 1977, atëherë nga Kryetari i Bashkisë Skrapar të merren masa për rillogaritjen e fondit limit të mjetit qëështë marrë në dorëzim (si referencë çmimet që jepen nga organet tatimore, doganore, INSTAT, apo operatorë ekonomik të licencuar për tregtimin e mjeteve të transportit). Diferencat që do të rezultojnë tibëhen ngarkim ish Titullarit të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, anëtarëve të KVO dhe të komisionit marrjes në dorëzim të mallit.

c. Konkluzioni dhe opinioni i auditimit.

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion i kundërt për pasqyrat financiare.

Objektivi i audituesve në auditimin financiar është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nëse këto pasqyra janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Skrapar për vitin ushtrimor 2017, 2018 dhe 2019, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyra e flukseve monetare, etj., si dhe shënimet shpjeguese që shoqëronin këto pasqyra.Opinionin e dhënë mbi besueshmërinë e llogarive vjetore e mbështesim në konstatimet se deklaratat e të ardhurave, shpenzimeve, banka, etj., janë përfshirë në pasqyrat financiare. Janë marrë evidenca të mjaftueshme që të mund të japim një opinion.

Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, mbështetur në standardet ISSAI 1700 shprehim një ***opinion të kundërt***[1] *për llogaritë vjetore të vitit 2017, 2018 dhe 2019 të Bashkisë Skrapar duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale dhe të përhapura.*

Baza për dhënien e opinionit për pasqyrat financiare

Opinionin e dhënë për pasqyrat financiare e mbështesim në anomalitë e konstatuara në llogarinë 215 "Mjete transporti", e cila pasqyron edhe vlerën e katër mjeteve të transportit të cilat në fakt nuk ekzistojnë fizikisht. Këto aktive për periudhën 2017-2019 nuk i janë nënshtruar procesit të inventarizimit. Gjithashtu disa pasuri të njësisë vendore, si toka, troje, terrene, pyje, kullota, plantacione, nuk janë inventarizuar dhe nuk janë rregjistruar në ZVRPP (sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës), e si pasojë nuk pasqyrohen në pasqyrat financiare të njësisë vendore për vitin 2019, duke bërë që këto pasqyra të mos paraqesin vlerës e saktë të këtyre asete të njësisë vendore.

Opinion i kundërt për prokurimet publike.

Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur përsa i takon çështjeve të audituara është ose jo në përputhje, në të gjitha aspektet materiale,me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. *Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit*[2]*, mbështetur në standardet ISSAI 4100 shprehim një* ***opinion të kundërt***[3]*për fushën e prokurimevepublike***.**

---

[1] *ISSAI 1700* ***Opinion i kundërt:*** *në një auditim financiar audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar kur ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku,* ***janë materiale dhe të përhapura****, në llogaritë vjetore apo transaksionet e tjera financiare.*

[2] *Objektivi i audituesit është të hartojë dhe kryej ato procedura auditimi që ju japin mundësi të sigurojë evidencën e auditmit e cila duhet të jetë e mjaftueshme, përkatëse dhe e besueshme (****ISSAI 1500, ISA 300).***

[3] *ISAI 4100: Në një auditim përputhshmërie, audituesi duhet të shprehet se deri në çfarë shkalle fusha e audituar është në përputhje me kriteret e vendosura, si dhe duhet të shprehë një* ***opinion të kundërt*** *kur ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku,* ***janë materialedhe të përhapura****në çështjen e audituar.*

Baza për dhënien e opinionit për prokurimet publike

Opinionin e dhënë mbi çështjet prokurimeve publike e mbështesim në konstatimet e mëposhtme:

- Në 17 procedura prokurimi për hartimin e kritereve të veçanta të DST, nuk është mbajtur procesverbali për argumentimin e tyre. Në 13 nga këto procedura, përvec mungesë së mësipërme, kriteret e vendosura nuk janë në përputhshmëri me kuadrin rregullator në fuqi, sepse janë vendosur në mënyrë të pa argumentuar, të pa lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, vlerën dhe natyrën e kontratës.
- Përsa i përket shkallës së përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi, të veprimtarisë së komisionit të vlerësimit të ofertave, në shtatë raste, nuk është bërë anullimi i procedurës së prokurimit publik, pasi asnjë prej operatorëve ekonomik nuk plotëson kriteret e vendosura në DST. Në këto raste janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST, duke u shkelur nga KVO kuadri rregullator në fuqi. Në një rast është kualifikuar dhe shpallur fitues OE i cili nuk plotëson kriteret dhe ka paraqitur një mjet i cili përsa i përket vitit të prodhimit nuk është parashikuar në DST.

Anomalitë e mësipërme klasifikohen si anomali materiale në aspektin cilësor.

Përgjegjësitë e drejtuesve të njësisë vendore

Drejtimi i njësisë vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", me ndryshime dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi. Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e miratuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e audituesve të KLSH mbi auditimin

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojmë bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar, si dhe nëse hartimi i kritereve të DST, vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratave të punimeve janë në përputhshmëri më kriteret e fushës së prokurimeve publike dhe kriteret e kontratave të lidhura. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe fushave të tjera të auditimit dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

II. HYRJA

-Titulli: Ky Raport Përfundimtar Auditimi përmbledh punën e bërë nga grupi i auditimit në teren në Bashkinë Skrapar.

-Marrësi: Raporti Përfundimtar i Auditimi i drejtohet Kryetarit të Bashkisë Skrapar, z. A. M., menaxherëve të tjerë të institucionit, për njohjen dhe vlerësimin e problemeve të konstatuara në këtë auditimim, për marrjen e masave për përmirësimin e gjendjes. Gjithashtu ju drejtohet personave të cilët janë atakuar nëkëtë Raport, për tu rinjohur me problematikën e trajtuar nga grupi i auditimit.

Objektivat dhe qëllimi: Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e pasqyrave financiare janë:

-Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim si; përkatësia, plotësia, saktësia, periudha, klasifikimi, ligjshmëria dhe rregullsia.

-Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës si; ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi.

-Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese si; transaksione, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, klasifikimi dhe kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi.

- Marrja e garancive nëse procedurat e prokurimit publik janë zhvilluar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi, mbi përputhshmërinë e zbatimit të kuadrit rregullator në fuqi në mbledhjen e të ardhurave dhe ekzekutimin e buxhetit.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.

Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar.

Për fushën e prokurimeve qëllimi i auditimit është të kuptohet se deri në cfarë shkalle subjekti zbaton kuadrin rregullator në fuqi, zbulimi i shkallës së devijimeve nga standardet e pranuara dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së ligjshmërisë, me qëllim që për rastet individuale të identifikuara personat përgjegjëstë ngarkohen me përgjegjësi, si dhe të merren masa për parandalimin e shkeljeve në të ardhmen.

Identifikimi i çështjes:

A. Kontrolli i brendshëm

B.1. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit.

B.2. Burimi i krijimit të të ardhurave dhe vlerësimi i mbledhjes së tyre, borxhi tatimor

C. Vlerësimi i Raportimit Financiar (Pasqyrat financiare për vitin 2017 dhe 2018).

D.1. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike.

D.2. Hartimi dhe zbatimi i kontratave të punimeve.

E. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:

Titullarët e njësive publike, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efiçencë, sigurimin, nëpërmjet akteve të brendshme administrative, të zbatimit të rregullave për kontrollin e brendshëm.

Nëpunësi autorizues z. A. M., me detyrë Kryetar i Bashkisë Skrapar dhe *Nëpunësi zbatues* z. N. G., me detyrë përgjegjëse finance, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare

në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Skrapar.

Bazuar në pikën 6 të nenit 34, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*: *"Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore"*.

Sipas neni 91. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: pika 1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës:

a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;

b)vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre;

ç) mbajnë llogaritë,në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.

Neni 65; *"Administrata e njësisë administrative"*, pika 1, *"Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori"*.

Strukturat drejtuese të Bashkisë Skrapar, për problematikat e trajtuara lidhur me çështjet nën auditim për hartimin dhe zbatimin e buxhetit, mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, hartimin e pasqyrave financiare dhe inventarizimin e pasurisë; mbi prokurimet me fonde publike dhe zbatimin e kontratave, mbajnë përgjegjësi në lidhje me mangësitë, në shkelje të dispozitave ligjore të përcaktuara nga ligjet nr. 68/2017 datë 27.04.2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"*; nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*; nr. 9936, datë 26.6.2008, *"Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* dhe të akteve të tjera ligjore e nënligjore në aktivitetin financiar dhe përputhshmërisë. Problematikat dhe përgjegjësitë lidhur me to, të konstatuara gjatë procesit të auditimit, janë evidentuar në akt-konstatimet e mbajtura dhe në këtë Projektraport Auditimi.

<u>Përgjegjësitë e audituesve</u>

Përgjegjësia e audituesve të KLSH-së, është që nëpërmjet auditimit të mund të shprehë një opinionin mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e raportimit të pasqyrave financiare dhe Raportimit Financiar si dhe çështjet që lidhen me zbatimin e procedurave të prokurimit me fonde publike dhe mbi të ardhurat dhe shpenzimet.

Në këtë funksion, auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, sipas INTOSAI.

Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi.

Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe raportimit të shifrave në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi profesional i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesi ka vlerësuar nivelin e kontrollit të brendshëm, me qëllim programimin e procedurave tëtë përshtatshme tëauditimit.
Gjatë kryerjes së auditimit, në mënyrë që të jepet një gjykim sa më profesional, objektiv dhe i pavarur, audituesit e grupit kanë zbatuar parimet e mëposhtme me karakter etik:
Parimin e integritetit
Parimin e pavarësisë
Parimin e objektivitetit
Parimin e shmangies së konfliktit të interesit
Ne besojmë se dështmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme për sigurimin e bazës për opinionin tonë në lidhje me pasqyrat financiare, procedurat e prokurimit publik.

Kriteret e vlerësimit.

Kriter vlerësimi është i gjithë kuadri rregullator në fuqi (baza ligjore, aktet e brendshme të institucionit, kushtet e kontratës etj., me të cilat krahasohet aktiviteti i njësisë vendorer që auditohet) dhe kryesisht:
Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2017 ”Për vetëqeverisjen vendore”; ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” si dhe ligjet e udhëzimet vjetore të Ministrisë së Financave për buxhetin; ligji nr. 147/2015 “Për buxhetin e vitit 2016”;ligji nr. 130/2016, datë 17.12.2016 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2017”; ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar; UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Menaxhimi i aktiveve në njësitë e sektorit publik”,i ndryshuar; etj.
-Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.

Standardet e auditimit

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t.
Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC.
Praktika të mira të fushës si: Manuali iAuditimitFinanciardhetë PërputhshmërisëtëGjykatës Evropianetë adituesve;
Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtaretë Auditimit,ISSAImbiAuditimin e përputhshmërisë", etj.
Manualet e Auditimit Financiar dhe Përputhshmërisë të miratuar nga Kontrollit i Lartë i Shtetit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH-së etj.
Gjatë zhvillimit të auditimit nga grupi u patën parasysh dhe u zbatuan:
-Qasjen e auditimit mbi bazë risku (rreziku), sipas së cilës të gjithë përpjekjet dhe burimet drejtohen në fushat dhe çështjet më të rëndësishme dhe ku vlerësimi i riskut është në nivelet më të larta;
-Përdorimin e gjykimit profesional duke u bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Manualin e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë.
Gjithashtu auditimi është kryer në zbatim të:
LigjiT organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
Rregullores së Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimit administrativ të KLSH-së”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30.06.2015;

-Rregullores "Mbi Procedurat e auditimit në KLSH", miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së.

Procedurat e auditimit.

Përcaktimi i procedurave të auditimit nga grupi i auditimit u bë duke pasur parasysh parimet themelore të auditimit si më poshtë:

Procedurat e auditimit kanë për qëllim të sigurojnë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshmet cilat do të përbëjnë një bazë të arsyeshme për vlerësimet dhe përfundimet e auditimit (ISSAI 300, 3.5.1).

Audituesit përzgjedhin ato procedura auditimi të cilat sipas gjykimit të tyre profesional janë më të përshtatshme në varësi të rrethanave (ISSAI 300, 3.4.5)

Për arsye se në bazë të vlerësimi paraprak sistemi i kontrollit të brendshëm është përcaktuar jo në nivelin e duhur, grupi i auditimit u mbështetet më shumë në procedurat thelbësore dhe më pak në qasjen e mbështetur në sistemin e kontrollit të brendshëm. Siguria e auditimit është marrë nga procedurat thelbësore.

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët,

Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduara) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "jashtë normales", që përbëjnë tregues të parregullsive kontabile. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit (akt-konstatimet, akt-verifikimet dhe letrat e punës), i cili është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur konkluzionet e auditimit. Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara,

u përgatit Projekt Raporti i Auditimit. Nga subjekti i audituar kanë ardhur kundërshtitë lidhur me cështjet e auditimit dhe kato janë trajtuar nga grupi i auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Informacioni i përgjithshëm. Bashkia Skrapar ka nja popullsi rreth 16,900 banorë dhe përfshinë 8njësi administrative. Veprimtaria e njësisë vendore ka një bazë të gjerë ligjore, por ligji kryesor është ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Parimet themelore të vetë qeverisjes vendore janë: veprojnë në bazë të parimit të autonomisë vendore; respektojnë kushtetutën. Aktiviteti, të drejtat dhe detyrat e njësive të VV shpjegohen në këtë ligj.

Objekti i këtij auditimi, është "Auditimi financiar dhe përputhshmërisë".

Qëllimi i auditimit: Vlerësimi nëse aktivitetet dhe informacionet e raportuara në pasqyrat financiare, hartimin dhe zbatimin e buxhetit, prokurimet publike, mbledhjen e të ardhurave, është në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet, dhënia e opinionit, hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes.

Fusha e veprimit: Pasqyrat financiare, prokurimet publike, buxheti, të ardhurat për periudhën 01.01.2017 deri më datën 31.12.2019.

Në përputhje me objektin e auditimit, u auditua mbajtja e kontabilitetit, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullave të institucionit dhe parimeve për një qeverisje të mirë në përmbushje të objektivave të institucionit Bashkia Skrapar dhe ligjit nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Në Bashkinë Skrapar evidenca kontabël, mbahet në mënyrë manuale (Excel) dhe jo me programe të posaçme financiare.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET (Përmbajtja e punës së kryer)

A1.Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe organizimi dhe funksionimi i njësisë së auditit të brendshëm.

U auditua funksionimi i pesë elementëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm: mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, informimi dhe komunikimi, monitorimi. Në përfundim të auditimit arrihet në konkluzionin se nuk është hartuar një paketë e plotë rregullash të shkruara për të siguruar një funksionim të mirë të kontrollit të brendshëm. Mjedisi i kontrollit, si elementi bazë dhe kryesor i kontrollit të brendshëm, nuk është në nivelin e duhur, punonjësit kanë mangësi në njohjen e kërkesave të ligjit 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", nuk janë hartuar programe për të siguruar ruajtjen dhe zhvillimin profesional të stafit. Nuk janë hartuar dokumente si regjistri i rriskut, gjurma e auditimit, rregulla për ruajtjen e aktiveve, nuk ka sistem rezervë për ruajtjen e të dhënave të elektronike (back-up) për njësinë etj.

Titulli i Gjetjes:	Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin pranë Bashkisë Skrapar
Situata:	1-Mjedisi i kontrollit -Bashkia e Skraparit, funksionon mbi bazën e rregullores së brendshme të

miratuar nga Këshilli Bashkiak prej vitit 2015. Aktualisht është duke punuar për hartimin e rregullores së re për organizimin e funksionimin e administratës së bashkisë.

-Në këtë Njësi Qeverisjes Vendore, nuk aplikohen programe elektronike të licencuara lidhur me mbajtjen e kontabilitetit financiar.

Nuk është hartuar gjurma e auditimit dhe lista (harta) e proceseve të punës për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë, në kundërshtim me nenin16, të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010.

Nga njësia e burimeve njerëzore janë kryer vlerësimet periodike vetëm për vitin 2017 ndërsa mungojnë vlerësimet për vitet 2018-2019 për punonjësit të cilët janë me status të nëpunësit civil, lidhur me detyrën që ata kryejnë, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 109, datë 26.2.2014 "Për vlerësimin e rezultateve të punës të nëpunësve civil".

Politika dhe praktika e burimeve njerëzore nuk garanton ruajtjen dhe zhvillimin profesional të stafit, pasi nuk ka programe trajnimi për punonjësit, për të ngritur në vazhdimësi nivelin e tyre profesional.

Për periudhën 2017-2019 kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës tetëmbëdhjetë punonjës, të cilët përpara largimit nuk kanë bërë dorëzimin e detyrës me procesverbal (dorëzimin e dosjeve shkresore, elektronike, pra të gjithë punës së krijuar prej tyre gjatë qëndrimit në institucion). Këto veprime nuk garantojnë ruajtjen e bazës së të dhënave për sektorët përkatës të institucionit, krijojnë vështirësi për vazhdimësinë e punës së kryer dhe transmetimin e saj nga një punonjës te tjetri.

2- Menaxhimi i riskut

Nuk është hartuar regjistri i riskut për institucionin, për asnjë sektor, në kundërshtim me kërkesat e manualit për zbatimin e ligjit të MFK dhe nenit 12 të ligjit 10296 të MFK, i ndryshuar.

3-Veprimtaritë e kontrollit

Veprimtaria e GMS, nuk ka qenë në përputhje me kërkesat ligjore, për arsye se:

-GMS, nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjikë me afat jo më pak se sa 5 vjet, kërkesë e ligjit nr. 68-2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 32 dhe UMF Plotësues nr 8 dt. 29.3.2012 "Procedurat e përgatitjes të Buxhetit afatmesëm", Kap. V.

4- Informacioni dhe komunikimi

Nuk është ngritur një sistem deklarimi efikas, i cili duhet të përfshinte nivelet dhe afatet për deklarimin, llojet e deklaratave që i dorëzohen titullarit nga menaxherët kryesor, shpeshtësia e këtyre raportimeve (për raporte, mujore, tre mujore etj.), në mënyrë që të vlerësohet dhe të mbikëqyret efiçenca dhe efektiviteti i veprimtarive të secilit sektor, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e të nenit 23 të MFK. Nuk ka të përcaktuar me shkrim në detyrat e menaxherve se çfarë raportesh duhet të përgatisë për Titullarin dhe në çfarë intervali kohe duhet të përgatiten.

5-Monitorimi

Monitorimi është kryer nga titullari, nga menaxherët e tjerë kryesor nëpërmjet veprimtarisë së përditshme, nga njësia e auditit të brendshëm nëpërmjet auditiveve, nëpërmjet organizimit të grupeve të punës ose komisionet përkatëse si për marrjen në dorëzim të punimeve të kontraktuara, në rastet e indetifikimit

	të detyrimeve për tatim taksat lokale etj. Por nuk janë vlerësuar si duhet pesë komponentët e MFK në fund të cdo viti, në plotësimin e deklaratës për vlerësimin e cilësisë për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, duke mos e analizuar këtë sistem e duke mos përcaktuar pikat e dobëta të tij. Për sa më sipër mban përgjegjësi ish titullari i AK z. N. S., nëpunësi zbatues z. N. G., përgjegjësi i AB znj. D. S..
Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", nenet 8, 16, 22, 23, 24.
Ndikimi/Efekti:	Mos identifikimi dhe menaxhimi i risqeve, mungesa e rregullave për ruajtjen e aktiveve, për hartimin e raporteve periodike, mungesa e analizimit të cilësisë së funksionimit të sistemit të kontrollit tëbrendshëm, mos trajnimi për rritjen profesionale të stafit si, ndikojnë negativisht në arritjen e objektivave të institucionit, lënë hapësira për ndodhjen e anomalive dhe mos informimin e titullarit për këto anomali (si rasti i mos përfshirjes në procesin e inventarizimit të katër mjeteve për tre vjet), nuk nxjerrin qartë përgjegjësitë etj. Mosfunksionim i sitemit të kontrollit të brendshëm, sjell risk të lartë për institucionin.
Shkaku:	Mosnjohje e plotë e koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" si dhe nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave. Mosnjohje nga niveli i lartë drejtues i kritereve të MFK, me nivel mesatar të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nga Kryetari i Bashkisë Skrapar, të merren masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, hartimin e regjistrit të riskut, dhe miratimin e gjurmëve të auditimit, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

A.2. Vlerësimi i Auditit të Brendshëm.

Njësia e auditimit te brendshëm është e organizuar ne nivel sektori, por realisht ka vetëm një punonjës në këtë njësi, i cili është i paisur me certifikatën e auditit të brendshëm.
Nga njësia e auditimit te brendshëm janë hartuar dhe miratuar për çdo vit ne zbatim te ligjit për auditimin e Brendshëm Planet strategjike dhe vjetore sipas formateve të miratuara.
Për vitin 2017 nga 8 auditime të planifikuara janë realizuar 5 auditime, nga ku janë konstatuar 26 gjetje dhe janë lenë 26 rekomandime.
Për vitin 2018 nga 8 auditime të planifikuara janë realizuar 4 auditime, nga ku janë konstatuar 20 gjetje dhe janë lenë 20 rekomandime.
Për vitin 2019 nga 6 auditime të planifikuara janë realizuar 4 auditime, nga ku janë konstatuar 21 gjetje dhe janë lenë 21 rekomandime.

Titulli i Gjetjes:	Mbi veprimtarinë e Njësisë së Auditit të Brendshëm
Situata:	Në dosjet e auditimit ndodhen konfirmimet e raporteve të bëra nga subjektet e audituara, së bashku me planin e veprimit, në zbatim të rekomandimeve të dhëna nga njësia e auditimit. Në sektorin e Auditimit të Brendshëm, Sigurimi i

	Cilësisë në të gjitha angazhimet e Auditimit të Brendshëm të kryera gjatë periudhës objekt auditimi mungon. Në njësinë vendore Bashkia Skrapar struktura e njësisë së auditimit të brendshëm është miratuar me tre punonjës, por kjo strukturë është e pa plotësuar, pasi aktualisht kryen detyrën e audituesit të brendshëm vetëm një punonjës. Mungesa e plotë e stafit të kësaj strukture ka sjellë si pasojë edhe numrin e ulët të auditimeve, mos mbulimin me auditim të të gjitha fushave kryesore të aktivitetit të njësisë vendore, por edhe mos arritjen e duhur të cilësinë e auditimeve, pasi zbulimet nuk justifikojnë problematikat ekzistuese të konstatuara nga grupi i auditimit. Planifikimi i auditiveve të miratuara nuk është realizuar, pasi nga shtatë auditime të planifikuara (2 auditime financiare, 3 auditime përputhshmërie, 2 auditime të kombinuara) janë realizuar katër prej tyre. Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të vëna në dispozicion rezulton se nuk janë respektuar kërkesat e ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", (ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16.09.2010), Manuali i Auditimit të Brendshëm (MAB), miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr.69, datë 29.09.2010. - Mungojnë, identifikimi dhe vlerësimi i riskut, takimi i përmbyllës, pyetsorët dhe kostoja e auditimit. - Në raportet finale janë dhënë vetëm rekomandime për masa organizative për gjetjet e trajtuara në raport. Sistemi i kontrollit të brendshëm, ngritja dhe funksionimi i tij, të cilat përbëjnë cështjet kryesore për auditin e brendshëm, nuk kanë qenë objekt i programeve të auditit të brendshëm. Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka kryer auditime në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, të tilla si prokurimet publike, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, asetet, etj. Për këtë arsye kjo njësi nuk i ka dhënë mbështetjen e duhur Titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave, pasi planet vjetore nuk janë hartuar bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, veprime në kundërshtim me nenin nr. 5 dhe nr. 6 të ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik". Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi znj.**D. S.**, me detyrë Përgjegjëse e Njësisë së Auditit të Brendshëm.
Kriteri:	Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik". VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik". Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016 "Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik". UMF nr. 28, datë 15.12.2011 "Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm një njësitë publike", të Bashkisë Skrapar.
Ndikimi/Efekti:	Nëse nuk kryhen auditive në fushat me rrisk që ka veprimtaria e njësisë vendore, kjo sjellë mosnjohjen nga auditi dhe titullari të rreziqeve të mundshme që ka në këto fusha, e për pasojë, duke mos i njohur, nuk ka as vëmendje për ti minimizuar këto rrisqe e për ti monitoruar. Rasti konkret është bumbja e 4 mjeteve, fakt i cili ka "fjetur" minimalisht për katër vjet rresht, e cila tregon se nuk ka funksionuar sistemi i kontrollit të brendshëm. Si përfundim titullarit nuk i

	jepet këshillimi i duhur nga ana e auditit të brendshëm, e cila është detyra themelore e këtij të fundit.
Shkaku:	Mungesa e kontrollit të cilësisë së auditimeve të kryera.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	Nga njësia e auditimit të brendshëm të merren masa për planifikimin në programet e auditimit të fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me rrisk të lart, duke i dhenë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave, nëpërmjet rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike.

B.1. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit

- për vitin 2017 planifikimi shpenzimeve ka qenë në vlerën 777,321,289 lekë, realizimi në vlerën 713,094,805 lekë, ose në masën 92%.
- për vitin 2018 planifikimi shpenzimeve ka qenë në vlerën 513,859,822 lekë, realizimi në vlerën 472,225,410 lekë, ose në masën 92%.
- për vitin 2019 planifikimi shpenzimeve ka qenë në vlerën 529,762,261 lekë, realizimi në vlerën 456,011,231 lekë, ose në masën 86%.

Në mënyrë tabelore të dhënat për planifikimin dhe realizimin e buxhetit për secilin zë, për periudhën 2017-2019 jepen nëaneksin nr. 1/1 në fund të projekt raportit.

Titulli i Gjetjes: ***Risqet buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara***

Situata: Në mënyrë të përmbledhur gjendja e detyrimeve të prapambetura për secilin vit buxhetor 2017, 2018 dhe 2019 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tab. B.1 Në lekë

Vlera e kredisë (detyrimit) më 31.12.2016	Shtesa te detyrimit gjatë vitit 2017	Shlyerjet gjatë periudhës 2017	Vlera e kredisë (detyrimit) më 31.12.2017
63,541,789	36,620,908	6,919,099	93,243,598
Vlera e kredisë (detyrimit) më 31.12.2017	Shtesa te detyrimit gjatë vitit 2018	Shlyerjet gjatë periudhës 2018	Vlera e kredisë (detyrimit) më 31.12.2018
93,243,598	10,700,644	36,738,202	67,206,040
Vlera e kredisë (detyrimit) më 31.12.2018	Shtesa te detyrimit gjatë vitit 2019	Shlyerjet gjatë periudhës 2019	Vlera e kredisë (detyrimit) më 31.12.2019
67,206,040	39,616,584	78,885,152	28,092,152

Burimi Bashkia Skrapar

Ndërsa të ardhurat e pa pa përdorura të cilat kanë qenë të disponueshme, por nuk janë përdorur brenda vitit buxhetor, jepen në tabelën e mëposhtme, kolona **Te ardhura te trasheguara**.

Tab. B.1/1 Në lekë

Nr.	**Vitet**	**466**	**Te ardhura te trasheguara**	**Totali**
1	2017	35,228,302	39,658,745	74,887,047
2	2018	33,506,214	10,620,352	44,126,566
3	2019	15,107,782	**39,891,672**	54,999,454
	Shuma:	**83,842,298**	**90,170,769**	**174,013,067**

Vihet re se për vitin 2017 dhe 2018 vlera e detyrimeve është më e ulët se vlera e të ardhurave të trashëguara.

Konstatohet se faturat e pa likuiduara brenda një viti buxhetor, edhe pse kanë qenë të mbuluara me vlerën e të ardhurave të trashëguara për vitin pasues buxhetor, këto fatura nuk janë likuiduar të gjitha në vitin e ardhshëm, që do të thotë se disponibilitetet në thesar në fund të vitit buxhetor, nuk janë përdorur të gjitha në funksion të likuidimit të faturave të prapambetura vjetore, por një pjesë e tyre janë përdorur për buxhetin e ri vjetor. Vlera e detyrimeve të prapambetura për Bashkinë Skrapar, pa përfshirë ndërmarrjen e shërbimeve publike, ka vlerën 26,602,714 lekë, sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela B.2.Në lekë

Emertimi detyrimit	Gjendje detyrime (debi) më 31.12.2018	Shtesa detyrime (Debi) viti 2019	Pagesa (Kredi) viti 2019	Gjendje e detyrimeve (debi) më 31.12.2019
Vendime Gjyqësore	8,119,041	783,300	650,000	8,252,341
Shërbime	363,211	388,537	280,292	471,456
Mirëmbajtje	3,101,455	1,375,935	1,637,821	2,839,568
Investime	49,617,401	30,280,378	71,892,678	8,005,100
Te tjera	6,004,932	6,788,434	4,424,361	8,523,687
TOTALI	67,206,040	39,616,584	78,885,152	28,092,152

Burimi Bashkia Skrapar

Vlera 28,092 mijë lekë (vetëm Bashkia) përbëhet nga detyrime për investime në vlerën 8,005 mijë lekë, detyrime për shërbime në vlerën 471 mijë lekë, për mirëmbajtje në vlerën 2,839 mijë lekë, detyrime të tjera 8,523 mijë lekë, detyrime për vendimet gjyqësore të cilat kanë marrë formën e prerë për vlerën 8,252 mijë lekë. Nga shuma e mësipërme prej 28,092 mijë lekë, vlera prej 17,113 mijë lekë i përket faturave të pa likuiduara (kreditorëve) për periudhën janar 2017-dhjetor 2019.

Vlera e detyrimeve të prapambetura për Bashkinë Skrapar, duke përfshirë edhe ndërmarrjen e shërbimeve publike, ka vlerën 42,810,406 lekë, nga e cila vlera prej 14,718,254 lekë i përket ndërmarrjes së shërbimeve publike, si më poshtë:

Tabela B.3Në lekë

Emertimi detyrimit	Gjendje detyrime (debi) më 31.12.2018	Shtesa detyrime (Debi) viti 2019	Pagesa (Kredi) viti 2019	Gjendje e detyrimeve (debi) më 31.12.2019
Vendime Gjyqesore	156,480	0	0	156,480
Sherbime (Energji)	11,905,223	0	2,135,084	9,770,139
Mirmbajtje	2,329,181	1,207,601	1,406,803	2,129,979
Te tjera	478,000	96,000	574,000	0
Mirëmbajtje periudh -13		497,040	497,040	0
Mirëmbajtje periudh -13		2,661,656		2,661,656
TOTALI	14,868,884	4,462,297	4,612,927	14,718,254

Burimi Bashkia Skrapar

Peshën specifike të detyrimeve të prapambetura për këtë ndërmarrje e zënë detyrimet për energjinë elektrike, në vlerën 9,770,139 lekë, ose 66% të totalit të të gjithë detyrimeve. Ky detyrim i mbartur që nga periudha dy vjeçare 2010-2011 vjen si rezultat i mos kryerjes në kohë të pagesave për 17 kontrata të energjisë elektrike për ndriçimin rrugor të Bashkisë Skrapar. Për shlyerjen e faturave të prapambetura për këto 17 kontrata, midis Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike dhe OSHEE, në datën 29.06.2018

është nënshkruar akt-marrëveshje për shlyerjen me këste të detyrimit të konstatuar në këtë moment prej 12,942,139 lekë, nga i cili vlera prej 6,386,644 lekë është principal, ndërsa vlera prej 6,555,495 është kamat-vonesë. Sipas kësaj akt-marrëveshje vlera e këstit mujor që është përcaktuar dhe vazhdon të shlyhet çdo muaj nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, është 171,257 lekë, nga e cila principal 84,950 lekë dhe 86,308 lekë kamat-vonesë.

Sipas informacionit të dhënë nga përgjegjësi i financës së Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, për të gjitha faturat e ndriçimit rrugor të qytetit, përveç vlerës së energjisë elektrike të konsumuar sipas aparatit matës, për çdo muaj është llogaritur edhe vlera tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televiziv, ndërkohë që ndriçimi rrugor i qytetit nuk ka të instaluar aparat televiziv. Shpenzimi i mësipërm, i pa llogaritur nga kjo ndërmarrje është **efekt negativ në buxhetin e njësisë vendore** dhe në kundërshtim me pikën 8, shkronja "b", pikën 9 të udhëzimit nr. 29, datë 18.12.2014 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televiziv", ku përcaktohet se "institucioni ka detyrimin ti përcjellë kompanisë OSHEE, brenda datës 15 janar të çdo viti, listën emërore të kategorive të përjashtuara nga pagimi i tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televiziv, si dhe gjatë vitit përditësimet përkatëse nëse ka".

Nga auditimi konstatohet se Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike për vitin 2017, midis të tjerash ka kryer shpenzime për mirëmbajtjen e mjetit të transportit tip kamion, me targa AA ... GL të blerë po në këtë vit, për të cilin është lidhur kontrata e blerjes në datën 12.06.2017. Vlera e shpenzimeve të kryera për vitin 2017 për këtë mjet është 186,400 lekë, vlera e shpenzimeve të mirëmbajtjes të kryera në vitin 2018 është 167,040 lekë, ndërsa vlera e shpenzimeve për vitin 2019 është 227,280 lekë. Gjithsej për një periudhë tre vjeçare shpenzimet e mirëmbajtjes për këtë mjet janë 580,720 lekë, të cilat lidhen edhe me faktin e blerjes të një mjeti shumë të vjetër, të vitit 1977, në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në DST për procedurën e prokurimit të zhvilluar në vitin 2017.

Nga rakordimi me degën e thesarit në datën 31.12.2019 konstatohet se detyrimet e prapambetura në këtë datë janë në vlerën 42,155,036 lekë, sipas tabelës së mëposhtme:

Në 000/lekë

Kategoritë								
Investime			Mallra dhe shërbime etj			Vendime gjyqësore	Investime nga FZHR	Totali detyrimeve në 31.12.2019
Pjesa që i përket Grantit Qeveritar	Pjesa që i përket të ardhurave	Detyrimi total për investimet	Pjesa që i përket Grantit Qeveritar	Pjesa që i përket të ardhurave	Detyrimi total për mallra	Detyrimi total		
Bashkia	6,510	6,510		11,835	11,834	8,252	1,495	28,092
Ndërmarrja e shërbimeve publike				14,561	14,561	156		14,718
	6,510	6,510	0	26,396	26,396	8,408	1,495	42,810

Burimi Bashkia Skrapar

Sipas shkresës nr. 331, datë 29.01.2020 me lëndë "Dërgojmë raportin periodik për detyrimet e prapambetura, vlera e raportuar e këtyre detyrimeve është 40,659,107 lekë. Ka një diferencë midis këtyre vlerave për arsye se raporti në MF është bërë përpara kryerjes së rakordimit përfundimtar me thesarin dhe nuk përfshihen disa fatura në të.

Bashkia Skrapar në 31.12.2019 ka një vlerë të faturave të pa likuiduara prej 42,810 mijë lekë, nga e cila vlera 28,092 mijë lekë i përket Bashkisë, ndërsa vlera 14,718 mijë lekë

	Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike. Të dhënat për faturat e pa likuiduara jepen në aneksin nr.1/4 në fund të këtij projektraporti. Konstatohet se nga njësia vendore nuk janë parashikuar dhe arkëtuar të ardhurat të cilat burojnë nga pika ç) e nenit 25 -Të ardhurat nga taksat e ndara, të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ku përcaktohet se "Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin një përqindje nga taksat ose tatimet kombëtare që realizohen në juridiksionin e tyre, sipas përcaktimeve të këtij neni. Ato marrin 2 për qind e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale".
Kriteri:	Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 50 - Angazhimet buxhetore, nenin 52 -Kryerja e shpenzimeve, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 10.01.2018, "Për buxhetin e vitit 2018", pikat 82-91 – Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, VKM 914 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 70. Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" nenet 2, 3, 6, 9, 10,15,15, 27, 32, 52. Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, neni 9 pika 1.3 germa "c" dhe "ç". Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore''*, nenet 2 dhe 3 pika 3. Udhëzimin e Ministrisë së Financës nr. 2, datë 06.02.2012 *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".*
Ndikimi	Mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet rrisk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.
Shkaku:	Mos zbatim i kërkesve ligjore për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim	Njësia vendore të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja të prapambetura dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve totale të prapambetura, duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim

Titulli i Gjetjes:	***Efektet negative në buxhet si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore***
Situata:	1. Për vendimet gjyqësore me objekt dëmshpërblim për largime nga puna të punonjësve, për periudhën 2017-2019, Bashkia Skrapar ka pasur si detyrim për likuidimi 16 vendime gjyqësore, në vlerën totale 4,999,784 lekë. Nga vlera e mësipërme vlera prej 2,472,840 lekë është likuiduar për periudhën 2017-2019, e cila konsiderohet efekt financiar negativ në buxhetin e njësisë vendore (për vitin 2017 është likuiduar vlera 988,480 lekë, për vitin 2018 vlera 1,009,360 lekë, për vitin 2019 vlera 475,000 lekë). Mbetet për likuidim në periudhën e ardhshme buxhetore vlera prej 2,526,944 lekë. Pagesat e kryera për zbatimin e vendimeve gjyqësore për largimet e pa drejta nga puna për periudhën 2017-2019, sipas aneksit 1/2 në fund të raporit të auditimit. 2. Gjithashtu për vendimet gjyqësore me objekte të tjera të ndryshme, Bashkia Skrapar ka pasur si detyrim për likuidimi 10 vendime gjyqësore në vlerën totale11,255,545 lekë, nga e cila vlera prej 4,095,068 lekë është likujduar për periudhën 2017-2019, e cila

	konsiderohet efekt financiar negativ në buxhetin e njësisë vendore. Mbetet për likuidim në periudhën e ardhshme buxhetore vlera prej5,725,397 lekë. Të gjitha këto vendime gjyqësore kanë dalë në periudhën e viteve 2001-2006 dhe paraqiten në aneksin nr. 1/3 në fund të raporit të auditimit. Si përfundim, efekti financiar negativ në buxhetin e njësisë vendore, si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore, pavarësisht natyrës së tyre, ka vlerën 6,567,908 lekë. Konstatohet se përpara zbatimit të vendimit gjyqësor, nga titullari i njësisë vendore nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative dhe nuk është nxjerrë akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi, në kundërshtim me kërkesat e
Kriteri:	Pika nr.62, e udhëzimin nr. 2, datë 06.02. 2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".
Ndikimi	Proceset gjyqësore dhe humbja e çështjes së tyre nga njësia vendore, krijojnë efekte negative në buxhet.
Shkaku:	Mos zbatimi i kritereve ligjore në procesin e largimeve nga puna të punonjësve.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandim	Titullar i njësisë vendore të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore, të nxjerr arsyet dhe përgjegjësitë për humbjen e tyre dhe efektin negativ që këto vendime kanë dhënë në buxhetin e njësisë vendore. Drejtoria juridik të ndjek proceset në të gjitha shkallët e gjykimit, duke bërë edhe rekurs. Në rastet e largimeve të punonjësve nga puna, nga sektori juridik dhe titullari të zbatohen të gjitha procedurat e nevojshme të afateve të njoftimit

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme lidhur me problemet në hartimin dhe zbatimin e buxhetit ngarkohen me përgjegjësi *z.N. S., me detyrë ish kryetar i bashkisë, në cilësinë e nëpunësit autorizues, z. N. G., me detyrë drejtor ekonomik, në cilësinë e nëpunësit zbatues, V. N., me detyrë përgjegjës i financës për Ndërmarrjen e Sherbimev Publike.*

B.2.Burimi i krijimit të të ardhurave dhe vlerësimi i mbledhjes së tyre

1.Programimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore.

1.Titulli Gjetjes

Drejtoria ekonomike, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Skrapar, nuk ka bërë të mundur realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore sipas planifikimit të bërë, duke krijuar debitorë të kategorisë së taksapaguesve privat për 80 subjekte të biznesit të madh e të vogël si dhe debitorë të kategorisë së taksapaguesve familjar për 5076 familje, gjendje më 31.12.2019 në vlerën 67,619,642 lekë. Gjithashtu nuk janë arkëtuar detyrimet prej 15,923,678 lekë debitorë të ndryshëm nga akt kontrollet e lëna në Bashkinë Skrapar.

Situata:

Për vitin 2017, programimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendorë, është miratuar në vlerën 115,000 mijë lekë, realizuar në fakt në vlerën 100,057 mijë lekë me mosrealizim në vlerën 14,943 mijë lekë, ose 87%. Për vitin 2018, programimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendorë, është miratuar në vlerën 100,000 mijë lekë, realizuar në fakt në vlerën 73,335 mijë lekë me mosrealizim në vlerën 26,665 mijë lekë, ose 73%. Për vitin 2019, programimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendorë, është miratuar në vlerën 170,577 mijë lekë, realizuar në fakt në vlerën 74,826 mijë lekë me mosrealizim në vlerën 32,751 mijë lekë, ose 70%. Tabela e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave pasqyrohet në aneksin nr.2 dhe nr.2/1 në fund të raportit.

Konstatohet se numri i bizneseve në total është në rritje, për vitin 2018 dhe vitin 2019 janë regjistruar 18 biznese të reja, kurse për vitin 2017 dhe vitin 2019 kanë mbyllur aktivitetin gjithsej 7 biznese. Për vitin 2017, ndikim negativ në mos realizimin e të ardhurave nga taksat lokale, ka mos realizimi i të ardhurave nga taksa mbi tokën bujqësore, e cila është programuar në masën 7,722 mijë lekë, realizuar në masën 5,355 mijë lekë ose 69%. Mosrealizimi ndaj totalit është në masën 2,367 mijë lekë, me ndikim në mosrealizim në masën 2,4%. -Ndikim negativ në mos realizimin e të ardhurave nga tarifat lokale, ka mos realizimi i të ardhurave nga tarifa e pastrimit, ndricimi, gjelbërimit të cilat janë realizuar respektivisht në masën 86%, 82% dhe 61%. Për vitin 2018, ndikim negativ në mos realizimin e të ardhurave nga tarifat lokale, ka mos realizimi i të ardhurave nga të ardhurat nga tarifat e Ndërmarrjes Pyjore, e cila është programuar në masën 46,952 mijë lekë, realizuar në masën 16,948 mijë lekë ose 36%. Mosrealizimi ndaj totalit është në masën 30,004 mijë lekë, me ndikim në mosrealizim 40,9%. Për vitin 2019, ndikim negativ në mos realizimin e të ardhurave nga tarifat lokale, ka mos realizimi i të ardhurave nga të ardhurat nga tarifat e Ndërmarrjes Pyjore, e cila është programuar në masën 52,040 mijë lekë, realizuar në masën 31,792 mijë lekë ose 61%. Mosrealizimi ndaj totalit është në masën 20,248 mijë lekë, me ndikim në mosrealizim 27%.

Në lidhje me gjendjen e debitorëve për taksat vendore, në numër dhe vlerës, sipas bizneseve, taksës tokës, taksat e popullatës, etj, kontratat për shfrytëzimin e sipërfaqes dhënë sipas Lejeve Minerare, apo Lejeve Koncesionare për pasurinë në administrim të tyre, rezulton se gjendja e debitorëve për periudhën 2017 -2019, paraqitet sipas listës analitike e cila u printua nga ana e grupit të auditivit dhe nga zyra e taksave dhe tarifave vendore janë mbajtur në format exsel. Kjo listë paraqitet në aneksin nr.2/5, nr.2/6 dhe 2/7 në fund të raportit të auditimit.

Nga të dhënat e pasqyrës, konstatohet se niveli i debitorëve në numër dhe në vlerë paraqitet pothuajse me ndryshime shumë të vogla. Në vitin 2017 nga 244 subjekte aktive gjendje në fund të vitit, janë debitorë 58 subjekte ose 24%. Në vitin 2018 nga 257 subjekte aktive gjendje në fund të vitit, janë debitorë 72 subjekte ose 28%. Në vitin 2019 nga 256 subjekte aktive gjendje në fund të vitit, janë debitorë 80 subjekte ose 31%. Të dhënat e mësipërme flasin për një performancë jo të mirë të nivelit të arkëtimeve nga Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Skrapar.

Totali i detyrimeve debitore nga taksat dhe tarifat vendore të bizneseve, të familjarëve dhe të akt kontrolllleve të ndryshme gjendje me 31.12.2017 janë në vlerën 77,506,800 lekë, me 31.12.2018 janë në vlerën 74,650,606 lekë dhe me 31.12.2019 janë në vlerën 83,543,320 lekë, sipas të dhënave të Njësive Administrative në aneksin bashkangjitur.

Për vjeljen e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, nga bizneset, nga ana e sektorit të taksave dhe tarifave vendore, u janë bërë njoftim subjekteve dhe më pas janë dërguar shkresa për bllokimin e llogarive bankare, për sekuestro të mjeteve të transportit pranë Drejtorisë së Kontrollit dhe Shfrytëzimit të Automjeteve, ZRPP/ASHK për vendosjen e barrës së pasurisë dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Për vjeljen e detyrimeve debitore, nuk është vazhduar më tej për kërkimin e masave të tjera shtrënguese si bllokimi i aktivitetit të biznesit deri në sekuestron e mallrave të debitorëve deri në kallëzim penal.

Nga përpunimi i të dhënave të vëna në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Skrapar në lidhje me zbatimin e procedurave për arkëtimin e detyrimeve nga taksat/ tarifat vendore, konstatohet se vlera totale e debisë (borxhit tatimor) në fund të periudhës së vitit 2019 paraqitet prej 83,543,320 lekë, e cila përbëhet

nga:
-detyrimi prej 67,619,642 lekë nga debitorët e subjekteve fizik/juridik dhe debitorët familjarë për taksat e tokës bujqësore dhe tarifat familjare, të bashkisë qyteti Çorovodë dhe tetë Njësitë Administrative.
-detyrimi prej 15,923,678 lekë nga debitorët e konstatuar nga kontrolle të ndryshme para datës 31.12.2016, të bashkisë qyteti Çorovodë dhe tetë Njësitë Administrative.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme lidhur me taksat dhe tarifat vendore, ngarkohen me përgjegjësi:
z.S. A. me detyrë, Përgjegjës Sektori i Taksave/Tarifave vendore periudha 2017-2019.
znj.I. O. me detyrë, Inspektore e të ardhurave, periudha 2017-2019.
znj. B. C. me detyrë, punonjëse taksave/ndihma ekonomike, NjA Qendër,2017-2019.
z.N. K. me detyrë, punonjës taksave/ndihma ekonomike, NjA Bogovë,2017-2019.
z.N. D. me detyrë, punonjës taksave/ndihma ekonomike, Nj A Vëndreshë,2017-2019.
znj.F. B. me detyrë, punonjës taksave/ndihma ekon, NjA Çepan, 2017-2019.
znj.F. C. me detyrë, punonjës taksave/ndihma ekonomike, NjA Potom, 2017-2019.
znj.L. B. me detyrë, punonjës taksave/financiere, NjA Leshnjë, 2017-2019.
z.F. C. me detyrë, punonjës taksa/ndihmës ekonomike, NjA Gjerbës, 2017-2019.
z.T. S. me detyrë, punonjës taksa/ndihma ekon. NjA Zhepë, 03.10-31.12.2019.
z.B. D. me detyrë, punonjës taksave larguar nga puna më 30.08.2019.
z.F. M. me detyrë, punonjës taksave, larguar nga puna 03.10.2019.

Kriteri Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për Sistemin e Taksave Vendore*", i ndryshuar; ligji nr. 68-2017 "*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*"; ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, kreu XI-*"Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara",* të neneve 88 deri 104.

Ndikimi/ Efekti Mos pasqyrim i drejtë i situatës financiare të Bashkisë Skrapar, mangësi në realizimin e të ardhurave të programuara sipas paketës fiskale dhe rrjedhimisht mos përmbushje e programeve buxhetore në lidhje me realizimin e tyre, duke mos ofruar të gjitha shërbimet e nevojshme për popullatën. Akumulim i borxheve dhe rrjedhimisht pamundësi për të programuar në mënyrë të qartë dhe të realizueshme shpenzimet e buxhetit.

Shkaku -Moszbatim i neneve 88-104 , mos ndjekja dhe mos arkëtimi i detyrimeve të debitorëve nga Drejtoria ekonomike, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore.

Rëndësia: -E lartë.

Rekomandim -Drejtoria ekonomike, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Skrapar, të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e detyrimeve të taksapaguesve privat dhe familjar.

2. Programimi i pa studiuar i të ardhurave nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme.

2.Titulli Gjetjes Ndryshim i vlerës totale të të ardhurave nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme, pa dhen argumente konkrete nëse ka ndryshuar sipërfaqja e pasurisë që taksohet.

Situata: Bazuar në të dhënat e marra nga Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Skrapar dhe sipas të dhënave të zyrës së Kadastrës të Bashkisë, sipërfaqja e tokës bujqësore gjithsej është 11,715 ha dhe kanë përfituar tokë sipas ligjit "Për tokën", 5801 familje. Planifikimi i të ardhurve nga taksa mbi pasurinë, si taksa mbi ndërtesat, taksa mbi truallin dhe taksa mbi tokën bujqësore, është bërë jo në përputhje me sipërfaqen e tokës bujqësore për çdo vit dhe numrin e familjeve për ndërtesat e konkretisht:

Emërtimi	Programuar në vitin	Programuar në vitin	Programuar në vitin

	2017 në lekë	2018 në lekë	2019 në lekë.
Taksa mbi Pasurinë e paluajtshme	13,069,000	9,198,000	10,035,000
Diferenca me vitin 2017	0	-3,871,000	-3,034,000

Planifikimi për taksën mbi pasurinë për vitin 2017 është në vlerën 13,069,000 lekë, kurse për vitin 2018 është në vlerën 9,198,000 lekë dhe për vitin 2019 është në vlerën 10,035,000 lekë. Konstatohet se krahasuar me vitin 2017, planifikimi i të ardhurave nga taksa mbi pasurinë është e ndryshme nga viti në vit e konkretisht, për vitin 2018 është më pak për shumën 3,871,000 lekë, për vitin 2019 më pak për shumën 3,034,000 lekë. Nuk ka arsye dhe shpjegime konkrete nga njësia vendore për uljen e planifikimit për taksën e mësipërme. Në total për 2 vitet 2018 dhe 2019 është planifikuar është më pak vlera 6,905,000 lekë,e ardhur e pa planifikuarnë buxhetin e bashkisë Skrapar. Gjithashtu nuk janë parashikuar dhe arkëtuar të ardhurat të cilat e kanë burimin nga 2 përqindëshi i të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale, që realizohen në juridiksionin e njësisë vendore. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme lidhur me taksat dhe tarifat vendore, ngarkohen me përgjegjësi:

z.S. A. me detyrë, Përgjegjës Sektori i Taksave/Tarifave vendore periudha 2017-2019.

Kriteri Ligji nr. 68/2017, datë 27.4.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar, neni 4 dhe 35, Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.1, datë 21.01.2016 "Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2016", i ndryshuar me nr.5, datë 29.08.2016, me nr.82, datë 27.2.2016, me nr.76, datë 21.12.2017 dhe nr.63, datë 28.06.2018, të Bashkisë Skrapar.

Ndikimi/Efekti Ulje e nivelit të planifikimit të të ardhurave, pa argumente dhe llogaritje konkrete.

Shkaku - Moszbatim i paketës fiskale, për programim real të të ardhurave, nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, për taksën e pasurisë.

Rëndësia: -E mesme.

Rekomandimi Titullari i njësisë vendore të analizojë situatën dhe të përcaktoj shkaqet e diferencave në planifikimin e taksës mbi pasurinë për vitin 2018 dhe 2019. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për një planifikim të saktë të taksës mbi pasurinë (taksa mbi ndërtesën, taksa mbi truallin dhe taksa mbi tokën bujqësore), bazuar në të dhënat konkrete zyrtare, për tokën bujqësore, tokën truall dhe sipërfaqen e ndërtesës. Nëse ulja në planifikimin e këtyre të ardhurave nuk ka ardhur si rezultat i uljes së sipërfaqeve të pasurive mbi të cilat llogaritet taksa, por si rezultat i parregullsive të sektorit të taksave, të korigjohen diferencat e krijuara dhe të pa llogaritura për këtë taksë, duke evidentuar taksapaguesit privat dhe familjar, të cilët janë lënë pa taksuar

3. Programimi, realizimi i të ardhurave, nga taksimi i subjekteve të ndërtimit që operojnë në fushën e përpunimit të gurit dhe mermerit.

3.Titulli Gjetjes KLSH konstatoj se nga Bashkia Skrapar, Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk është aplikuar ngarkesa për taksën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, për tarifën e gjelbërimit dhe tarifën e ndriçimit, duke rezultuar me të ardhura të munguara në vlerën**1,610,000 lekë**për periudhën 2017-2019.

Situata: Bazuar në dokumentacionin e marrë nga Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Skrapar për programimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për subjektet juridike e kryesisht për subjektet e ndërtimit të cilat ushtrojnë aktivitet në përpunimin e gurit e të mermerit të cilat paraqiten në aneksin nr. 2/2, nr.2/3 dhe 2/4 në fund të raporit të auditimit. Nga auditimi i 20 subjekte, për ngarkesën e taksave/tarifave vendore e

kryesisht për taksën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, për tarifën e gjelbërimit dhe tarifën e ndriçimit konstatohet se, për vitin 2017 nga 20 subjekte të verifikuara u konstatuan me probleme 10 subjekte të cila nuk janë ngarkuar me detyrime për taksën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, të tarifës së gjelbërimit dhe tarifën e ndriçimit, për vitin 2018 u konstatuan me probleme 3 subjekte dhe për vitin 2019 u konstatuan me probleme 7 subjekte. Referuar dokumentacionit për programimin e të ardhurave nga taksimi i subjekteve të ndërtimit që operojnë në fushën e përpunimit të gurit dhe mermerit në Malin e Tomorit, konstatohet se nuk është aplikuar ngarkesa për taksën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, për tarifën e gjelbërimit dhe tarifën e ndriçimit, për periudhën e viteve 2017-2019, sipas aneksit bashkangjitur, për 10 subjekte në vlerën 1,610,000 lekë, e ardhur e paplanifikuar dhe munguar me dëm në buxhetin e bashkisë Skrapar. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme lidhur me taksat dhe tarifat vendore, ngarkohen me përgjegjësi:
z.S. A. me detyrë, Përgjegjës Sektori i Taksave/Tarifave vendore periudha 2017-2019.

Kriteri Ligji nr. 68/2017, datë 27.4.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar neni 4 dhe 35, VKB nr.1, datë 21.01.2016 "Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2016", i ndryshuar, të Bashkisë Skrapar.

Ndikimi/ Efekti -Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve.

Shkaku -Mos zbatimi i kërkesave ligjore, mos realizim i të ardhurave dhe mos realizim i kryerjes së shërbimeve për komunitetin.

Rëndësia: -E mesme.

Rekomandim Nga titullari i njësisë vendore, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren të gjitha masat e duhura ligjore, duke përfshirë edhe hapjen e proceseve gjyqësore, për arkëtimin e detyrimit në vlerën prej **1,610,000 lekë,** sipas listës së lënë nga KLSH në fund të projektraporit.

4. Programimi, realizimi i të ardhurave, nga taksimi i subjekteve të ndërtimit të cilat janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit me fonde publike.

4.Titulli Gjetjes KLSH konstatoj se,nga Bashkia Skrapar, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk është vepruar për të aplikuar dhe arkëtuar tarifën e pastrimit, të ndriçimit dhe tarifën e gjelbërimit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë, rezultuar me të ardhura të munguara, të paplanifikuara në buxhetin e bashkisë në vlerën **282,246 lekë.**

Situata: Në territorin e Bashkisë Skrapar janë kryer punime ndërtimi nga 19 subjekte të ndërtimit, të cilat janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit me fonde publike. Bazuar në evidencën e prokurimeve ku subjektet që janë kualifikuar si oferta e vlefshme dhe kanë lidhur kontrata për kryerjen e punimeve në territorin e Bashkisë për periudhën e viteve 2017-2019, u konstatua se subjektet e ndërtimit nuk janë ngarkuar me detyrime për tarifën e pastrimit, tarifën e ndriçimit dhe tarifën e gjelbërimit, në vlerën totale prej **282,246 lekë**, e ardhur e paplanifikuar dhe munguar me dëm në buxhetin e bashkisë Skrapar dhe paraqitet në aneksin nr. 2/10 në fund të raporit të auditimit. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme lidhur me taksat dhe tarifat vendore, ngarkohen me përgjegjësi: z.S. A. me detyrë, Përgjegjës Sektori i Taksave/Tarifave vendore periudha 2017-2019.

Kriteri Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Kreut VII,

	nenit 35, dhe Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.1, datë 21.01.2016 "Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2016", i ndryshuar.
Ndikimi/ Efekti	-Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve.
Shkaku	-Mos zbatimi i kërkesave ligjore, mos realizim i të ardhurave dhe mos realizim i kryerjes së shërbimeve për komunitetin.
Rëndësia:	-E ulët.
Rekomandim	Nga titullari i njësisë vendore, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren të gjitha masat e duhura ligjore, për arkëtimin e detyrimit në vlerën **282,246 lekë,** sipas listës së lënë nga KLSH në fund të raporit të auditimit.

5. Programimi dhe realizimi i të ardhurave të institucionit, nga dhënia me qira e aseteve.

5.Titulli Gjetjes	KLSH konstatoj se,nga bashkia Skrapar, Ndërmarrja e Shërbimit Pyjor, nuk janë marrë masa për të lidhur kontratë qiraje me subjektet private për sipërfaqen pyjore prej 958.43 ha, në afatet kohore sipas lejes minerale 6-10 vjet, ku për gjithë sipërfaqen që ato kanë në përdorim, rezulton me mungesë të ardhurash në buxhetin e njësisë vendore në vlerën **889,715,200 lekë.**
Situata:	Në territorin e Bashkisë Skrapar ushtrojnë aktivitet privat disa subjekte të pajisura me leje minerare nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe subjekte të cilat nuk kanë lidhur kontratë qiraje për sipërfaqet pyjore dhe kullosore, por që i shfrytëzojnë këto pasuri për qëllime biznesi. Bazuar në informacionin e marrë nga Ndërmarrja e Shërbimit Pyjor Bashkia Skrapar, për statusin e aktivitetit në terren të subjekteve private që operojnë në territorin e bashkisë Skrapar, konstatohet se, për periudhën e viteve 2017-2019, janë gjithsej 20 subjekte që ushtrojnë aktivitet në fushën e nxjerrjes dhe të përpunimit të gurit gëlqeror dhe të mermerizuar në pronat e bashkisë, nga të cilat janë me status aktiv që punojnë në terren 18 subjekte, kurse dy subjekte janë më status pasiv. Nga 18 subjekte me status aktiv në terren, një subjekt dhe kryesisht subjekti "F." shpk ushtron aktivitetin në pronë private, kurse 9 subjekte ushtrojnë aktivitetin rregullish për gjithë periudhën objekt auditimi, për vitet 2017-2019, kurse 8 subjekte kanë ushtruar aktivitet për dy vite 2017 dhe 2018, pasi për vitin 2019 janë pezulluar me VKM nr. 467, datë 26.7.2018 "Për zgjerimin e sipërfaqes së parkut kombëtar "Mali i Tomorit". Nga bashkia Skrapar, nuk është vepruar, për të lidhur kontratë qiraje me subjektet private të cilat janë pajisur me leje minerare të miratuara nga MEI, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore me sipërfaqe totale prej 864 ha, ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi, për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë) me afat 6-10 vjet ku tarifa vjetore është 440,000 lekë/ha/vit në territor tokë Inproduktive, të trajtuara në aneksin nr.1,bashkangjitur, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Skrapar, në vlerën 806,616,800 lekë. Gjithashtu në zonën "Rasa e Novajve" Mali i Tomorit, Bashkia Skrapar, kanë ushtruar aktivitet, 10 subjekte private, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore për nxjerrje guri pllakë, gurë gëlqerorë, gëlqeror mermer dhe gëlqerorë masiv, sipas lejeve minerare të miratuara nga MEI. Nga Ndërmarrja e Shërbimit Pyjor nuk është vepruar për të lidhur kontrata qiraje për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore me sipërfaqe totale prej 94,43 ha, ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi, të trajtuara në aneksin

nr.2,bashkangjitur, për periudhën e viteve 2017-2018, pasi për vitin 2019 territori që shfrytëzohej nga këto subjekte është miratuar zonë e mbrojtur me VKM nr.467, datë 26.07.2018 "Për zgjerimin e sipërfaqes së parkut kombëtar "Mali i Tomorit", të clat rezultojnë me të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Skrapar, në vlerën 83,098,400 lekë.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që, Bashkia Skrapar, nga mungesa e nënëshkrimit të kontratave të qirasë të fondit pyjor, transferuar me VKM nr.433, datë 8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive", pika 6, shtojca me nr.4, u konstatua se kanë ushtruar aktivitet, në territorin e bashkisë Skrapar, 17 subjekte private, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore për nxjerrje guri pllakë, gurë gëlqerorë, gëlqeror mermer dhe gëlqerorë masiv, referuar lejeve minerare të miratuara nga MEI, nuk është vepruar, për të lidhur kontratë qiraje me subjektet private për sipërfaqen totale prej 958,43 ha, detyrimi përllogaritet në vlerën 889,715,200 lekë, për 17 subjekte, mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë, sipas aneksit nr.2/11 në fund të raporit të auditimit.

Kriteri -VKM nr 391, datë 21.06.2006, i ndryshuar "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", lidhja nr. 2, pika 6/1.

Ndikimi/ Efekti -Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve.

Shkaku -Mos zbatimi i kërkesave ligjore, mos realizim i të ardhurave dhe mos realizim i kryerjes së shërbimeve për komunitetin.

Rëndësia: -E mesme.

Rekomandim Titullari i Njësisë Vendore, Drejtoria Juridike dhe Ndërmarrja e Shërbimit Pyjor, të marrin të gjitha masat e nevojshme ligjore, deri në hapjen e proceseve gjyqësore, për lidhjen e kontratave të qirasë dhe arkëtimin e detyrimit prej 889,715,200 lekë (*periudha 01.01.2017 – 31.12.2019)*, nga 17 subjektet private, sipas listës së lënë nga KLSH në fund të këtij raporti.

6. Programimi, realizimi i të ardhurave, nga dhënia me qira e fondit pyjor e kullosor, subjekteve të ndërtimit që operojnë në fushën e ndërtimit të HEC-ve.

6.Titulli Gjetjes KLSH konstatoj se,nga Ndërmarrja e Shërbimit Pyjor të Bashkisë Skrapar, nuk janë aplikuar saktë tarifat e përdorimit të fondit pyjor e kullosor, lekë/ha/vit dhe lekë/km/vit, rezultuar me të ardhura të munguara, të paplanifikuara me dëm në buxhetin e bashkisë në vlerën **722,110 lekë**për pesë subjekte.

Situata: Në territorin e Bashkisë Skrapar ushtrojnë aktivitet privat për ndërtimin e HEC-ve, subjekte të pajisura me leje nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, të cilat kanë lidhur kontratë qiraje për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore me afat nga 1 deri në 2 vjet.

Bazuar në kontratat e dhënies me qira të fondit pyjor e kullosor, lidhur midis bashkisë dhe subjekteve private, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi, për ndërtimin e HEC-ve, për periudhën janar 2017 deri më 31.12.2019, u konstataua se nga Ndërmarrja e Shërbimit Pyjor të Bashkisë Skrapar, për pesë subjekte nuk janë aplikuar saktë tarifat e përdorimit të fondit pyjor e kullosor, lekë/ha/vit dhe lekë/km/vit, ku nga rillogaritjet e kryera rezulton me një diferencë më pak në **vlerën 722,110 lekë, dëm ekonomik në buxhetin e bashkisë Skrapar**, sipas aneksit nr.2/13 të lënë nga KLSH në fund raporit të auditimit.

Kriteri	VKM nr 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", i ndryshuar, lidhja nr. 2 pika 11.
Ndikimi/ Efekti	-Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve.
Shkaku	-Mos zbatimi i kërkesave ligjore, mos realizim i të ardhurave dhe mos realizim i kryerjes së shërbimeve për komunitetin.
Rëndësia:	-E mesme.
Rekomandim	Nga Titullari i Njësisë Vendore, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren të gjitha masat e duhura ligjore, për arkëtimin e detyrimit nëvlerën prej **722,110 lekë,** nga aplikimi gabuar i tarifave të përdorimit të fondit pyjor, sipas listës së lënë nga KLSH në fund të raporit të auditimit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme për gjetjet e auditimit nr.5 dhe 6 ngarkohen me përgjegjësi:
z.N. S., me detyrë ish Kryetar i Bashkisë, për periudhën 01.01.2017-31.07.2019.
z.I. Ç., me detyrë ish Drejtor i Shërbimit Pyjor, për periudhën 01.01.2017 deri më 17.09.2019, aktualisht Jurist në Ndërmarrjen e Shërbimit Pyjor.
z.T. L., me detyrë DSHP, periudha 17.09.2019 deri më 31.12.2019.
z.F. O., me detyrë Jurist në DSHP, për periudhën 01.01.2017 deri më 18.09.2019, larguar nga puna.

7. Programimi, realizimi i të ardhurave, nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, dhe nga dhënia e certifikatave të përdorimit për objektet e ndërtimit.

7.Titulli Gjetjes	KLSH konstatoj se,nga Sektori i Planifikimit, Zhvillimit të Territorit, Bashkia Skrapar,nuk është kryer përllogaritja e saktëe taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, dhe nga dhënia e certifikatave të përdorimit,rezultuar me të ardhura të munguara, të paplanifikuara me dëm në buxhetin e bashkisë në vlerën **18,860 lekë.**
Situata:	Nga Bashkia Skrapar, Sektori i Planifikimit, Zhvillimit të Territorit, për periudhën objekt auditimi janë miratuar 8 leje ndërtimi dhe janë dhënë 2 certifikata përdorimi për objekte të ndryshme ndërtimi. Në auditimin e programimit dhe realizimit të të ardhurave, nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, dhe nga dhënia e certifikatave të përdorimit, për periudhën 1janar 2017 deri më 31.12.2019, konstatohet se nga Sektori i Planifikimit, Zhvillimit të Territorit, nuk është llogaritur saktë, taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja, nuk është kryer përllogaritja në bazë të çmimit referencë që është kosto mesatare e ndërtimit sipas Entit Kombëtar të Banesave, në vlerën **18,860 lekë**,e ardhur e paplanifikuar dhe munguar në buxhetin e bashkisë Skrapar, përkatësisht,vlera 12,530 lekë për lejen e ndërtimit nr.9, datë 04.12.2018, për objektin shtëpi banimi 1 dhe 2 kate, me vendndodhje në Vëndreshë NjA Qendër në emër të qytetarit A. K. dhe vlera 6,330 lekë për Certifikatën e Përdorimit miratuar me nr.1, datë 31.08.2017, për objektin "Godinë banimi individuale 1 kt" me vendndodhje në fshatin Çerenisht, NjAQendër, miratuar me Leje Ndërtimi nr.3, datë 22.08.2016, në emër të qytetarit A. Y..
Kriteri	Ligji nr. 107, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar neni 46, Udhëzimi KM nr.3, datë 28.12.2016, "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i banesave, për vitin 2016" dhe VKB nr.1, datë 21.01.2016 "Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2016", i ndryshuar.
Ndikimi/	-Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve.

Efekti

Shkaku -Mos zbatimi i kërkesave ligjore, mos realizim i të ardhurave dhe mos realizim i kryerjes së shërbimeve për komunitetin.

Rëndësia: -I ulët.

Rekomandim Në të ardhmen të llogariten këto llojë taksa.

Komente nga subjekti i audituar: *Për sa më sipër janë bërë kundërshti nga subjekti i audituar, z. B. M., me detyrë përgjegjës i Sektorit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, për Projektraportin e auditimit në të cilat në mënyrë të përmbledhur thuhet:*
.....Për sa i përket taksës së ndikimit në infrastrukture për lejet e ndërtimit " Shtëpi banimi 1 dhe 2 kate " me vendndodhje në fshatin Vërzhezhë nga qytetari A. K. dhe "Shtëpi Banimi " 1 kat e z. A. Y. Fshati Çerenisht Njësia Administrative Qendër, Bashkia Skrapar ajo është llogaritur sipas ligjit nr.107,date 31.07.2014 "Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" të ndryshuar, nenit 46 dhe paketës fiskale të Bashkise Skrapar të miratuar me V.K.B nr. date 29.08.2016 dhe nr.63.datë 28.06.2018.
Në nenin 46 dhe te LPZh,T-se dhe jo vetëm nuk citohet ne asnjë rast qe duhet ti referohemi kostos se ndërtimit sipas Entit Kombëtar te Banesave edhe në qofte se do te citohej ne këtë rast nuk zbatohet udhëzimi nr. 3 i Keshillit te Ministrave datë 28.12.2016 për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave, për vitin 2016 për arsye se në këtë udhëzim përcaktohen kostot e sipërfaqes në m2 të ndërtimit vetëm për qytetet dhe jo për fshatrat dhe është vetëm për vitin 2016. Të dyja këto raste që ju i referoheni janë leje ndërtimi të dhëna në fshatrat Vëndreshe dhe Çerenisht, njësia Administrative Qendër Bashkia Skrapar. Për rrjedhoje i jemi referuar preventivit te investimit qe do te kryhej. Per sa më larte se taksa e ndikimit ne infrastrukture për ndërtimet e reja eshte llogaritur sakte nga Sektori i Planifikimit te Territorit Bashkia Skrapar sipas ligjeve ne fuqi. Konkluzioni qe ju keni nxjer qe vlera prej 18,860 leke nuk është arkëtuar dhe konsiderohet si dëm ekonomik eshte i pabazuar në ligj dhe nuk qëndron.
Qëndrimi i grupit të auditimit: *Nga grupi i auditimit kundërshtimet e subjektit nuk merren në konsideratë për sa i përket përllogaritjes së takës së ndikimit në infrastrukturë pasi;*
1. Në nenin 46 Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, në pikën 1. Citohet se "Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zbatohet për zhvillimet që, sipas këtij ligji, kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe llogaritet mbi çmimin referencë ose preventivin e investimit të ri që kërkohet të kryhet, duke përzgjedhur atë që ka vlerën më të lartë".
Në përllogaritjen e kryer nga Ju për taksën e ndikimit i jeni referuar vlerës së preventivit e cila është vlerë më e ulët se çmimi referencë, kur në nënin 46 të ligjit nr. 107, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar, citohet që midis çmimit referencë dhe preventivit të investimit të ri që kërkohet të kryhet, duhet përzgjedhur atë që ka vlerën më të lartë.
2. Gjithashtu në nenin 46 të ligjit nr. 107, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar nuk përcakton se ndërtimi është në fshat apo në qytet.
3.Për sa i përket përgjegjësisë për masa disiplinorë qëndron, merret në konsideratë nga grupi i auditimit pasi shkelja është e papërfillshme për të mos rekomanduar masë disiplinore.

C. Vlerësimi i Raportimit Financiar (Pasqyrat financiare)

- **1.**Në Pasqyrat e Pozicionit Financiar, në llogarinë 210 "*Toka, Troje, Terrene*", nuk është pasqyruar vlera e trojeve nën objekt të ndërtesave të bashkisë, të shkollave, të zyrave në

Njësitë Administrative si dhe vlera e truallit dhe e godinave të regjistruar në ZRPP/ASHK dhe vlera e trojeve të cilat kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Skrapar si dhe nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i trojeve.

1.Titulli gjetjes:	Llogaria 210 "Toka, troje, terrene" nuk pasqyron saktë vlerën e aseteve të njësisë vendore.
Situata:	-Në Pasqyrat e Pozicionit Financiar, gjendja e llogarisë 210 "Toka, Troje, Terrene" në vitin 2016, paraqitet në vlerën 1,251,818 lekë, në vitin 2017 paraqitet me 2,843,818 lekë, në fund të viti 2018 paraqitet në vlerën 2,843,818 lekë, dhe 31.12.2019 paraqitet e pa ndryshuar ne vlerën 2,843,818 lekë, shtesa është vetëm në vitin 2017 në vlerën 1,592,000 lekë. Vlerat e investimeve në vitet e mëparshme dhe të viti ushtrimor, paraqiten sipas objekteve të mëposhtme: -Rrethim Varrezash fshati Radësh , viti 2008, vlera 794,913 lekë, -Rrethim Varrezash fshati Dhorës, viti 2010, vlera 456,905 lekë, -Blerje tokë për varrezat e qytetit Çorovodë, viti 2017, vlera 1,592,000 lekë. Në këtë llogari nuk është pasqyruar vlera e trojeve nën objekt të ndërtesave sipas llogarisë 212 "Ndërtime e konstruksione" si vlera e truallit të godinës së Bashkisë dhe objekteve të tjera. Në këtë llogari nuk është pasqyruar edhe vlera e trojeve të cilat me VKM janë kaluar në pronësi të Bashkisë Skrapar. Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i trojeve me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit. Llogaria "Toka, troje, terrene", nuk paraqet vlerën e saktë të pasurisë së njësisë vendore, për shkak të mos marrjes së masave për regjistrimin në ZVRPP/ASHK të pasurive ekzistuese dhe të atyre të cilat me VKM të posaçme kanë kaluar në pronësi të Bashkisë.
Kriteri:	-Ligji nr.25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, neni 15, pika 1 dhe 2, -UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", kapitulli IV. pika 74 dhe 96, -UMF nr. 8 datë 9.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*".
Ndikimi	-Pasqyrat financiare nuk paraqesin informacion të saktë për llogarinë 210 "Toka, troje, terrene", nuk pasqyrojnë me vërtetësi vlerën e saktë të pasurisë së njësisë vendore.
Shkaku:	-Mos zbatimi i kuadrit ligjor për veprimet kontabël të llogarisë 210 "*Toka, Troje, Terrene*",
Rëndësia:	-E lartë.
Rekomandimi:	-Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues të marrin masa për sistemimin e llogarisë 210 "*Toka, Troje, Terrene*", duke bërë që në këtë llogari të paraqitet, vlera e tokës truall nën objekte të ndërtesave të pasqyruar në llogarinë 212 "Ndërtime e konstruksione", vlera e trojeve të cilat me Vendime të Këshillit të Ministrave janë kaluar në pronësi të Bashkisë dhe vlera e truallit të lirë dhe vlera e tokës truall nën objekt për ndërtesat e regjistruara në ZRPP si dhe të kryhet inventarizimi i trojeve me komision.

- **2.**Në Pasqyrat e Pozicionit Financiar, në llogarinë211 "*Pyje, kullota, plantacione*", nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë, sipas VKM nr.433, datë 8.6.2016 "*Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive*", pika 6, shtojca me nr.4, sipas listës së inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Skrapar, me numër rendor nga 1(një) deri 892 (tetëqind e nëntëdhjetë e dy) dhe godinae Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, nuk është kryer

inventarizimi dhe vlerësimi i Pyjeve dhe Kullotave me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit.

2.Titulli gjetjes:	Mos pasqyrim në llogarinë 211 "Pyje, kullota, plantacione" të vlerës së pyjeve dhe kullotave te regjistruara ne ZRPP, mos inventarizim dhe mos vlerësim pyjeve dhe kullotave.
Situata:	Në Pasqyrat e Pozicionit Financiar gjendja e llogarisë 211 "Pyje, kullota, plantacione" paraqitet për vitet 2016-2019 në vlerën 6,851,988 lekë pa ndryshime nga viti në vit, kjo vlerë përfaqëson vlerën investimeve, të kryera në vitin 2016 e konkretisht: Pyllëzim i kurorës së qytetit Çorovodë, viti 2016, vlera 6,851,988 lekë. Konstatohet se, në këtë llogari nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe kullotave të transferuara në pronësi të Bashkisë Skrapar, sipas VKM nr.433, datë 8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive", pika 6, shtojca me nr.4, e cila përmban: a) listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Skrapar, me numër rendor nga 1(një) deri 892 (tetëqind e nëntëdhjëtë e dy). b) godinën e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor. Llogaria "Pyje, kullota, plantacione", nuk paraqet vlerën e saktë të pasurisë së njësisë vendore, për shkak të mos marrjes së masave për regjistrimin në ZVRPP/ASHK të pasurive ekzistuese dhe të atyre të cilat me VKM të posaçme kanë kaluar në pronësi të Bashkisë.
Kriteri:	-Ligji nr.25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, neni 15, pika 1 dhe 2, -UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", kapitulli IV. pika 74 dhe 96, -UMF nr. 8 datë 9.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*".
Ndikimi	-Pasqyrat financiare nuk paraqesin informacion të saktë për llogarinë 211 "Pyje, kullota, plantacione", nuk pasqyrojnë me vërtetësi vlerën e saktë të pasurisë së njësisë vendore.
Shkaku:	-Mos zbatimi i kuadrit ligjor për veprimet kontabël të llogarisë 211 "Pyje, kullota, plantacione".
Rëndësia:	-E lartë.
Rekomandim	-Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues të marrin masa për sistemimin e llogarisë 211 "Pyje, kullota, plantacione" duke bërë që në këtë llogari të paraqitet, vlera e pyjeve dhe kullotave të regjistruara në ZRPP, si dhe të kryhet inventarizimi i tyre me komision.

3.Titulli gjetjes:	Në Pasqyrat e Pozicionit Financiar, llogaria 212 "Ndërtime e konstruksione", paraqet vlerën e saktë, por vlera e aktiveve të kësaj llogarie është e ndarë nga vlera e investimeve shtesë qëështë bërë për këto aktive (si rikonstruksione dhe vlera mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objekteve etj).
Situata:	Në Pasqyrat e Pozicionit Financiar, gjendja në llogarinë 212 "Ndërtime e konstruksione" për vitin 2016, paraqitet në vlerën 410,974,047 lekë, më 31.12.2017, rezulton 430,477,093 lekë, më 31.12.2018, rezulton 438,291,593 lekë dhe më 31.12.2019, rezulton 490,546,120 lekë.

Shtesat gjatë vitit 2017 janë në vlerën 87,787,278 lekë, si vijon:

1	Rik.Zyrave te Nd.Sh.Pyjor	NdertesaAdm	3,602,536
2	Rik.Zyrave te Nd.Sh.Pyjor	Ndertesa Administrative	12,684
3	MbikqyrjeRik.Zyrave te Nd.Sh.Pyjor	Ndertesa Administrative	117,600
4	Rik.ShkollesGostenckeNj.Adm.Leshnje	Ndertese Shkollore	295,000
5	Rikonstruksioni Shkolles "Kahreman Ylli"	Ndertese Shkollore	53,359,056
6	Rikonstruksioni ShkollesZ.Veleshnja (IADSA)	Ndertese Shkollore	28,563,120
7	Rik.Varrezave te Deshmoreve Faza e I-re	Varreza	550,000
8	Rik.Varrezave te Deshmoreve Faza e II-te	Varreza	150,000
9	Sistemim PerrojiGjerbes	Te tjera ndertimore	1,054,536
10	Ndertim Tualetesh Fshati Gjerbes	Te tjera ndertimore	82,746
			87,787,278

Shtesat gjatë vitit 2018 janë në vlerën 26,853,352 lekë, si vijon:

1	Kolaudim Rik.Zyrave te Nd.Sh.Pyjor	Ndertesa Administrative	12,600
2	Kolaudim -Rik.Shkolles "Kahreman Ylli"	Ndertese Shkollore	40,800
3	Rik.ShkollesVendreshe	Ndertese Shkollore	1,662,024
4	Rik.Shkolles Fshati Barç	Ndertese Shkollore	377,445
5	Rik.Shkolles Fshati Osoje	Ndertese Shkollore	866,640
6	Rik.Shkolles Fshati Gradec	Ndertese Shkollore	1,918,750
7	Rik.Shkolles Fshati Velushe	Ndertese Shkollore	618,000
8	Mbikqyrje-Rik.ShkollesVendreshe	Ndertese Shkollore	31,778
9	Mbikqyrje -Rik.Shkolles "Kahreman Ylli"	Ndertese Shkollore	504,000
10	Hidroizolim Shkolla "Kahreman Ylli"	Ndertese Shkollore	539,760
11	Rik.Shkolles "Kahreman Ylli"	Ndertese Shkollore	9,627,941
12	Ndertimi Çatise Muzeut Çorovode	NdertesSoc Kulturore	1,776,000
13	Rik.Godina e MZSH		4,801,956
14	Ndertim Lulishte Lagja "5 Shtator"		3,004,320
15	Mbikqyrje-Ndertim Lulishte Lagja "5 Shtator"		92,322
16	Ndertim Muri mbajtes Rruga Zaloshnje	Te tjera ndertimore	745,016
17	Ndertim Muri mbajtes Rruga Zaloshnje	Te tjera ndertimore	234,000
			26,853,352

Shtesat gjatë vitit 2019 janë në vlerën 4,583,947 lekë, si vijon:

	Ndertime Konstruksione		
1	**Mbikqyrje:Rik.ShkollaGradec**	**Ndertese Shkollore**	**36,000**
2	**Kolaudim:Rik.ShkollaGradec**	**Ndertese Shkollore**	**10,200**
3	**Kolaudim:Rik.ShkollaVendreshe**	**Ndertese Shkollore**	**11,520**
4	**Rikonstruksioni Kopshtit Kakruk**	**Ndertese Shkollore**	**1,586,100**
5	**Mbikqyrje:Ndertimi Çatise Muzeut Çorovode**	**NdertesaSocjal Kulturore**	**43,200**
6	**MbikqyrjeRik.Zyrat e Zjarrfikses**	**NdertimeMbrojte.Civile**	**56,740**
7	**Kolaudim Rik.Zyrat e Zjarrfikses**	**NdertimeMbrojte.Civile**	**17,283**
8	**Kolaudim:Ndertim Lulishte Lagja 5 Shtatori**		**12,120**
9	**Ndertim muri me gabion mbi unazën e qytetit**	**Ndert.Mure Rrethuese**	**744,000**
10	**Ndërtimi kabinës Elektrike te Konviktit**	**Te tjera ndertimore**	**2,066,784**
11	**Rikonstruksionn konvikti shkollës mesme**	**Ndertime konvikte nxënës e studentesh**	**24,111,723**
			28,695,770

Vlerat e investimeve shtesë të cilat nuk i janë bashkuar vlerës fillestare të aktivit (por është pasqyruar në pasqyrat financiare), sipas viteve janë përkatësisht, gjatë vitit 2017, janë në vlerën 87,787,278 lekë, për 10 raste, gjatë vitit 2018, janë në vlerën 26,853,352 lekë, në 17 raste dhe gjatë vitit 2019, janë në vlerën 28,695,770 lekë, në 11 raste, sipas anekseve të mësipërme, nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i AAGJM.

Kriteri:	Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, Neni 15, pika 1 dhe 2, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", kapitulli IV. pika 74 dhe 96.
Ndikimi	-Aktivet në regjistrin e tyre kontabël, nuk paraqiten me vlerën e sakt.
Shkaku:	-Mos plotësim i regjistrit kontabël sipas formatit të duhur dhe mos zbatim i rregullave kontabël.
Rëndësia:	-E ulët.
Rekomandim	-Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues të marrin masa për sistemimin e llogarisë

	212 "Ndërtime e konstruksione", për pasqyrimin e sakt në dokumentet kontabël të vlerës së secilit aktiv afatgjatë materiale, duke shtuar në vlerën fillestare të aktivit, vlerën e shpenzimeve të investimit të ri për secilin objekt (rikonstruksion etj.),si dhe të kryhet inventarizimi i tyre me komision.

4.Titulli gjetjes:	Në Pasqyrat e Pozicionit Financiar, llogaria 213 "Rrugë, rrjete vepra ujore", paraqet vlerën e saktë, por vlera e aktiveve të kësaj llogarie është e ndarë nga vlera e investimeve shtesë qëështë bërë për këto aktive (si rikonstruksione dhe vlera mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objekteve etj).
Situata:	Në Pasqyrat e Pozicionit Financiar, gjendja në llogarinë 213 "Rrugë, rrjete vepra ujore"për vitin 2016, paraqitet në vlerën 1,018,265,626 lekë, më 31.12.2017 rezulton në vlerën 1,268,850,661 lekë, më 31.12.2018 rezulton në vlerën 1,124,613,696 lekë,(Inventari AQT 1,303,433,779 lekë vlera fillestare), ndërsa më 31.12.2019 vlera në pasqyrat financiare rezulton 1,113,795,126 lekë,të cilat përfaqëson vlerën e investimeve të kryera ndër vite për rrugë, rrjete dhe vepra dhe shtesat sipas viteve: Shtesat gjatë vitit 2017 janënë vlerën 250,585,035 lekë, përbëhet nga vlera e objekteve të pasqyruar në aneksin nr.3/2 në fund të raportit të auditimit.Shtesat gjatë vitit 2018 janënë vlerën 34,583,118 lekë, sipas aneksit nr. 3/3 në fund të raportit të auditimit.Shtesat gjatë vitit 2019 janënë vlerën 47,521,715 lekë, sipas aneksit nr. 3/4 në fund të raportit të auditimit. Vlerat e investimeve shtesë të cilat nuk i janë bashkuar vlerës fillestare të aktivit (por është pasqyruar në pasqyrat financiare),janë përkatësisht, gjatë vitit 2017, janë në vlerën 250,585,035 lekë, për 34 raste, gjatë vitit 2018, janë në vlerën 34,583,118 lekë, në 30 raste dhe gjatë vitit 2019, janë në vlerën 47,521,715 lekë, në 7 raste, (sipas anekseve në fund të raportit të auditimit).Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i AAGJM.
Kriteri:	-Ligji nr.25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, neni 15, pika 1 dhe 2, -UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", kapitulli IV. pika 74 dhe 96, -UMF nr. 8 datë 9.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*". kapitulli II, pika 11, aneksi 1,pika 2 Klasa 2, "Aktivet afat gjata", përbërja dhe trajtimi kontabël, germa 'b'
Ndikimi	- Aktivet në regjistrin e tyre kontabël, nuk paraqiten me vlerën e sakt.
Shkaku:	Mos plotësim i regjistrit kontabël sipas formatit të duhur dhe mos zbatim i rregullave kontabël.
Rëndësia:	-E lartë.
Rekomandim	Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues të marrin masa për sistemimin e llogarisë 213"Rrugë, rrjete vepra ujore", për pasqyrimin e sakt në dokumentet kontabël të vlerës së secilit aktiv afatgjatë materiale, duke shtuar në vlerën fillestare të aktivit, vlerën e shpenzimeve të investimit të ri për secilin objekt (rikonstruksion etj.). si dhe të kryhet inventarizimi i tyre me komision.

5.Titulli gjetjes:	Në Pasqyrat e Pozicionit Financiar, në llogarinë 215 "Mjete transporti" , janë pasqyruar edhe vlera 8,158,500 lekë për 4 mjete që nuk kanë dokumentacionin e plotë dhe nuk përcaktohet vendndodhja e tyre, gjatë procesit të inventarizimeve në vitin 2019 kanë rezultuar mangut.

Situata:	Llogaria 215 "Mjete transporti" për vitin 2017 ka vlerën 85,652,568 lekë, për vitin 2018 ka vlerën 36,938,529 lekë dhe për vitin 2019 vlerën 20,145,397 lekë (vlerë neto kontabël). Për periudhën e auditur 2017-2019 kjo llogari nuk pasqyron saktë vlerën e mjeteve të transportit për arsye se në këtë llogari është paraqitur edhe vlera bruto 8,106,500 lekë (vlerë neto 2,178,637 lekë për vitin 2019), që përfaqëson 4 mjete transporti të cilat nuk ekzistojë, nuk ka fletë inventari, nuk ka person përgjegjës material. Këto aktive për vitin 2017 dhe 2018 nuk i janë nënshtruar procesit të inventarizimit. Bazuar në rezultatet e komisionit të inventarizimit për vitin 2019 (detyrë që është kryer gjatë vitit 2020), këto mjete nuk gjenden, nuk ekzistojnë. Gjithashtu nga njësia vendore raportohet se ka edhe 16 mjeteve të transporti të dëmtuara, në vlerën historike 33,060,842 lekë, por ky klasifikim si të dëmtuara nuk është rrjedhojë e procedurave zyrtare të procesit të inventarizimit nga komisionet përkatëse. Veprimet dhe mos veprimet e mësipërme, përbëjnë mungesë përgjegjësie nga ana e nëpunësit zbatues z. N. G., përgjegjësit të sektorit të aseteve znj. H. B.dhe komisioneve të inventarizimit për vitin 2017 dhe 2018 emrate dhe përgjegjësia e të cilëvë trajtohet më hollësisht në rubrikën e Inventarizimit në vijim.
Kriteri:	-Ligji nr.25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, neni 15, pika 1 dhe 2, UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*", kapitulli II, pika 11, aneksi 1,pika 2/1,Trajtimi kontabël dhe rastet e daljeve të aktiveve afat gjata, germat "e" dhe "f" dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 12, 74, 81, 85
Ndikimi	-Pasqyrat financiare nuk paraqesin informacion të saktë për llogarinë 215 "Mjete Transporti", nuk pasqyrojnë me vërtetësi vlerën e saktë të çdo aktivi.
Shkaku:	-Mos zbatimi i kuadrit ligjor për veprimet kontabël të llogarisë 215 "Mjete Transporti"
Rëndësia:	-E lartë.
Rekomandim	Titullari i njësisë vendore të ngrejë komision për vlerësimin e gjendjes së aktiveve të llogarisë 215 "Mjete transporti" i cili pas përfundimit të vlerësimit të përcaktojë listën e mjeteve të dëmtuara. Pas kësaj nga Titullari për mjetet të cilat rezultojnë se nuk mund të rikthehen në gjendje pune për shkak të kostove të larta të riparimit, të vazhdohet me procedurat e mëtejshme të xjerrjes jashtë përdorimit e shitjen e tyre për skrap. Ky proces të përshpejtohet, me qëllim që të mos mbahen mjete të dëmtuara nën ruajtje, në kushtet kur për to nuk ka vende të posaçme dhe persona përgjegjës për ruajtjen e tyre për 24 orë dhe në këtë mënyrë mjetet, pavarësisht gjendjes që kanë, bëhen objekt i humbjes apo i vjedhjes. Për katër mjetet e transportit të cilat nuk gjenden, pasi të bëhen zhdëmtimet nga personat përgjegjës (trajtuar më gjerë te rubrika e dëmit ekonomik), të bëhen rregullimet përkatëse në librat kontabël.

6.Në Pasqyrat e Pozicionit Financiar, për llogarinë466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*", nuk janë marrë masa për likuidimin e vlerës 5,434,875 lekë, të cilat janë detyrime të bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh të kryera për 24 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga bashkia dhe ish Komunat, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit sipas objekteve përkatëse.

6.Titulli gjetjes:	Mos marrje masash për likuidimin e vlerës 5,434,875 lekë, të pasqyruara në

	llogarinë466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*", detyrime të bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh për 24 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga bashkia dhe ish Komunat.
Situata:	Në Pasqyrat e Pozicionit Financiar, gjendja në llogarinë466 "Kreditorë për mjete në ruajtje", paraqitet në pasiv të bilancit në vitin 2017, në vlerën 35,228,302 lekë, në vitin 2018, në vlerën 33,506,214 lekë, në fund të viti 2019, në vlerën 15,062,182 lekë, e cila përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh. Nga analiza e kësaj llogarie,konstatohet se, në llogarinë 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*", nuk janë marrë masa nga Bashkia për likuidimin e vlerës 5,434,875 lekë, të cilat janë detyrime të bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh të kryera për 24 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia. Për këtë nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumenteve për sistemimin e vlerave sipas objekteve dhe subjekteve të paraqitur në aneksin bashkangjitur.Llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje",nuk paraqet vlerën e saktë të detyrimeve të njësisë vendore, për shkak të mos marrjes së masave për plotësimin e dokumentacionit dhe likuidimit të tyre. Pasqyra e detyrimeve ndaj subjekteve për garanci punimesh për objekte të përfunduara paraqitet në aneksin nr. 3/10, në Raportin Përfundimtar të Auditimit
Kriteri:	-UMF nr. 8 datë 9.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*".
Ndikimi	-Pasqyrat financiare nuk duhet të përmbanin në llogarinë 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje* ato vlera financiare, për garanci punimesh, për objekte të cilat janë marrë në dorëzim.
Shkaku:	-Mos zbatimi i kuadrit ligjor për veprimet kontabël të llogarisë 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*".
Rëndësia:	-E lartë.
Rekomandim	-Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues i njësisë vendore, të marrë masa për të zbatuar procedurat ligjore për likujdimin e vlerës **5,434,875 lekë** sipas subjekteve përkatëse dhe kontratave që këto subjekte kanë me njësisnë vendore, të evidemtuara në llogarinë nr**.** 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje", sipas aneksit në fund të raportit të auditimit.

Kthim përgjigje të observacioneve për Projektraportin e auditimit, nga z.N. G. me detyrë Drejtor i Drejtorise Ekonomike.

Komente nga subjekti i audituar: *Janë bërë kundërshti nga z.N. G., për Projektraportin e auditimit ku citohet se:*
Pasi kemi lexuar me vëmendje projekt raportin e auditimit të Bashkisë Skrapar ju paraqesim obsevacionin tonë si më poshtë:
1-Në projekt raport është përmendur se vlera 33,060,842 lekë e cila i përket 16 mjeteve të transportit të dëmtuara duhej paraqitej në pasqqyrat e pozicionit financiar në llogarin 28- "Aktive afatgjata të dëmtuara". Për sa më sipër ju informoj se nuk disponohet një listë e mjeteve të dëmtuara për të cilat financa të bënte levizjen kontabel, dhe këto mjete janë transferuar nga ish komunat në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike dhe informacionin për gjendjen teknike duhe të na vihej në dispozicion nga përduruesit e këtyre mjeteve.
2-Në projekt raport është përmendur se vlera 9,058,500 lekë e cila i përket katër mjeteve

të dëmtuara që nuk kanë dokumentacionin e plotë, nuk dihen personat përgjegjës material si dhe nuk përcaktohet vendodhja e tyre, nuk ka dalë përgjegjësia qysh në inventaret e viteve të mëparshme në kohën e përthithjes së tyre nga ish Komunat në vitin 2015.
Për sa më sipër ju informojmë se jo vetëm këto mjete por të gjitha mjetet e ish Komunave janë transferuar në Ndermarrjen e Shërbimeve Publike, në zbatim të VKM nr.510,datë 10.06.2015"Për miratimin e proçedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve ,personelit,aktiveve të trupezuara dhe të patrupëzuar,të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësit e qeverisjes vendore të prekura nga riorganizimi aministrativo-territorial", Kryetari bashkisë si personi përgjegjës për zbatimin e të gjitha procedurave të transferimit, me urdhër të veçantë ka ngritur grupin e punës sipas përcaktimeve të pikës 2 të kreut II të këti ligji.Të gjitha mjetet janë dorzuar me proces verbal të nënshkruar nga anëtarët e komisjonit, dorzuesi dhe marrësi në dorzim. Nisur nga rekomandimet në këtë projkte raport me shkresë nr.1047 prot,datë 02.04.2020 i kemi kërkuar Ndermarrjes Shërbimeve Publike informacion mbi gjendjen fizike, gjendjen teknike dhe personat përgjegjës materjal të mjeteve të Bashkise Skrapar të dhëna në përdorim dhe akoma nuk kemi një përgjigje. Nisur nga fakti se këto mjete janë marë me procesverbl nga përfaqsues të Ndërmarrjes këta të fundit duhe të kenë vepruar dhe me proçedurat e ngarkimit të personave përgjegjës materjal për këto mjete. Ndërsa për mjetin tip "Ford Tranzit" ju bëjmë me dije se ka qën në inventar të bashkisë me person përgjegjës materjal Z.F. Z.. Z.F. Z. ka deklaruar se disponon një proçesverbal dorzimi ku mjeti u ka kaluar rojeve të objektit të Thertores dhe në këtë procesverbal theksohet se në momentin e dorzimit i ka munguar pompa e naftës.Megjithatë përgjegjësia e komisjonit të invetarizimit është evidente në këtë rast. Theksojmë se me marrjen e informacioni të kërkuar nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike për mjetet do të vazhdojmë me proçedurën e mëtejshme.
3-Në lidhje me detyrimet ndaj operatorëve ekonomik të cilët kan realizuar kontrata në objekte të ndryshme të investimeve - llogaria 466 –garanci punimesh ju bëjm me dije se Drejtoria e Financës ka likujduar të gjitha garancit e punimeve të objekteve për të cilat janë paraqitur dokumentat justifikues. Po ashtu disa nga këto subjekte kan detyrime ndaj bashkisë, pra janë debitor dhe në momentin e arkëtimit të debis nga ana e tyre ne do të bëjmë financimin e garancisë punimeve.
Qëndrimi i grupit të auditimit: *Nga grupi i auditimit kundërshtimet e subjektit merren pjesërisht në konsideratë pasi:*
1.Bazuar në kërkesën e grupit të auditimit, drejtuar Drejtorisë Ekonomike për informacion mbi mjetet e transportit për të cilat kërkohej sa janë në gjëndje pune dhe sa janë të dëmtuar, nga Drejtori i Financës dhe specialiste e Aseteve është kthyer përgjigje me informacionin tuaj të nënshkruar nga Drejtori i Financës dhe specialiste e Aseteve keni përcaktuar mjetet ne gjendje pune dhe mjete të dëmtuara. Pra në llogarinë 215 "Mjete transporti" janë pasqyruar gabim vlera e mjeteve të transportit të dëmtuara prej 33,060,842 lekë e cila i përket 16 mjeteve të transportit të dëmtuar (AAGJM) dhe duhej të paraqitej në pasqyrat e pozicionit financiar në llogarinë 24 "Aktive afat gjata të dëmtuara", observacioni nuk merret në konsideratë.
2.Bazuar në dokumentet e fletëve të inventarizimit të aktiveve, për periudhën objekt auditimi,u konstatua se nuk është kryer inventarizimi i plotë i mjeteve të transportit sipas Llogarisë 215 "Mjete Transporti". nga komisionet e inventarizimeve. Gjatë inventarizimit nuk janë evidentuar, nuk janë pasqyruar në fletët e inventarit katër mjete e konkretisht, Mjeti tip Ford Tranzit me vlerë fillestare 400,000 lekë, transferuar nga ish bashkia Corovodë, Mjeti tip Fadrom me vlerë fillestare 2,498,500 lekë, transferuar nga ish

Komuna Qendër, Mjeti tip Fadrom Fernec me vlerë fillestare 3,280,000 lekë, transferuar nga ish Komuna Çepan dhe Mjeti tip Makinë me vlerë fillestare 2,880,000 lekë , transferuar nga ish Komuna Zhepë. Me kërkesë të vazhdueshme të grupit të auditimit për gjetjen e personave përgjegjës të këtyre katër mjeteve të transportit është përcaktuar përgjegjësia se kush persona i ka në ngarkim në periudhën para transferimit të të drejtave dhe detyrimeve sipas VKM nr.510,datë 10.06.2015"Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve ,personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuar, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësit e qeverisjes vendore të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial".
Personat përgjegjës të këtyre katër mjeteve sipas observacionit janë:
Për mjetin tip Ford Tranzit me vlerë fillestare 400,000 lekë, transferuar nga ish bashkia Corovodë, personi përgjegjës është z.F. Z., sipas një flete inventari të vitit 2019 të nënshkruar prëj tijë dhe të sjellë nga Bashkia Skrapar nëpërmjet observacioneve.
Për mjetin tip Fadrom me vlerë fillestare 2,498,500 lekë, transferuar nga ish Komuna Qendër, personi përgjegjës është z.B. B., sipas një flete inventari të vitit 2014 të nënshkruar prëj tijë dhe të sjellë nga Bashkia Skrapar nëpërmjet observacioneve.
Për mjetin tip Fadrom Ngarkues vetëlëvizës Fermec 865, me vlerë fillestare 3,228,000 lekë, transferuar nga ish Komuna Çepan, personi përgjegjës është z.A. H., sipas një proces verbali të datës 05.08.2015 mbajtur midis përfaqsuesve të NjA Çepan, komisionit të Bashkisë të ngritur për zbatimin e VKM nr.510,datë 10.06.2015"Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve ,personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuar, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësit e qeverisjes vendore të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial" dhe marrësit në dorëzim z.A. H. në atë periudhë me detyrë ekonomist në Ndërmarrjen e Shërbimeve. Kopje e këtij proces verbal ndodhet bashkangjitur observacioneve, të sjellë nga Bashkia Skrapar.
Për Automjetin Land Rover me vlerë fillestare 1,980,000 lekë , transferuar nga ish Komuna Zhepë. personi përgjegjës është z.A. H., sipas një proces verbali të datës 07.08.2015 mbajtur midis përfaqsuesve të NjA Zhepë, komisionit të Bashkisë të ngritur për zbatimin e VKM nr.510,datë 10.06.2015"Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve ,personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuar, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësit e qeverisjes vendore të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial" dhe marrësit në dorëzim z.A. H. në atë periudhë me detyrë ekonomist në Ndërmarrjen e Shërbimeve. Kopje e këtij proces verbal ndodhet bashkangjitur observacioneve, të sjellë nga Bashkia Skrapar. Personat kryesor përgjegjës për menaxhimin e aktiveve janë Nëpunësi i Autorizuar dhe Nëpunësi Zbatues dhe persona menaxherial të tjerë të cilët në rastin konkret është kryetari i komisionit të inventarizimeve, observacioni merret pjesërisht në konsidertë dhe u bënë rregullimet përkatëse në raportin përfundimtar të auditimit, kurse për pjesën që nuk janë kryer inventarizimi për periudhën objekt auditimi nuk merret në konsideratë.
3.Bazuar në inventarin e llogarinë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje", nuk i është dhënë zgjidhje për likuidim vlerës 5,434,875 lekë, pasi janë detyrime të bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh të kryera për 24 objekte të përfunduara. Likuidimi të kryhet pasi të paraqitjen dokumentet nga subjektet, pasi kjo llogari nuk pasqyron vlerën reale të detyrimeve ndaj subjekteve, observacioni nuk merret në konsideratë.

7.Mbi hartimin eregjistrit të aseteve dhe të pronave të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë si dhe regjistri i veçantë për pasuritë e dhëna me qira.

7.Titulli gjetjes:	Mos marrje masash për mbajtje tënjëregjistër të plotë të pronave të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë dhe mos mbajte regjistri të veçantë për pasuritë e dhëna me qira.
Situata:	Nga auditimi i dokumenteve të aseteve të bashkisë u konstatua se nga Drejtoria Ekonomike, zyra e aseteve, nuk ka plotësuar me të gjitha të dhënat e kërkuara ligjore, formatin e regjistrit të aktive, nuk është plotësuar me të gjitha kërkesat e kërkuara ligjore si regjistri për pronat e trashëguara dhe për pronat të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të saj, veprime në kundërshtim me kërkesat e nenit 23, pika 14, Kap. VII të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar dhe pikave 26 dhe 30, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, përkatësisht për llogaritë kontabël 210 "Toka, troje, terrene", 211 "Pyje, plantacione", 212 "Ndërtesa e konstruksione" dhe 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore". Gjithashtu regjistri për objektet e dhëna me qira nuk është plotësuar me të gjitha të dhënat e kërkuar e sidomos nuk është plotësuar kartelë për cdo pasuri të dhënë me qira dhe nuk është plotësuar kolona për arkëtimet sipas muajëve të vitit kalendarik, në kundërshtim me pikën 31/d të udhëzimit të mësipërm.
Kriteri:	- Ligji nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, neni 23, pika 14, Kap. VII UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pikat 26, 30 dhe 31/d.
Ndikimi	-Nga mosevidentimi, mosregjistrimi dhe mospasqyrimi real i aseteve dhe nga mos administrimi i mire i tyre, nuk janë shfrytëzuar për dhënie me qira të tretëve dhe krijimin e tëardhurave që rrjedhin prej tyre, duke krijuar mungesë të të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve.
Shkaku:	-Mos zbatimi i kuadrit ligjor për administrimin e aseteve.
Rëndësia:	-E lartë.
Rekomandim	- Titullari i njësisë vendore, drejtoria e financës, zyra e aseteve, të analizojë situatën e krijuar dhe të marrë masat që me specialistë të fushës, të inventarizojë dhe saktësojë pronat sipas të dhënave të kontabilitetit, si dhe krijimin e regjistrit të aseteve, regjistrimin e pronave dhe plotësimin e regjistrit të objekteve të dhëna me qira, në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar dhe ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme lidhur me pasqyrat financiare ngarkohet me përgjegjësi z. N. G., me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike.

Inventarizimi vjetor i aktiveve. Mangësitë e konstatuara nga auditimi për llogarinë 215 "Mjete transporti".

Për vitin 2017: Nga ish kryetari i bashkisë z. N. S. ka dalë urdhri nr. 139, datë 07.11.2017 "Për ngritjen e komisionit të inventarizimit për aktivet e qëndrueshme dhe objektet e inventarit të Bashkisë Skrapar", i përbërë nga: z. E. Y., kryetar komisioni, dhe anëtarët e tjerë: znj. J. S., me detyrë ish përgjegjëse e sektorit juridik, ndërprerë marrëdhëniet e punës me vendimin nr. 35 date 30.08.2019; znj. A. H., me detyrë ish inspektore IT, ndërprerë marrëdhëniet e punës me vendim nr. 8/1 date 02.09.2019; znj. M. B. me detyrë ish arkiviste,

ndërprerë marrëdhëniet e punës me vendimin nr.31, date 30.08.2019; z. D. H. me detyrë ish inspektor i emergjencave civile, ndërprerë marrëdhëniet e punës me vendimin nr. 97 date 09.10.2019.
Për vitin 2018: Nga ish kryetari i Bashkisë z. N. S. ka dalë urdhri nr. 82, datë 01.11.2018 "Për ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve në Bashkinë Skrapar dhe institucionet vartëse", i përbërë nga znj. H. B., kryetare komisioni, si dhe anëtarët: znj. A. H., znj. R. H., me detyrë përgjegjëse e sektorit të shërbimit social, z. B. D. me detyrë ish inspektor taksash, ndërprerë marrëdhëniet e punës me vendimin nr. 27 date 30.08.2019; znj. M. B., me detyrë inspektore ushqimi.
Për vitin 2019 Nga kryetari i bashkisë z. A. M. ka dalë urdhri nr. 185 datë 07.11.2019, "Për ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve në njësitë administrative të Bashkisë Skrapar dhe urdhëri nr. 196, datë 21.11.2019 (për zëvendësim të një anëtari të komisionit). Komisioni përfundimtar është i përbërë nga znj. H. B., kryetare komisioni, si dhe anëtarët: z. E. S., me detyrë specialist IT, znj. M. B., me detyrë inspektore ushqimi, znj. B. C. me detyrë specialiste e taksave në NJA Qëndër, z. R. G., me detyrë përgjegjës i sektorit të shërbimeve.
Gjithashtu për vitin 2019 nga kryetari i bashkisë z. A. M. ka dalë urdhri nr. 186, datë 07.11.2019 "Për ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve në institucionet vartëse të Bashkisë Skrapar", i përbërë nga znj. H. B., kryetare komisioni, si dhe anëtarët: znj. X. L., me detyrë përgjegjëse e sektorit të financës, z. E. S., me detyrë specialist IT, z. T. H. me detyrë inspektore e ndihmës ekonomike, z. S. M. me detyrë jurist.

Për vitin 2017 dhe 2018 procesi i inventarizimit për aktivet e llogarisë 215 "Mjete transporti" nuk është kryer i plotë, pasi në këtë proces nuk është përfshirë inventarizimi i katër mjeteve të transportit me vlerë kontabël 8,106,500 lekë:
- mjeti tip "Ford Tranzit", me vlerë kontabël 400,000 lekë;
- mjeti tip "Fadrom", me vlerë kontabël 2,498,500 lekënga ish Komuna Qëndër;
- mjeti "Fadrom Fermec 865", ngarkues vetëlëvizës, i cili i përket inventarit të ish Komunës Çepan, me vlerë kontabël 3,228,000 lekë;
- automjeti "Land Rover L....8", me vlerë kontabël 1,980,000 lekë, nga inventari i ish Komunës Zhepë.
Pra për këto mjete nuk është kryer verifikimi faktik nëse gjendja kontabël përputhet me gjendjen fizike. Për periudhën kohorejanar 2017- 28 shkurt 2020, datë në të cilën ka përfunduar faza e auditimit në subjekt, Bashkia Skrapar nuk disponon asnjë dokument lidhur me këto mjete, nuk ka fletë inventari, nuk ka person përgjegjës material dhe nuk ka dijeni për ekzistencën fizike të tyre. Për vitin 2017 dhe 2018 vlerën 8,106,500 lekë në gjendjen kontabël, e ka formalisht të trashëguar nga pasqyrat financiare të mëparshme. Për vitin 2019, deri në datën 28.02.02020, datë në të cilën është mbyllur auditimi në subjekt, procesi i inventarizimit të aktiveve për vitin 2019, nuk ka përfunduar.
Në datën 27.04.2020, nëpërmjet imelit zyrtar në adresën e z. B. M. dhe z. H. A., nga Drejtori ekonomik z. N. G., Specialiste e menaxhimit të aseteve znj. H. B. dhe komisioni i inventarizimit, është dërguar informacioni, me lendë "Për mjetet në inventar të bashkisë tëcilat nuk ekzistojnë", në të cilin përshkruhet se katër mjetet e mësipërme nuk gjenden, nuk ekzistojnë.
Më hollësisht si vijon:

1.Për mjetin tip Ford Tranzit.

Sipas fletës së inventarit të Bashkisë për periudhën 2017-2019, konstatohet se nuk evidentohet mjeti tip Ford Tranzit. Nisur nga ky fakt u audituan fletët e inventarit të një viti të mëparshëm të vitit 2016 ku u konstatua se mjeti tip Ford Tranzit, me vlerë 400,000 lekë është

në ngarkim të z.F. Z.. U thirr dhe u pyet personi përgjegjës z.F. Z. i cili deklaroi se mjetin e ka lënë në ruajtje tek rojet te objekti thertore, me dokument por nuk ka mbajtur kopje. Sqaron se ka një dokument fotokopje proces verbali në të cilin dokumentohet se në datën 04.09.2017 mjetit i janë vjedhur disa pajisje si pompa e naftës dhe ventilatori. Në vijim konstatojmë se në vitin 2018 dhe në vitin 2019 mjeti tip Ford Tranzit nuk pasqyrohet në fletët e inventarit.
Pas dërgimit të Projektraporit në subjekt, së bashku me observacionet është paraqitur edhe fleta e inventarizimit e vitit 2016 për mjetin Ford Tranzit, në të cilën vërtetohet se personi përgjegjës material në këtë vit ka qenë z.F. Z.. Kjo fletë inventarizimi është nënshkruar nga z.F. Z.. Përvec fletës së mësipërme të inventarizimit, nga njësia vendore nuk janë paraqitur dokumente të tjera për të vërtetuar ndryshimin e përgjegjësisë materiale të mjetit nga z. F. Z. të persona të tjerë. Për arsye se ky mjet është lënë jashtë procesit të inventarizimit për periudhë e auditimit 2017-2019, nuk ka të dhëna të tjera për vendndodhjen dhe përgjegjësinë materiale të këtij mjeti, vec atyre të mësipërme.
Përfundimisht mjeti tip Ford Tranzit me vlerë fillestare 400,000 lekë nuk ka fletë inventari, nuk ka person përgjegjës material dhe njësia vendore Bashkinë Skrapar nuk ka dijeni për ekzistencën fizike të këtij mjeti (deklaron nuk gjenden), për periudhën e auditimit 2017-209. Vlera e këtij mjeti është pjesë e vlerës së aktiveve në pasqyrat financiare në llogarinë 215 Mjete transporti, si rrjedhojë e transferimit nga viti në vit të vlerës së tij 400,000 lekë në këto pasqyra.
Për sa më sipër, për humbjen fizike të mjetit mban përgjegjësi personi përgjegjës material z. F. Z., ish punonjës i Bashkisë Skrapar, me detyrë ish drejtues mjeti, ndërprerë marrëdhëniet e punës me vendimin nr. 66 datë 17.09.2019.

2.Për mjeti tip Fadrom, nga ish Komuna Qëndër, me vlerë fillestare 2,498,500 lekë.
Sipas fletës së inventarit të Bashkisë për periudhën 2017- 2019, konstatohet se nuk evidentohet mjeti Fadrom transferuar nga ish Komuna Qendër. Nisur nga ky fakt u audituan fletët e inventarit të disa viteve të mëparshëm e konkretisht të vitit 2015 ku u konstatua se mjeti tip Fadrom, me vlerë 2,498,500 lekë nuk vërtetohet se cili është personi përgjegjës, pasi në këtë fletë është shkruar personi përgjegjës por nuk është vendosur emër dhe mbiemër, nuk ka as nënshkrim. Ju kërkua informacion ish kryetarit të Komunës z.A. M. i cili deklaroi se mjetin tip fadrom e ka patur në ngarkim z.B. B. i cili deklaroi se mjetin tip Fadrom e kam dorzuar tek ish Drejtori Ndërmarrje Shërbimeve z. M. K. i cili nuk u paraqit për të dhënë informacion. Z.B. B. nuk vërteton me dokument pretendimin e mësipërm.
Duke ju referua fletës së inventarit (të ish Komunës Qendër), e cila i përket viti 2014, për këtë mjet, personi përgjegjës në këtë vit del z.B. B., pasi kjo fletë inventari është nënshkruar prej tij dhe të sjellë nga Bashkia Skrapar pranë grupit të auditimit, së bashku me observacionet pasi është përcjellë në subjekt Projektraporti i Auditimit. Përvec fletës së mësipërme të inventarizimit, nga njësia vendore nuk janë paraqitur dokumente të tjera për të vërtetuar ndryshimin e përgjegjësisë materiale të mjetit nga z. B. B. të persona të tjerë. Për arsye se ky mjet është lënë jashtë procesit të inventarizimit për periudhë e auditimit 2017-2019, nuk ka të dhëna të tjera për vendndodhjen dhe përgjegjësinë materiale të këtij mjeti, veç atyre të mësipërme.
Përfundimisht mjeti tip Fadrom me vlerë fillestare 2,498,500 lekë nuk ka fletë inventari, nuk ka person përgjegjës material dhe njësia vendore Bashkinë Skrapar, nuk ka dijeni për ekzistencën fizike të këtij mjeti (deklaron nuk gjenden), për periudhën e auditimit 2017-209. Vlera e këtij mjeti është pjesë e vlerës së aktiveve në pasqyrat financiare në llogarinë 215 Mjete transporti, si rrjedhojë e transferimit nga viti në vit të vlerës së tij 2,498,500 lekë në këto pasqyra.

Për sa më sipër, për humbjen fizike të mjetit mban përgjegjësi personi përgjegjës material z.B. B., punonjës i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, njësi vartëse e Bashkisë Skrapar, me detyrë manovrator.

3. Për mjetin tip Fadrom Fermec 865, ngarkues vetëlëvizës, me numër shasie V.....Y, me vlerë kontabël 3,228,000 lekë, transferuar nga ish Komuna Çepan.

Sipas fletës së inventarit të Bashkisë për periudhën 2017- 2019, konstatohet se nuk evidentohet mjeti Fadrom transferuar nga ish Komuna Çepan.Nisur nga ky fakt u audituan fletët e inventarit të disa viteve të mëparshëm e konkretisht të vitit 2015, ku u konstatua se se nuk vërtetohet se cili është personi përgjegjës, pasi në këtë fletë është shkruar personi përgjegjës por nuk është vendosur emër dhe mbiemër, nuk ka as nënshkrim.

Sipas proces-verbalit të datës 05.08.2015, mbajtur midis përfaqsuesve të Njësisë Administrative Çepan, komisionit të Bashkisë të ngritur për zbatimin e VKM nr.510,datë 10.06.2015 ”*Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuar, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësit e qeverisjes vendore të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”* dhe, marrësit në dorëzim z. A. H., në atë periudhë me detyrë ekonomist në Ndërmarrjen e Shërbimeve, personi përgjegjës material në vitin 2015 është z. A. H.. Ky procesverbal është përcjellë nga Bashkia Skrapar pranë grupit të auditimit, së bashku me observacionet, pasi është dërguar Projektraporti i auditimit në subjekt.

Përvec fletës së mësipërme të inventarizimit, nga njësia vendore nuk janë paraqitur dokumente të tjera për të vërtetuar ndryshimin e përgjegjësisë materiale të mjetit nga z. A. H. të persona të tjerë. Për arsye se ky mjet është lënë jashtë procesit të inventarizimit për periudhë e auditimit 2017-2019, nuk ka të dhëna të tjera për vendndodhjen dhe përgjegjësinë materiale të këtij mjeti, vec atyre të mësipërme.

Përfundimisht mjeti tip Fadrom me vlerë fillestare 3,228,000 lekë nuk ka fletë inventari, nuk ka person përgjegjës material dhe njësia vendore Bashkinë Skrapar, nuk ka dijeni për ekzistencën fizike të këtij mjeti (deklaron nuk gjenden), për periudhën e auditimit 2017-209. Vlera e këtij mjeti është pjesë e vlerës së aktiveve në pasqyrat financiare në llogarinë 215 Mjete transporti, si rrjedhojë e transferimit nga viti në vit të vlerës së tij 3,228,000 lekë në këto pasqyra.

4. Për automjetin Land Rover L....8, me vlerë fillestare 1,980,000 lekë, viti i prodhimit 1994, me numër shasie S.....5, blerë nga ish komuna Zhepë më datën 23.06.2010, në vlerën 1,980,000 lekë.

Sipas fletës së inventarit të Bashkisë për periudhën 2017- 2019, konstatohet se nuk evidentohet ky mjet. Sipas proces-verbalit të datës 07.08.2015 mbajtur midis përfaqësuesve të NjësisëAdministrative Zhepë, komisionit të Bashkisë Skrapar të ngritur për zbatimin e VKM nr.510,datë 10.06.2015 ”*Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuar, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësit e qeverisjes vendore të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial*” dhe, marrësit në dorëzim z.A. H. në atë periudhë me detyrë ekonomist në Ndërmarrjen e Shërbimeve, personi përgjegjës material në vitin 2015 është z.A. H.. Ky procesverbal është përcjellë nga Bashkia Skrapar pranë grupit të auditimit, së bashku me observacionet, pasi është dërguar Projektraporti i auditimit në subjekt.

*Përvec fletës së mësipërme të inventarizimit, nga njësia vendore nuk janë paraqitur dokumente të tjera për të vërtetuar ndryshimin e përgjegjësisë materiale të mjetit nga z.*A. H. *të persona të tjerë. Për arsye se ky mjet është lënë jashtë procesit të inventarizimit për*

periudhë e auditimit 2017-2019, nuk ka të dhëna të tjera për vendndodhjen dhe përgjegjësinë materiale të këtij mjeti, vec atyre të mësipërme.
Perfundimisht automjetin Land Rover L....8, me vlerë fillestare 1,980,000 lekë nuk ka fletë inventari, nuk ka person përgjegjës material dhe njësia vendore Bashkinë Skrapar, nuk ka dijeni për ekzistencën fizike të këtij mjeti, për periudhën kohore janar 2017-28 shkurt 2020. Për vitin 2017 dhe 2018 vlera e këtij mjeti është pjesë e vlerës së aktiveve në pasqyrat financiare në llogarinë 215 Mjete transporti, si rrjedhojë e transferimit nga viti në vit të vlerës së tij 1,980,000 lekë në këto pasqyra.
Me shkresën nr. 846/1 prot., datë 04.05.2020, me lëndë "Dërgohet informacion", drejtuar grupit të auditimit, dërguar e skanuar nga Bashkia Skrapar, konstatohet se në tabelën e vendndodhjes së mjeteve, për mjetin Land Rover L....8, me vlerë fillestare 1,980,000, është bërë përshkri ndodhet në vendin e quajtur "Fusha e Kadiut" dhe nuk është në gjendje pune. Ky dokument është nënshkruar nga nga Drejtori ekonomik z. N. G., Specialiste e menaxhimit të aseteve znj. H. B..
Në datën 27.04.2020, nëpërmjet imelit zyrtar në adresën e z. B. M. dhe z. H. A., nga Drejtori ekonomik z. N. G., Specialiste e menaxhimit të aseteve znj. H. B., e cila është edhe kryetare e komisionit të inventarizimit për vitin 2019, si dhe komisioni i inventarizimit të vitit 2019 znj. X. L., E. S., T. H., S. M., është dërguar informacioni, me lendë "Për mjetet në inventar të bashkisë të cilat nuk ekzistojnë", në të cilin përshkruhet se katër mjetet e mësipërme nuk gjenden, nuk ekzistojnë. Për arsye se ka dy informacione kontradiktore, grupi i auditimit merrë të mirëqënë, informacionin që përshkruan komisioni i inventarizimit, pasi vetëm ky komision, bazuar në urdhrin e titullarit dhe në UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", harton të dhënat për procesin e inventarizimit, deklaron për diferencat që konstaton, gjendjen e aktiveve etj.,dheështë përgjegjës direkt për rezultatet e inventarizimit.
Në qoftëse njësia vendore do të gjeje një nga mjetet e mësipërme, e cila edhe pse mund të jetë për shitje për skrap, por vetëm pasi komisioni të vërtetojë se përputhen të dhënat si numri i shasisë, tipi, targa etj. dhemjeti në gjendje të dëmtuar të jetë bërë hyrje në magazinë, atëherë pasi të kryhet shitjae skrapit, kjo vlerë ti zbritet vlerës që duhet të zhdëmtoj personi përgjegjës material.

Për sa më sipër, për humbjen fizike të mjetit tip Fadrom Fermec 865 me vlerë kontabël 3,228,000 lekë dhe automjetin Land Rover L....8, me vlerë kontabël 1,980,000 lekë, mban përgjegjësi personi përgjegjës material z.A. H.,ish punonjës i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, njësi vartëse e Bashkisë Skrapar, me detyrë ish ekonomist, ndërprerë marrëdhëniet e punës me urdhrin nr.63, datë 10.12.2015
Për periudhën 2017-2019, u konstatua se nga Bashkia Skraparë, nuk është kryer inventarizimi i plotë i mjeteve të transportit sipas Llogarisë 215 "Mjete Transporti" nga komisionet e inventarizimeve, pasi 4 mjetet e mësipërme nuk janë përfshirë në këtë proces. Nga drejtori i financës, vlera në bilan është marrë e mirëqenë nga viti i mëparshëm, pa u siguruar më parë të administrojë të gjitha kartelat e inventarizimit të mjeteve për llogarinë 215, dhe pa bërë ballafaqimin e gjendjes kontabël që ka me gjendjen fizike të evidentuar nga komisionet e inventarizimit.
Për katër mjetet e mësipërme për periudhën objekt auditimi 2017-209, Bashkia Skrapar nuk disponon asnjë dokument lidhur me këto mjete, përveçse i ka formalisht në gjendjen kontabël, nuk ka fletë inventari, nuk ka person përgjegjës material dhe nuk ka dijeni për ekzistencën fizike të tyre.

Kthim përgjigje të observacioneve për Projektraportin e auditimit, nga z.H. B. me detyrë Inspektore e Menaxhimit të Aseteve.

***Kundërshti nga subjekti i audituar**: Për sa më sipër janë bërë kundërshti nga znj.H. B., për Projektraportin e auditimit ku në mënyrë të përmbledhur thuhet:*
1……Nuk më është dorëzuar asnjë document në lidhje me makinat e transferuara nga ish komunat në vitin 2015. Këtë fakt e tregon gjithë dokumentacioni që u është dorëzuar disa herë.
***2…...**I qëndroj faktit që regjistri i kontratave të qirasë të lidhura nga bashkia është më të gjitha kërkesat*
*3…..Kundërshtoj pikën 6 në fq.57, **Keni cituar që nuk është kryer inventarizimi i plotë i mjeteve të transportit**, ndërkohë që keni gjithë informacionin dhe dokumentacionin e duhur që mjetet e tranportit nga ish komunat nuk janë futur asnjëherë në inventarin e bashkisë, por janë dorëzuar nga komisioni përkatës direkt në Drejtorinë e Shërbimeve, gjë e cila vërtetohet nga proçesverbalet e dorëzimit të mjeteve në 2015, të cilat jua kam vënë në dispozicion edhe gjatë kohës së auditimit në bashkinë Skrapar, edhe me observacionet, si dhe jua kam dërguar edhe të skanuara me e-mail.*
***Shtoj këtu që mjeti tip makinë , me vlerë 2.880.000 lekë që ka qënë në pronësi të ish komunës Zhepë**, për të cilën kemi dhënë informacion që mungon, në fakt ndodhet në vendin e quajtur "Fusha e Kadiut", brenda rrethimit të kompanisë TAP, tërësisht e dëmtuar.*
***Qëndrimi i grupit të auditimit:** Nga grupi i auditimit kundërshtimet e subjektit merren pjesërisht në konsideratë pasi:*
1.....Për sa i përket mos dorzimit tek Ju të dokumenteve të mjeteve të transportit nuk qëndron, pasi marrja e detyrës bëhet me proces verbal midis dorëzuesit dhe marrësit në dorëzim, dokument të cilin Ju nuk na e paraqitët gjatë auditimit. Për kryerjen e procesit të inventarizimit duhej të merrnit nga financa listën e mjeteve të transportit, gjëndjen kontabile të tyre dhe të gjithë aktiveve pastaj të fillonit inventarizimin konkret, për të ballafaquar gjendjen kontabël me gjendjen fizike.
2.....Për sa i përket regjistrit të kontratave të qirasë, qëndron vetëm fakti se Ju e keni mbajtur si regjistër, por ai nuk është i plotësuar me të gjitha të dhënat e kërkuar e sidomos nuk është plotësuar kartelë për cdo pasuri të dhënë me qira dhe nuk është plotësuar kolona për arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik, në kundërshtim me pikën 31/d të udhëzimit të mësipërm.
3.....Për sa i përket inventarizimit të mjeteve të transportit dhe veçanërisht 4 mjeteve të dëmtuara dhe të pa inventarizuara nga ana Juaj, është sqaruar me observacionet e z.N. G. e konkretisht; Bazuar në dokumentet e fletëve të inventarizimit të aktiveve, për periudhën objekt auditimi,u konstatua se nuk është kryer inventarizimi i plotë i mjeteve të transportit sipas Llogarisë 215 "Mjete Transporti" nga komisionet e inventarizimeve. Gjatë inventarizimit nuk janë evidentuar, nuk janë pasqyruar në fletët e inventarit katër mjete e konkretisht, Mjeti tip Ford Tranzit me vlerë fillestare 400,000 lekë, transferuar nga ish bashkia Corovodë, Mjeti tip Fadrom me vlerë fillestare 2,498,500 lekë, transferuar nga ish Komuna Qendër, Mjeti tip Fadrom Fernec me vlerë fillestare 3,280,000 lekë, transferuar nga ish Komuna Çepan dhe Automjetin Land RoverL....8, me vlerë fillestare 1,980,000 lekë. Me kërkesë të vazhdueshme të grupit të auditimit për gjetjen e personave përgjegjës të këtyre katër mjeteve të transportit është përcaktuar përgjegjësia se kush persona i ka në ngarkim në periudhën para transferimit të të drejtave dhe detyrimeve sipas VKM nr.510,datë 10.06.2015"Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe

detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuar, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësit e qeverisjes vendore të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial".
Personat përgjegjës të këtyre katër mjeteve sipas dokumenteve bashkangjitur observacionit janë:
Për mjetin tip Ford Tranzit me vlerë fillestare 400,000 lekë, transferuar nga ish bashkia Corovodë, personi përgjegjës është z.F. Z., sipas një flete inventari të vitit 2016 të nënshkruar prëj tij dhe të sjellë nga Bashkia Skrapar nëpërmjet observacioneve.
Për mjetin tip Fadrom me vlerë fillestare 2,498,500 lekë, transferuar nga ish Komuna Qendër, personi përgjegjës është z.B. B., sipas një flete inventari të vitit 2014 të nënshkruar prëj tijë dhe të sjellë nga Bashkia Skrapar nëpërmjet observacioneve.
Për mjetin tip Fadrom Ngarkues vetëlëvizës Fermec 865, me numër shasie V.....Y, me vlerë fillestare 3,228,000 lekë, transferuar nga ish Komuna Çepan, personi përgjegjës është z. A. H., sipas një proces verbali të datës 05.08.2015 mbajtur midis përfaqsuesve të NjA Çepan, komisionit të Bashkisë të ngritur për zbatimin e VKM nr.510,datë 10.06.2015"Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve ,personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuar, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësit e qeverisjes vendore të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial" dhe marrësit në dorëzim z. A. H. në atë periudhë me detyrë ekonomist në Ndërmarrjen e Shërbimeve. Kopje e këtij proces verbal ndodhet bashkangjitur observacioneve, të sjellë nga Bashkia Skrapar.
Për AutomjetinLand RoverL....8, me vlerë fillestare 1,980,000 lekë, viti i prodhimit 1994, me numër shasie S.....5, blerë nga ish komuna Zhepë më datën 23.06.2010, në vlerën 1,980,000 lekë, transferuar nga ish Komuna Zhepë. Personi përgjegjës është z.A. H., sipas një proces verbali të datës 07.08.2015 mbajtur midis përfaqësuesve të NjA Zhepë, komisionit të Bashkisë të ngritur për zbatimin e VKM nr.510,datë 10.06.2015"Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve ,personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuar, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësit e qeverisjes vendore të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial" dhe marrësit në dorëzim z.A. H. në atë periudhë me detyrë ekonomist në Ndërmarrjen e Shërbimeve. Kopje e këtij proces verbali ndodhet bashkangjitur observacioneve, të sjellë nga Bashkia Skrapar.
Personat kryesor përgjegjës për menaxhimin e aktiveve janë Nëpunësi i Autorizuar dhe Nëpunësi Zbatues dhe persona menaxherial të tjerë të cilët në rastin konkret është komisioni i inventarizimeve. Observacioni merret pjesërisht në konsideratë dhe u bënë rregullimet përkatëse në raportin përfundimtar të auditimit, kurse për pjesën që nuk janë kryer inventarizimi për periudhën objekt auditimi nuk merret në konsideratë.

Për mos kryerjen e inventarizimit të plotë të llogarisë 215 Mjete transporti, duke mos përfshirë në këtë proces inventarizimit e 4 mjeteve të mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi z. N. G., me detyrë Drejtor Ekonomik, si dhe komisionet e inventarizimit për periudhën 2017-2019, sipas emrave në urdhrat e mëipërm të ish titullarit për ngritjen e këtyre komisioneve. Gjithashtu, për periudhën 2017-2019, katër mjetet e mësipërme nuk janë përfshirë as në procesin e inventarizimit të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, e cila i ka pasur në përdorim këto mjete (ndërsa si gjendje kontabël i ka Bashkia). Për këtë mangësi ngarkohet me përgjegjësi, Përgjegjësi i Financës së Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike,njësi vartëse e Bashkisë, z. V. N., i cili ka vepruar në kundërshtim me nenin nr. 12 të ligjit 10296

datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ku përcaktohet se nëpunësi zbatues ka për detyrë "...ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar".
Nga z. A. H. dhe z.F. Z., përpara ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, nuk është bërë prej tyre dorëzimi me procesverbal i mjetit (aktivit) që kanë pasur në ngarkim.
Gjithashtu z. B. B., aktualisht në marrëdhënie pune, nuk vërteton dorëzimin e mjetit që ka pasur në ngarkim, as në ish komunën Qendër as në Bashkinë Skrapar.
Veprimet dhe mos veprimet e mësipërme lidhur me mos dorëzimin e aktiveve dhe humbjen e tyre, ngarkojnë me përgjegjësi personat e mësipërm material dhe janë në kundërshtim me pikat 12, 13, 23 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

D.1. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike.

Nga AK Bashkia Skrapar është hartuar regjistri i parashikimit të prokurimeve publike për vitin dhe 2017, 2018 dhe 2019, i cili është raportuar në APP në sistemin elektronik si dhe në degën e thesarit. Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë më parë kërkesat nga secili sektor përfitues i mallit, punës apo shërbimit të planifikuar. Janë bërë konsultime me komunitetin për përparësinë e investimeve. Vlerat e prokurimeve janë ne përputhe me buxhetin dhe te mbështetura me fonde buxhetore. Nuk ka shpenzime shume vjeçare. Për sa më sipër u krahasuan vlerat e regjistrit të prokurimeve me vlerat e miratuara në buxhet për secilin prokurim. Gjithashtu u verifikua kohëzgjatja e secilit investim. Urdhrat e prokurimit janë vulosur në thesar, përpara fillimit të procedurës së prokurimit. U verifikua lista e investimeve të kryera dhe konstatohet se nuk ka angazhime buxhetore të pa miratuara në këshillin bashkiak.
Ka pasur ndryshime ne regjistrin e prokurimeve ne vlera dhe ne numër procedurash dhe kanë qene te mbështetura me fonde buxhetore përkatëse përpara se te bëhej ndryshimi, duke u miratuar më parënë këshillin bashkiak.
Regjistri i realizimit të prokurimeve reflekton sakte prokurimet e kryera gjate vitit.
Bashkia Skrapar për periudhën 2017-2019 ka zhvilluar gjithsej 50 procedura prokurimi me vlera të larta, me vlerë të fondit limit 323,265,787 lekë, vlerë të kontratës 282,653,542 lekë, diferencë midis tyre prej 40,612,245 lekë.
Të ndara sipas viteve, procedurat e zhvilluara dhe mbulimi me auditim, si vijon:
Për vitin 2017: Bashkia Skrapar ka zhvilluar gjithsej 24 procedura prokurimi me vlera të larta, me vlerë të fondit limit 210,872,800 lekë, vlerë të kontratës 195,481,906 lekë, diferencë midis tyre prej 15,390,894 lekë. Nga procedurat e zhvilluara, për sa i përket auditimit të hartimit të kritereve të DST, kualifikimit të operatorve ekonomik dhe shpalljes së fituesit, janë audituar 12 procedura në vlerën e fondit limit 185,212,287 lekë, vlerë të kontratës 175,082,125 lekë, diferencë midis tyre prej 10,130,162 lekë. Shprehur në përqindje për vitin 2017, janë audituar 50% e numrit të procedurave të zhvilluara, e cila përbën 87% e vlerës së procedurave të zhvilluara për fondin limit dhe 89% e vlerës së kontratave të lidhura për këtë vit.
Përsa i përket zbatimi të kontratave të punimeve, për vitin 2017 janë audituar tre kontrata, vlera totale e të cilave është89,994,314 lekë, ose 46% e vlerës së kontratave të lidhura.
(këto kontrata bëjnë pjesë te 12 procedurat e mësipërme, pra për të cilat është audituar edhe zhvillimi i procedurës). Gjithashtu si pjesë e periudhës së vitit 2017, janë audituar edhe 2

kontrata punimesh, procedura e të cilave është zhvilluar në vitin 2016, por zbatimi i kontratës është kruer gjatë vitit 2017. Këto dy kontrata janë: "*Rikualifikim i hapsirave perreth pallatit te Kultures,rruga me trafik tekufizuar/pedonalja "Pasho Hysi",rruga automobilistike "Pasho Hysi*", me vlerë220,586,682 lekë pa TVSH dhe "*Rehabilitimi i kanalit ujitës Vendreshe dega e majt dhe e djathtë*", me vlerë të kontratës 29,195,883 lekë pa TVSH. Pra në total për vitin 2017 janë audituar Pesë kontrata punimesh në vlerën totale të kontratës prej 339,776,879 lekë.

Për vitin 2018: Bashkia Skrapar ka zhvilluar gjithsej 15 procedura prokurimi me vlera të larta, me vlerë të fondit limit 57,995,602 lekë, vlerë tëkontratës 43,074,563 lekë, diferencë midis tyre prej 14,921,039 lekë. Nga procedurat e zhvilluara, për sa i përket auditimit të hartimit të kritereve të DST, kualifikimit të operatorve ekonomik dhe shpalljes së fituesit (pra zhvillimit të procedurës), janë audituar 5 procedura në vlerën e fondit limit 33,980,574 lekë, vlerë të kontratës 21,560,289 lekë, diferencë midis tyre prej 12,420,285 lekë.Shprehur në përqindje për vitin 2018 janë audituar 33% e numrit të procedurave të zhvilluara, e cila përbën 59% e vlerës së procedurave të zhvilluara për fondin limit dhe 50% e vlerës së kontratave të lidhura për këtë vit.

Përsa i përket zbatimi të kontratave të punimeve, për vitin 2018 janë audituar dy kontrata, me fond limit 24,488,246 lekë, ose 42% e vlerës së fondit limit për kontratat e lidhura. Vlera e dy kontratave të audituara është 15,048,689 lekë, ose 35 % e vlerës së kontratave të lidhura.

(këto kontrata bëjnë pjesë te 5 procedurat e mësipërme, pra për të cilat është audituar edhe zhvillimi i procedurës).

Për vitin 2019: Bashkia Skrapar ka zhvilluar gjithsej 11 procedura prokurimi me vlera të larta, me vlerë të fondit limit lekë 54,397,385 lekë, vlerë të kontratës 44,097,073 lekë, diferencë midis tyre prej 10,300,312 lekë. Nga procedurat e zhvilluara, për sa i përket auditimit të hartimit të kritereve të DST, kualifikimit të operatorve ekonomik dhe shpalljes së fituesit (pra zhvillimit të procedurës), janë audituar 3 procedura në vlerën e fondit limit 30,941,912lekë, vlerë të kontratës 22,491,623 lekë, diferencë midis tyre prej 8,450,289 lekë. Shprehur në përqindje për vitin 2019 janë audituar 27 % e numrit të procedurave të zhvilluara, e cila përbën 57% e vlerës së procedurave të zhvilluara për fondin limit dhe 51% e vlerës së kontratave të lidhura për këtë vit.

Përsa i përket zbatimi të kontratave të punimeve, për vitin 2019 nuk ka kontrata të audituara.

Nga 50 procedurat e zhvilluara për periudhën 2017-2019, për sa i përket auditimit të hartimit të kritereve të DST, kualifikimit të operatorve ekonomik dhe shpalljes së fituesit (pa përfshir zbatimin e kontratave të punimeve), janë audituar gjithsej 20 procedura në vlerën totale të fondit limit 250,134,773 lekë, vlerë të kontratës 219,134,037 lekë, diferencë midis tyre prej 31,000,736 lekë.

Mbulimi me auditim për të gjithë periudhën e audituar 2017-2019 (pa përfshirë dy kontratat e lidhra në vitin 2016 e të zbatuara në vitin 2017) shprehur në përqindje: janë audituar 40% e numrit të procedurave të zhvilluara, ose 77% e vlerës së procedurave të zhvilluara si për fondin limit edhe për vlerën e kontratave të lidhura. Përzgjedhja e procedurave të auditimit u bë bazuar në madhësinë e vlerës së kontratës, por jo vetëm, është pasur parasysh edhe rrisku lidhur me natyrën e objektit të prokurimit, si në rastin e blerjes së mjetit të transportit tip kamion, pasi nisur nga auditimie të tjera të mëparshme, këto objekte prokurimi kanë rezultuar me rrisk të lartë, pavarësisht vlerës së fondit limit.

Për zbatimin e kontratave të punimeve janë audituar 7 kontrata, në vlerën e lidhjes së kontratës 354,825,568 lekë. Dy nga këto kontrata në vlerën totale prej 249,782,565 janë

lidhur në vitin 2016, por janë zbatuar në vitin 2017. Përzgjedhja e kontratave për auditim u bë bazuar në vlerën e kontratës dhe natyrën e investimit.

Anomalitë e konstatuara në fushën e prokurimeve publike kanë të bëjnë me këto element: a) hartimin e dokumenteve standarde të tenderit, ku përfshihen llogaritja e fondit limit dhe hartimi i kritereve të vecanta të DST, b) kualifikimin e operatorve ekonomik dhe shpalljen e fituesit, c)zbatimin e kontratave të punimeve.

a) anomalitë në hartimin e dokumenteve standarde të tenderit (mos mbajtja e procesverbalit për argumentimin e kritereve, vendosje kriteresh të cilat nuk kanë lidhje me natyrën dhe vlerën e kontratës).

Për vitin 2017 nga 12 procedurat e audituara, janë konstatuar me shkelje për hartimin e dokumenteve standarde të tenderit shtatë procedura, me vlerë të fondit limit 80,229,463 lekë, të cilat përbëjnë 58% të numrit të procedurave të audituara, ose 43% të fondit limit të këtyre procedurave. Shprehur në lidhje me numrin dhe vlerën e procedurave të zhvilluara, këto anomali zënë 29% tënumrit tëprocedurave të zhvilluara, ose 38% tëvlerës sëtyre.

Për vitin 2018 nga pesë procedurat e audituara, janë konstatuar me shkelje për hartimin e dokumenteve standarde të tenderit dy procedura, me vlerë të fondit limit 24,488,246 lekë, të cilat përbëjnë 40% të numrit tëprocedurave të audituara, ose 72 % të fondit limit të këtyre procedurave. Shprehur në lidhje me numrin dhe vlerën e procedurave të zhvilluara, këto anomali zënë 13% të numrit të procedurave të zhvilluara, ose 42 % të vlerës së tyre. Gjithashtu në vitin 2018 janë konstatuar edhe tre procedura prokurimi në hartimin e kritereve të të cilave nga njësia e prokurimit nuk është mbajtur procesverbali për këtë qëllim. Vlera e fondit limit për këto procedura është 9,492,328 lekë.

Për vitin 2019 nga tre procedurat e audituara, në vlerën e fondit limit 30,941,912lekëjanë konstatuar me shkelje për hartimin e dokumenteve standarde të tenderit dy procedura, me vlerë të fondit limit 29,202,634 lekë, të cilat përbëjnë67% të numrit të procedurave të audituara, ose 94 % të fondit limit të këtyre procedurave. Shprehur në lidhje me numrin dhe vlerën e procedurave të zhvilluara, këto anomali zënë 18% të numrit të procedurave të zhvilluara, ose 54 % të vlerës së tyre.

Gjithashtu në vitin 2019është konstatuar edhe një procedurë prokurimi në hartimin e kritereve të së cilës nga njësia e prokurimit nuk është mbajtur procesverbali për këtë qëllim. Vlera e fondit limit për këto procedura është 1,739.278 lekë.

b) anomalitë në kualifikimin e operatorve ekonomik dhe shpalljen e fituesit

Për vitin 2017 nga 12 procedurat e audituara, janë konstatuar me shkelje për mos zbatimin e kuadrit rregullator në fuqi lidhur me kualifikimin e operatorve ekonomik dhe shpalljen e fituesit, katër procedura prokurimi në vlerën e fondit limit 23,129,743lekë, të cilat përbëjnë30 % të numrit të procedurave të audituara, ose 12% të fondit limit të këtyre procedurave. Shprehur në lidhje me numrin dhe vlerën e procedurave të zhvilluara, këto anomali zënë 17% të numrit të procedurave të zhvilluara, ose 11 % të vlerës së tyre. Tre nga katër procedurat e mësipërme duhet të ishin anulluar, duke qënë se asnjë nga OE nuk plotëson kriteret e vendosura në DST, ndërsa në një rast është s'kualifikuar OE I cili nuk plotëson kriteret e vendosura në DST dhe është kualifikuar OE i cili nuk I plotëson këto kritere, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 48,000 lekë për shkak të diferencës së ofertave dhe përdorim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet, për shkak se OE i kualifikuar ka paraqitur një mjet mjet i cili është jashtë kritereve të DST përsa i përket vitit të prodhimit I cili është 1977, ndërkohë që në DST është kërkuar një mjet i vitit 1990 e mbrapa.

Për vitin 2018 nga pesë procedurat e audituara, janë konstatuar me shkelje për mos zbatimin e kuadrit rregullator në fuqi lidhur me kualifikimin e operatorve ekonomik dhe shpalljen e fituesit, tre procedura prokurimi, në vlerën e fondit limit 11,30,59 lekë, të cilat përbëjnë 60 %

të numrit të procedurave të audituara, ose 33% të fondit limit të këtyre procedurave. Shprehur në lidhje me numrin dhe vlerën e procedurave të zhvilluara, këto anomali zënë 20% të numrit të procedurave të zhvilluara, ose 19 % të vlerës së tyre.
Për vitin 2019 nga tre procedurat e audituara, janë konstatuar me shkelje për mos zbatimin e kuadrit rregullator në fuqi lidhur me kualifikimin e operatorve ekonomik dhe shpalljen e fituesit, dy procedura prokurimi, në vlerën e fondit limit 3,032,912 lekë, të cilat përbëjnë 67 % të numrit të procedurave të audituara, ose 10% të fondit limit të këtyre procedurave. Shprehur në lidhje me numrin dhe vlerën e procedurave të zhvilluara, këto anomali zënë 18% të numrit të procedurave të zhvilluara, ose 6 % të vlerës së tyre.
c) anomalitë nëzbatimin e kontratave të punimeve
Përsa i përket zbatimit të kontratave të punimeve është konstatuar një dëm ekonomik në vlerën 2,357,654 lekë, nga e cila 2,160,111 lekë i përkasin vitit 2017, ndërsa vlera 197,543 lekë vitit 2018.
Të dhëna të hollësishme për procedurat e zhvilluara dhe të audituara jepen në aneksin nr. 4 në fund të raportit të auditimit.

Në 13 raste hartimi i kritereve të vecanta të DST, është bërë në mënyrë të pa argumentuar. Janë konstatuar kritere të pa lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, vlerën dhe natyrën e kontratës, si dhe nuk është mbajtur procesverbali për argumentimin e tyre.

Titulli i Gjetjes:	Në shumicën e procedurave të audituara, nuk është mbajtur procesverbal për hartimin e kritereve të veçanta të DST, si dhe një pjesë e kritereve të vendosura nuk janë të argumentuara dhe nuk janë të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, vlerën dhe natyrën e kontratës.
Situata:	***1. Procedura e prokurimit me objekt "Rikonstruksion i Shkolles 9 –Vjeçare "Kahreman Ylli" Corovodë", me vlerë të fondit limit 52,83,363 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 22.06.2017.*** *Anomalitë e konstatuara në hartimin e DST:* Dokumentet e tenderit janë hartuar nga njësia e prokurimit, sipas urdhrit të prokurimit nr. 50, datë 19.04.2017tëish titullarit të AK Z. N. S.. • Nga njësia e prokurimit nuk është mbajtur proces-verbalë për hartimin e kritereve të veçanta të DST, si dhe nuk janë argumentuar këto kritere. • Në rubrikën Liçensa profesionale e shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, të kritereve të veçanta të DST, është kërkuar që OE të paraqesin: N.P- 1 A Punime gërmimi ne toke. N.P-5 A Punime nëntokësore, ura e vepra arti N.S- 19 A Sistemet kundra zhurmëspër infrastrukture. Bazuar në VKM nr. 42 datë 16.01.2008, "*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe proçedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi"*, të cilat japin shpjegimet për secilën nga licencat e mësipërme, konstatohet se këto licenca nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit, në preventiv nuk ka zëra që të kenë lidhje me licencat në fjalë. • Në rubrikën "Deklarimi i drejtuesve teknik", është kërkuar se ofertuesi duhet të deklarojë drejtuesit teknik të objektit, të cilët duhet të jenë të punësuar pranë kësaj kompanie, me një eksperience pune jo me pak se 5 vjet … Deklarata të shoqërohet me CV, kontratën e punës dhe diploma, të Drejtuesve Teknik, si më poshtë: Ing. ndërtimi, inxhinier topograf, inxhinier mjedisi, inxhinier elektrik, inxhinier mekanik, inxhinier hidroteknik, inxhinier gjeolog. Kriteri 5 vjet si eksperiencë pune është i pa argumentuar, i pa mbështetur në bazë ligjore,

diskriminues, nuk nxit, por frenon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre.
Të gjithë drejtuesit teknik të licencuar, janë të barabartë përsa i përket pjesëmarrjes në tender, pavarësisht nga përvoja që kanë.

- Në rubrikën "Dëshmi për fuqinë mesatare punëtore të operatorit ekonomik", është kërkuar se operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar si dhe te përfshire ne listëpagesat e shoqërisë

Saldator te pajisjeve nen presion 5 (pese); Mekanik 3tre); Karpentier 5(pese).
Kriteret e mësipërme janë të pa nevojshme, të pa argumentuara dhe nuk kanë lidhje me objektin e kontratës, pasi në preventivë nuk ka zëra pune të cilët të kenë lidhje me nevojën për saldatorin, mekanikun, apo karpentierin.

- Gjithashtu në këtë rubrikë është kërkuar se të gjithë specialistet e mësipërm te jene te pajisur me certifikatë kualifikimi të lëshuar nga IQT apo subjektet të tjera të autorizuara dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë per 7 muajt e fundit (për periudhën shtator 2016- mars 2017). Kriteri se punonjësit duhet të jenë në listëpagesat e shoqërisë për 7 muajt e fundit, është i pa nevojshëm, i pa mbështetur ligjërisht. E rëndësishme është që te jenë në listëpagesë, pa vendosur afate kohore.

- Në pikën nr.10 të kritereve të veçanta të DST është kërkuar që OE të paraqesin:

Raport Testim te Materialeve Ineret Granil,Metoda e Tesimit S SH EN 933- 1; 1997. Metoda e Tesitimit S SH EN 1097-6-2000
- Raport Testimi te materialeve Inerte Rere e Lare Metoda e Testimit S SH EN 933- 1; 1997. Metoda e Testimit S SH EN 1097-6-2000
- Testimet e materialeve Inerte duhet te jene nga Laborator i akredituar konformë S SH ISO/EN 17025;2006
- Raport Testimi nga Impianti i Prodhimit metoda e e testimit SSH EN 12390 -1: 2000 , SSH – EN 12390 – 3 : 2000 për mostrën e betonit. - Raport i testimeve duhet te jete 9 muajt e fundit.

Pra për të gjitha raportet e mësipërme është kërkuar që të jenë kryer 9 muajt e fundit, kriter i cili nuk lidhet me asnjë argument konkret dhe nuk mbështetet në bazë ligjore përsa i përket afatit 9-mujor. Po nëse raportet do të ishin 10 apo 11 muajt e fundit, cili është argumenti ligjor, apo teknik se nuk janë të vlefshëm?
Nuk është argumentuar numri i mjeteve dhe fuqisë punëtore të kërkuar (100 punonjës).

- Në rubrikën 10 të kritereve të veçanta të DST, është kërkuar:"Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet te disponojnë: Impiant prodhim Betoni me QKL, 1 cope nëpronësi ose me qera: Impiant prodhim Inertesh me QKL, 1 cope në pronësi ose me qera.

Vendosja e këtij kriteri është përjashtues, pasi duhet të përfshinte edhe variantin kur OE kanë lidhur kontratë furnizimi me një impiant, pa qenë e nevojshme ta kenë në pronësi apo me qira.
Pas përfundimit të akt konstatimeve, nga subjekti janë bërë kundërshti të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit në fazën e projekt raportit të auditimit, por për mungesë të fakteve dhe argumenteve ligjore nuk janë marrë parasysh.

2. *Procedura e prokurimit me objekt "Furnizimi me ujë i fshatit Gradec", me fond limit 12,163,586 lekë, zhvilluar në datën 11.08.2017.*

Anomalitë e konstatuara në hartimin e DST:
Dokumentet e tenderit janë hartuar nga njësia e prokurimit, sipas urdhrit të prokurimit nr. 75, datë 26.05.2017 tëish titullarit të AK Z. N. S..

- Nga auditmi konstatohet se kriteret e veçanta të DST të hartuara nga njësia e prokurimit nuk janë argumentuar, nuk është mbajtur procesverbal për këtë qëllim.
- Gjithashtu konstatohet se janë vendosur kritere të cilat nuk kanë lidhje me objektin dhe

natyrën e kontratës si vijon:
Në DST, kriteret e veçanta të kualifikimit, rubrika 2.3 -Kapaciteti teknik, pika (f), është kërkuar:
- Certifikate ISO 39001:2012 (e vlefshme) (Certifikon qe sistemi i Menaxhimit te sigurisë se trafikut rrugor për kompanin), ndërkohë që objekti i prokurimit nuk ka lidhje me sigurimin e trafikut rrugor.
- Në pikën (g) të kësaj rubrike është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik: Ing mekanik 1 person, por nga auditimi i preventivit nuk konstatohen zëra punimesh të cilat të justifikojnë nevojën për inxhinier mekanik.

Pas përfundimit të akt konstatimeve, nga subjekti janë bërë kundërshti të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit në fazën e projekt raportit të auditimit, por për mungesë të fakteve dhe argumenteve ligjore nuk janë marrë parasysh.

3.*Procedura e prokurimit me objekt "Rikonstruksion i Rrugës Alush Grepcka"me fond limit 25,679,034 lekë, zhvilluar në datën 17.2.2017.*

Anomalitë e konstatuara në hartimin e DST:

Dokumentet e tenderit janë hartuar nga njësia e prokurimit, sipas urdhrit të prokurimit nr. 5, datë 23.01.2017tëish titullarit të AK Z. N. S..

- Në kriteret e veçanta të DST, Rubrika 2.3. -Kapaciteti teknik, pika (f), është vendosur kriteri: OE duhet të paraqesin -Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, si më poshtë:

Punime të përgjithshme ndërtimi:
N.P - 1 - B Punime gërmimi në tokë.
N.P - 2 - B Ndërtime civile dhe industriale.
N.P - 4 - B Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale.
N.P - 5 - B Punime nëntokësore, ura e vepra arti.
N.P - 11 -B Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
N.P - 12 - B Punime të inxhinierisë së mjedisit.

Punime speciale ndërtimi:
N.S -1- B Punime për prishjen e ndërtimeve.
N.S- 3- B Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).
N.S-7 - B Barriera dhe mbrojtje rrugore.
N.S-8 - B Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri.
N.S- 14- B Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
N.S-18- B Punime topogjeodezike.
N.S-20- B Shpime gjeologo-inxhinierike,

Nga auditimi konstatohet se vendosja e kriterit për nivelin B të licencave të mësipërme është i pa argumentuar, nuk lidhet me vlerën e kontratës. Baza ligjore që trajton licencat e mësipërme është VKM nr. 42 date 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe proçedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi". Në kreun V - Mënyra e klasifikimit të shoqërive, pika 1- Klasifikimi i shoqërive, germa (a) thuhet:

Shoqëria vendoset paraprakisht në nivelin (klasën) e pasqyruar në lidhjen nr.4, ku përfshihet vlera e punimeve të kryera gjatë 4 viteve të fundit për kategorinë që klasifikohet.

Në lidhjen 4 të VKM së mësipërme thuhet:

Niveli i shoqërisë sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi:
A(edhe për herë të parë): 0- 20 milion lekë; B: 21- 50 milion lekë; C: 51 - 100 milion lekë; D: 101 - 200 milion lekë; E: 201 - 400 milion lekë: F: 401 - 800 milion lekë; G: mbi 800 milion lekë.

Është shumë e qartë se kategoria B për një licencë të caktuar, kërkohet nga autoriteti kontraktor, në rastin kur vlera e zërit të punimeve në preventiv, e cila lidhet me këtë licencë, ka vlerën nga 21- 50 milion lekë. Por nga auditimi i preventivit konstatohet se kjo vlerë është shumë më e ulët se vlerë 21 milion lekë. Edhe për licencat e tjera të kërkuara në DST, është e njëjta situatë, asnjë zë në preventivin e hartuar nga AK, nuk e kalon vlerën 21 milion lekë. Për këtë arsye kriteri për nivelin B të licencave të mësipërme nuk lidhet me vlerën e kontratës, pra është i pa argumentuar.

- Gjithashtu në rubrikën e mësipërme është kërkuar licenca N.S- 3- B -Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues), e cila nuk ka lidhje me objektin e kontratës, pasi nuk ka në preventive zëra punimesh që të lidhen me nevojën e kësaj licence, pra kjo licencë nuk është e lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese dhe natyrën e kontratës.

Bazuar në VKM nr. 42 date 16.01.2008, shpjegimi për këtë kategori licence është:
"*N.S-3 Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)*
Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve transportuese, ashensorë, shkallë të lëvizshme, ngritëse dhe të transportit, komplet dhe të lidhur me çdo punim murature plotësuese ose ndihmëse që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme".

- Në kriteret e veçanta të DST, Rubrika 2.4, është vendosur kriteri si vijon:

Operatori ekonomik ofertues duhet te ketë certifikata cilësie ne gjuhen shqipe, ose të përkthyera dhe te noterizuara. Në këtë kriter midis të tjerash është kërkuar:
- çertifikata EN-ISO 3834-2:2005 mbi "Kushtet e cilësisë për shkrirjen e metaleve (Klasifikimi ne produktet e salduara)
- çertifikata ISO 5001:2011 mbi "Certifikimi i sistemit për menaxhimin e energjisë".

Vendosja e kriterit për administrimin e dy certifikatave të mësipërme është i pa argumentuar dhe nuk ka lidhje me objektin dhe natyrën e kontratës.

- Në kriteret të veçanta të DST pika 2.6 është kërkuar që OE të kenë të punësuar <u>një inxhinier pyjesh.</u>

Vendosja e këtij kriteri është e pa argumentuar dhe nuk ka lidhje me objektin dhe natyrën e kontratës. Nuk ka në preventiv asnjë zë punimi që të lidhet me nevojën e inxhinierit të pyjeve.

- Në kriteret të veçanta të DST, pika 2.6, shkronja (d), është vendosur kriteri:

*"Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet te ketë ne stafin e tij minimalisht **20 punonjës** te pajisur me dëshmi nga IQT ose ekuivalente me te, te cilët të figurojnë në listëpagesa".*

Në hartimin e këtij kriteri nuk është përcaktuar se çfarë specialiteti duhet kenë 20 punonjësit e kërkuar. Duke hartuar kritere të pa qarta, njësia e prokurimit jo vetëm është në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, por krijon vështirësi për operatorët ekonomik në përgatitjen e dokumentacionit prej tyre, si dhe krijon vështirësi për KVO gjatë vlerësimit të ofertave, pasi operatorë të ndryshëm paraqesin dokumentacion të ndryshëm, sepse duke mos u përcaktuar specialiteti, nuk është përcaktuar as dokumenti që duhet paraqitur. Në këtë rast nga njësia e prokurimit është vepruar në kundërshtim me kërkesat e pikës nr.5 të nenit 26- Kontratat për punë publike të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Në kriteret të veçanta të DST, pika 2.7, është vendosur kriteri:
"*Duke pasur parasysh që objekti që prokurohet kërkon dhe mbjelljen e pemëve dekorative,*

Operatori ekonomik duhet të jete i pajisur me licence për prodhim fidanësh kodi II. 4".
Nga auditimi konstatohet se në preventiv është parashikuar të mbillen 82 pemë dekorative me lartësi 3.5 m. Ky kriter është i pa argumentuar, i pa nevojshëm, përjashtues, sepse nuk është e nevojshme që OE i cili është i specializuar në fushën e ndërtimit të rrugëve, të këtë si aktivitet edhe tregtimin e pemëve dekorative. Pemët operatori i blen lehtësisht në tregun e shitjes së tyre. Që të sigurohet për cilësinë e pemëve, autoriteti kontraktor mund të kërkojë që OE fitues të shoqërojë pemët e kërkuara me një dokument të caktuar (qoftë edhe licence për prodhim fidanësh) të cilin e merrë te shitësi i tyre, por jo detyrimisht këtë dokument duhet ta ketë vetë ofertuesi.
Pas përfundimit të akt konstatimeve, nga subjekti janë bërë kundërshti të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit në fazën e projekt raportit të auditimit, por për mungesë të fakteve dhe argumenteve ligjore nuk janë marrë parasysh.
4.Procedura e prokurimit me objekt "Punime rikonstruksioni të disa segmenteve të rrugëve rurale, Bashkia Skrapar", me fond limit 9,378,945 lekë, zhvilluar në datën 31.03.2017.
Anomalitë e konstatuara në hartimin e DST:
Dokumentet e tenderit janë hartuar nga njësia e prokurimit, sipas urdhrit të prokurimit nr.27, datë 08.03.2017tëish titullarit të AK Z. N. S..

- Në kriteret e veçanta të DST, rubrika 2.3-Kapaciteti teknik, është vendosur kriteri se OE duhet të paraqesin: Liçenca profesionale e shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës me kategoritë:

NP–1 Punime gërmimi në tokë, NP-4 Rrugë autostrada, ura, mbikalime,etj, NP-5 Punime nëntokësore, ura e vepra arti, NP-12 Punime të inxhinierisë së mjedisit, NS-18 Punime topo-gjeodezike, NS-19 -Sistemet kundra zhurmës për infrastrukturë. Për të gjitha licencat e mësipërme nuk është përcaktuar kategoria e licencës (e cila duhet të ishte kategoria A)

- Gjithashtu kriteri për licencën NS-19 -Sistemet kundra zhurmës për infrastrukturë, është i pa argumentuar dhe nuk ka lidhje me natyrën e kontratës, pasi në objektin e prokurimit nuk ka zëra punimesh të cilët të kenë lidhje me nevojën e licencës së mësipërme.

Baza ligjore që trajton licencat e mësipërme është VKM nr. 42 date 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe proçedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi". Në këtë VKM, kuptimi për licencën N.S - 19 jepet si më poshtë:
N.S - 19 Sistemi i mbrojtjes nga zhurmat në infrastrukturë:
Konsiderohet ndërtimi dhe vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe verifikimi akustik i objektit për zhurmën me origjinë rrugore, hekurudhore, të barrierave metalike betonarme, dru xham, ose material plastik transparent, të mureve dopio, të mureve poroze ose të tullave poroze, gjithashtu edhe të veshjeve izoluese të pareteve të terrenit ose të tuneleve.

- Në kriteret e veçanta të DST, rubrika 2.3-Kapaciteti teknik, pika "g", është vendosur kriteri se OE duhet të paraqesin:

g. Për efekt te kryerjes se punimeve në tërësi, ofertuesi duhet te ketë me kontrate pune te rregullt Inxhinier Mekanik 1 (nje). Ky kriter është i pa argumentuar dhe nuk ka lidhje me natyrën e kontratës, pasi në objektin e prokurimit nuk ka zëra punimesh të cilët të kenë lidhje me nevojën e inxhinierit mekanik.

- Në kriteret e veçanta të DST, rubrika 2.3-Kapaciteti teknik, pika e- Dëshmi per mjetet e pajisjet teknike, është vendosur kriteri që OE të paraqesin dokumentacion për të vërtetuar se kanë "*Nyje per prodhimin e inerteve 1 cope Pronësi ose me Qera*". Kriteri është jo i plotë pasi duhet të parashikohej edhe alternativa e kontratës së furnizimit.

Nuk janë dhënë argumentime për numrin e kërkuar të punonjësve (30), për numrin e makinerive etj.
Pas përfundimit të akt konstatimeve, nga subjekti janë bërë kundërshti të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit në fazën e projekt raportit të auditimit, por për mungesë të fakteve dhe argumenteve ligjore nuk janë marrë parasysh.

5. Procedura e prokurimit me objekt "Rehabilitimi i kanalit Ujites "Rog- Zaberzan", me fond limit 12,078,754 lekë, zhvilluar në datën 06.04.2017.
Anomalitë e konstatuara në hartimin e DST:
Dokumentet e tenderit janë hartuar nga njësia e prokurimit, sipas urdhrit të prokurimit nr.6, datë 23.01.2017 tëish titullarit të AK z. N. S..

- Në kriteret e veçanta të DST, rubrika 2.3. -Kapaciteti teknik: pika d.4, është kërkuar - *Certifikate ISO 22000:2005 (Certifikon Sigurinë ushqimore mbi punonjësit).* Kriteri për këtë certifikatë është i pa argumentuar, i pa nevojshëm, pasi nuk ka lidhje me objektin e kontratës. Çertifikata është e vlefshme për fushat e mëposhtme të aplikimit: prodhim i konservave bimore, perimeve dhe ullinjve të marinar. Tregtim i konservave të frutave dhe perimeve të marinuara. Pra nuk ka lidhje me objektin e kontratës.
- Në kriteret e veçanta të DST, rubrika 2.3. -Kapaciteti teknik: pika (f) është kërkuar: *një Ing mekanik*, por nga auditimi i preventivit nuk konstatohet të ketë zëra punimesh të cilët të lidhen me nevojën e inxhinierit mekanik. Ky kriter nuk ka lidhje me objektin e kontratës.
- Në kriteret e veçanta të DST, rubrika 2.3. -Kapaciteti teknik: pika (i), midis të tjerash janë kërkuar *fadrome 3 cope; kamionçina 5 copë, kamion 3 copë*, për të cilat nuk ka argumentim për numrin e tyre të kërkuar, i cili krahasuar me volumin e punimeve konsiderohet i ekzagjeruar. Gjithashtu nuk janë përcaktuar kapacitetet e mjeteve të mësipërme (element i nevojshëm i cili kushtëzohet nga volumi i punimeve, grafiku dhe afati i tyre), e cila tregon për një përcaktim të pa studiuar dhe të pa argumentuar të numrit të makinerive. Ky numër duhet të ishte përcaktuar duke analizuar volumin e punimeve të kontratës, kohëzgjatjen e punimeve, kapacitetin e makinerive që do të kërkohej në DST, kohën e angazhimit për 24 orë të secilës makineri.
- Po në këtë rubrikë është kërkuar nga operatorët ekonomik:

Makineri për prodhimin e elementeve të betonit 1 copë.
Për makinerinë e prodhimit të elementeve të betonit duhet te paraqitet kontratë qiraje/ blerje,skema teknologjike e makinerisë të jete e paisur me leje mjedisore nga QKL, vërtetim zhdoganimi si dhe certifikata ISO për prodhim elementesh... Si dhe të ketë miratim nga drejtoria e standardeve për prodhimet sipas standardit sshen1339:03, qe te vërtetohet kjo duhet fatura e blerjes nga drejtoria e standardeve.
Vendosje e këtij kriteri nuk është i plotë, sepse është përjashtuar alternativa e lidhjes së kontratës së furnizimit me një operatorë ekonomik i cili të plotësoj këto kritere të vendosura për makinerinë e prodhimit të elementeve të betonit.
Vendosja e këtij kriteri nuk ka lidhje me objektin e kontratës, pasi në preventiv nuk ka asnjë zë punimi i cili do të ndërtohet me elementë betoni (pra elementë të cilët prodhohen dhe vendosen në vepër si elementë të gatshëm)
Në preventiv është zëri "Struktura monolite betoni 16/20 me trashësi 8-10cm, në sasinë 30 m3 dhe për këtë duhej kërkuar beton e jo elemente betoni.

Pas përfundimit të akt konstatimeve, nga subjekti janë bërë kundërshti të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit në fazën e projekt raportit të auditimit, por për mungesë të fakteve dhe

argumenteve ligjore nuk janë marrë parasysh

6. Procedura e prokurimit me objekt "Ndërtim vepra arti ne segmentet e rrugëve rurale, Zaberzan Poshte - Zaberzan Lart, Blezencke - Prishte, Qeshibec - Sternec, Bashkia Skrapar" me fond limit 9,878,155 lekë, zhvilluar më 31.03.2017.

Anomalitë e konstatuara në hartimin e DST:

Dokumentet e tenderit janë hartuar nga njësia e prokurimit, sipas urdhrit të prokurimit nr.30, datë 17.03.2017tëish titullarit të AK z. N. S..

- Nga njësia e prokurimit nuk është mbajtur procesverbal për hartimin e kritereve të veçanta të DST, si dhe nuk janë argumentuar këto kritere (janë kërkuar 30 punonjës, por nuk është përcaktuar profili i tyre, sa inxhinier dhe të kujt profili duhen, janë kërkuar 5 kamionë, 2 kamionçina, etj. pa argumente përkatëse).
- Në kriteret e veçanta të DST, rubrika Liçenca profesionale, janë kërkuar licencat e mëposhtme, por pa përcaktuar nivelin e tyre (i cili duhej të ishte niveli A):

NP–1 Punime gërmimi në tokë; NP-4 Rrugë autostrada, ura, mbikalime,etj; NP-5 Punime nëntokësore, ura e vepra arti; NP-12 Punime të inxhinierisë së mjedisit.

Pas përfundimit të akt konstatimeve, nga subjekti janë bërë kundërshti të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit në fazën e projekt raportit të auditimit, por për mungesë të fakteve dhe argumenteve ligjore nuk janë marrë parasysh.

***7.Procedura e prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i rruges se fshatit Munushtir" me fond limit* 18,583,333 *lekë, zhvilluar më* 31.03.2018.**

Anomalitë e konstatuara në hartimin e DST:

Dokumentet e tenderit janë hartuar nga njësia e prokurimit, sipas urdhrit të prokurimit nr.4, datë 12.02.2018tëish titullarit të AK Z. N. S..

- Vihet re se në te gjitha kriteret e hartuara në rubrikën e kritereve të veçanta të DST, NJP nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Konkretisht:

- OE të kenë mesatarisht të punësuar 70 punonjës për periudhën (Janar 2017 – Dhjetor 2017). Ky numër punonjësish rezulton i lartë krahasuar me vlerën e punimeve të preventivuara dhe me natyrën e punimeve që do të kryen pasi ato nuk rezultojën të jenë komplekse.
- OE të kenë 1 (një) inxhinier mekanik. Ky kriter është i panevojshëm pasi natyra e punimeve nuk parashikon punime për të cilat nevojitet inxhinier mekanik.

OE të kenë karpentier 5 punonjës. Ky kriter është ekzagjerues pasi NJHDT mund të ishte mjaftuar duke vendosur si kriter paraqitjen e vetëm me 1 (një) karpentier dhe jo 5 të tillë për kryerjen e punimeve sipas preventivit të miratuar.

Për veprimet dhe mosveprimet, lidhur me anomalitë e konstatuara në hartimin e kritereve të veçanta të DST në 7 procedurat e mësipërme të prokurimit, ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJP të cilët kanë hartuar DST: znj. R. L., kryetare (juriste), me detyrë drejtore e drejtorisë juridike dhe njësisë së burimeve njerëzore, z. E. Y., anëtar, me detyrë specialist për prokurimet publike në sektorin e shërbimeve ligjore dhe prokurimeve, z. V. M., anëtar, me profesion inxhinier ndërtimi, me detyrë ish specialist në drejtorinë e planifikimit dhe zhvillimit të teritorit, ndërprerë marrëdhëniet e punës.

8. ***Procedura e prokurimit me objekt "Sistemim i ambienteve të jashtëm dhe terrenet sportive të shkollës Ramis Aranitasi", me fond limit 27,909,000 lekë , zhvilluar në datën 28.10.2019.***

Anomalitë e konstatuara në hartimin e DST:
Dokumentet e tenderit janë hartuar nga njësia e prokurimit, të cilat janë firmosur prej tyre.

- Për hartimin e kritereve të veçanta të DST, nga Njësia e prokurimit është hartuar procesverbali nr. s'ka, datë 16.09.2019, por në këtë procesverbal nuk është dokumentuar argumentimi i asnjë prej kritereve të veçanta të DST.
- Në kriteret e veçanta të DST, Rubrika 2.3. -Kapaciteti teknik, pika nr.3.a, është vendosur kriteri:OE duhet të vërtetojnë se numri mesatar i punonjësve për periudhën e fundit 6 mujore nuk duhet të jetë më i ulët se **50** (pesëdhjetë)...Kjo të dëshmohet me Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën e sipërpërmendur e të shoqërohet me list-pagesat e plotësuara rregullisht sipas formularit të përcaktuar E-SIG 025/a dhe formularët e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore, shëndetësore e TAP, me vulë banke.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e formularëve të deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore, shëndetësore e TAP, me vulë banke, është e pa argumentuar, e pa nevojshme, pasi AK duhet të kërkojë vërtetime nga organet tatimore për pagesën e detyrimeve për sigurimet shoqërore, shëndërsore TAP etj. Ngarkimi në sistem nga OE të formularve të deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore, shëndetësore e TAP, me vulë banke, është një volum i konsiderueshëm dokumentash, i cili zëvendësohet me vërtetimin e organeve tatimore, i cili është një dokument i vetëm dhe në përputhje edhe me kërkesat e LPP, neni 45.

- Në kriteret e veçanta të DST, Rubrika 2.3. -Kapaciteti teknik, pika nr.3.c dhe pika nr.4, është vendosur kriteri: Përveç specialisteve te disiplinave te sipërpërmendura, në listpagesë për 6 mujorin e fundit duhet të rezultojnë të punësuar...jo më pak se tre saldatorë me eksperiencë pune mbi 10 vjet, të pasqyruar ne librezën e punës.

Operatori ekonomik duhet te përcaktoje me një deklarate te administratorit te shoqërisë Drejtuesin/Drejtuesit teknik te punimeve ne objekt do te jete/jene i/te pranishëm gjate gjithë kohës qe do te kryhen punimet ne objekt, i cili/ te cilët të kenë eksperience pune jo me pak se 10 vjet.

Për punonjësit e mësipërm vendosja e kriterit "me eksperiencë pune mbi 10 vjet", është i pa argumentuar, i pa mbështetur në bazë ligjore, diskriminues, nuk nxit, por frenon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, veprim në kundërshtim me nenin nr.1 "Objekti dhe qëllimi", pika (c) dhe (ç), neni 20 "Mosdiskriminimi", të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin public", i ndryshuar. Të gjithë punonjësit janë të barabartë përsa i përket pjesëmarrjes në tender, pavarësisht nga përvoja që kanë. Çështja e përvojës së operatorëve ekonomik, si koncept trajtohet nga neni 26 i VKM 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe ka të bëjë me përvojën në punë të ngjashme. LPP, VKM apo akte të tjera të dala në zbatim të LPP nuk trajtojnë çështjen e përvojës së punonjësve. Përderisa nuk trajtohet nga kuadri rregullator i fushës së prokurimit publik, njësia e prokurimit nuk ka tagër për vendosjen e këtij kriteri. Në rast se do ta vendos, duhet konkretisht të argumentoj bazën ligjore ku mbështetet në lidhje me përvojën 10 vjeçare.

Kundërshti nga subjekti i audituar: *a)Përsa mës sipër janë bërë kundërshti nga z. A. L.dhe znj. S. H., anëtar të NJP, ku në mënyrë të përmbledhur thuhet:*
Nuk jemi dakord me audituesin i cili thot se është i gabuar fakti që nga NJP është kërkuar që OE të paraqesin formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore e shëndetësore me vulë banke, pasi në nenin 45 të LPP përcaktohet se cdo operatorë ekonomik skualifikohet nëse nuk ka përmbushur detyrimet për pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëdetsore.
b) Nuk jemi dakord me audituesin i cili shprehet se: Në kriteret e veçanta të DST, Rubrika 2.3.

-Kapaciteti teknik, pika nr.3.c dhe pikën nr.4, është vendosur kriteri:..., si dhe jo me pak se tre saldatore me eksperiencë pune mbi 10 vjet, të pasqyruar ne librezën e punës. Operatori ekonomik duhet te përcaktoje me nje deklarate te administratorit te shoqërisë Drejtuesin/Drejtuesit teknik te punimeve ne objekt do te jete/jene i/te pranishëm gjate gjithë kohës qe do te kryhen punimet ne objekt, i cili/ te cilët të kenë eksperience pune jo me pak se 10 vjet dhe te jete i pajisur me diplome, kontrate pune dhe CV. Për punonjësit e mësipërm vendosja e kriterit "me eksperiencë pune mbi 10 vjet", është i pa argumentuar, i pa mbështetur në bazë ligjore, diskriminues, nuk nxit, por frenon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, veprim në kundërshtim me nenin nr.1 "Objekti dhe qëllimi", pika (c) dhe (ç), neni 20 "Mosdiskriminimi", të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin public", i ndryshuar.

Ne si NJP gjykojmë se në zbatim të nenit 46 të LPP b)aftësia teknike:operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikime te nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personeline nevojshëm, për të zbatuar kontratën,siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin objektit të kontratës". Për këtë arsye NJP ka vendosur kriterin "eksperiencë pune mbi 10 vjet" për drejtuesit teknik, si dhe për specialistët saldator, duke e konsideruar si kriter për besueshmërinë dhe përvojën e duhur, pasi punimet janë parashikuar të kryhen brenda oborrit të shkollës, në kohën kur këtu kryhet mësim. Kjo kërkesë jep garanci për sigurinë në punë dhe kruerjen e punimeve pa dëmtuar shëndetin e nxënësve apo procesin mësimor. Nga ana tjetër, mos përcaktimi i vjetërsisë së punonjësve si kriter kualifikues, apo diskriminues në aktet ligjore të prokurimit publik, nuk e pengon autoritetin kontraktor, të vendos si kriter kërkesën për punonjës të kualifikuar dhe me përvojën e nevojshme.

***Qëndrim i grupit të auditimit**: a) Kërkesa për paraqitjen e formularve të deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore e shëndetësore është e pa nevojshme. Në zbatim të nenit 45 të LPP, Ju duhet të kërkoni një vërtetim të lëshuar nga organet tatimore i cili të vërtetojë se janë shlyer detyrimet për sigurimet shoqërore, shëndetësore, TAP etj. Kjo është e mjaftueshme. Për këtë pikë kundërshtia juaj nuk merret parasysh.*

b)Për këtë çështje janë dhënë shpjegimet në akt konstatim dhe në projektraport. Kriteret në fjalë nuk janë të argumentuara. Drejtuesit teknik, bazuar në VKM nr.42, datë 16.1.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", drejtuesi teknik i shoqërisë është personi me arsimin universitar përkatës (përcaktuar në lidhjen nr.5) dhe me përvojë pune jo më pak se 5 vjet nga diplomimi. Për personat që kanë mbaruar universitetin me mesatare note nga 9.0 e lart ose ekuivalent (për studime të përfunduara në shtete të huaja) afati të jetë jo më pak se 3 vjet nga diplomimi. Pra këta drejtues teknik janë certifikuar nga komisione të posacme, janë paisur me licence të posaçme dhe, menjëherë pasi kësaj janë të barabartë më të gjithë të tjerët, edhe pse janë licensuar më parë. Nuk ka tagër NJP të kategorizojë drejtuesit teknik sipas përvojës së tyre, në varësi me tenderin që prokurohet. E njëjta logjik është edhe për specialistët, ata janë të paisur me dokumentacionin e kërkuar dhe, pavarësisht nga përvoja nuk mund të kategorizohen nëse janë të përshtatshëm për një tender të caktuar dhe nuk janë të përshtatshëm për një tender tjetër. As LPP dhe asnjë akt tjetër në funksion të fushës së prokurimeve publike nuk trajtojnë një gjë të tillë. Madje e ndalojnë, sipas bazës ligjore që është përmendur më sipër. Për arsye se për këtë çështje nuk keni fakte dhe argument të reja, kundërshtia juaj nuk merret parasysh.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJP të cilët kanë hartuar DST, sipas urdhrit të prokurimit nr.36, datë 13.09.2019:z. A. L., me detyrë drejtor i drejtorisë së zhvillimit të territorit, kadastër mjedisit dhe ujitjes, z. D. H., me detyrë ish

specialist i emergjencave civile, ndërprerë marrëdhëniet e punës, znj.S. H. me detyrë inspektore mjedisi.

9.Procedura e prokurimit me objekt "Rikonstruksion i zyrave te Njësisë Administrative Qendër & Ndërmarrjes Shërbimeve Publike" me fond limit 7,717,656 lekë, zhvilluar më 02.02.2017.

Anomalitë e konstatuara në hartimin e kritereve të DST

Njësia e prokurimit (NJP) është ngritur me urdhrin nr. nr.1, datë 13.01.2017, e përbërë nga znj. E. H., juriste, znj. L. H., me arsim të lartë, z. A. H. me arsim të lartë. DST janë firmosur nga të tre anëtarët e njësisë së prokurimit. Për hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit të OE, është mbajtur procesverbali nr. ska, datë 13.01.2017, i cili është hartuar dhe firmosur nga z. N. K., me arsim të mesëm teknik ndërtimi (pra jo nga anëtarët e NJP).

Nga auditimi nuk konstatohet urdhër nga titullari për caktimin e kryerjes së kësaj detyre nga z. N. K., mangësi që ngarkon me përgjegjësi z. M. K., me detyrë ish drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike (njësi vartëse e Bashkisë Skrapar), në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, (ndërprerë marrëdhëniet e punës), pasi prej tij është vepruar në kundërshtim me nenin 56 -Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku thuhet:

Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrit të prokurimit. ... Ai duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit.

Nga z. N. K. nuk është bërë argumentimi i kritereve të veçanta të DST.

- Në kriteret e veçanta të DST, rubrika 2.3 - Kapaciteti teknik, janë kërkuar një numër i caktuar certifikatash ISO, si: Çertifikate te cilësisë se punimeve për ndërtime civile ISO 9001-2008; Çertifikate e menaxhimit te mjedisit ISO 14001-2004; Çertifikate mbi kushtet e sigurisë dhe shëndetit të punonjësve OHSAS 18001-2007; Çertifikate për Sistemet e Integruar te menaxhimit mbi sigurinë rrugore PASS 99:2012. Për këto certifikata nuk janë dhënë argumente për arsyen e vendosjes së tyre në kriteret e veçanta të DST.
- Në DST është kërkuar: Operatori ekonomik duhet te ketë ne stafin e tij një ekspert zjarrfikës te licensuar nga organet kompetente. Vendosja e këtij kriteri nuk ka lidhje me objektin e kontratës, pasi nuk ka asnjë zë në preventive për nevojën e zjarrfikësit.
- Janë kërkuar 6 punonjës të specializuar ndërtimi, por pa përcaktuar specialitetin, gjithashtu thuhet se numri maksimal i punonjësve duhet të jetë 15, por kur bëhet përshkrimi i tyre sipas profesioneve dalin më shumë se 15 punonjës.

Në DST është kërkuar vinç me krah (12 - 16) m, por objekti që do të restaurohet është me një kat dhe nevoja e krahut të vinçit është e pa argumentuar, e ekzagjeruar, nuk lidhet me objektin e natyrën e kontratës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi z. N. K., në cilësinë e hartuesit të kritereve të veçanta të DST, me detyrë teknik ndërtimi, si dhe titullari i AK z. M. K..

***10. Procedura e prokurimit me objekt "Blerje Rruli ", me fond limit* 2,083,333 *lekë, zhvilluar me* 24.02.2017.**

Dokumentet e tenderit janë hartuar nga njësia e prokurimit, sipas urdhrit të prokurimit nr.5, datë 13.02.2017 të Drejtorit të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, z. M. K..

Anomalitë e konstatuara në hartimin e kritereve të DST

- Në dosjen e prokurimit nuk ndodhet asnjë dokumentacion i vlefshëm për përllogaritjen e vlerës së limit të kontratës në kundërshtim me nenin 59 të VKM 914 datë 29.12.2014, i ndryshuar, pika 1.

Dosja e prokurimit përmban vetëm një dokument tip me emërtimin Proces-Verbal, i pa protokolluar, mbi përcaktimin e fondit limit të objektit "Blerje Rruli", me datë 10.02.2017 i firmosur nga z. N. K. i cili është përcaktuar sipas Urdhërit të Titullarit anëtar i KVO në kundërshtim të neneve 58 dhe 61 pika 2 të VKM 914. Në dokument thuhet se përcaktimi i vlerës së kontratës nga AK është bazuar në manualet e MPPTT, çmimet e botuara nga INSTATI-i dhe në VKM 629 datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit ...", si dhe ato të tregut.

Gjithcka më lart për përcaktimin e fondit limit është fiktive, pasi VKM 629 datë 15.07.2015 nuk bënë fjalë cmimet e mjeteve, gjithashtu nuk ka asnjë dokumentacion që të vërtetohet se është studiuar tregu dhe janë marrë oferta, apo ndonjë referencë konkrete të INSTAT. Ky dokument ka pamjen e një formati tip i përdorur nga AK për përcaktimin e vlerës së fondit limit dhe në rastin konkret nuk ka asnjë bazë ligjore dhe asnjë dokumentacion shoqërues mbi përcaktimin e vlerës së FL për mallin e prokuruar nga AK.

- Mungon në dosjen e prokurimit Formularët e deklarimit të konfliktit të interesave nga ana e NJHDT pasi nga ana e njësisë ky formular është plotësuar vetëm një herë në fillim të vitit për të gjithë procedurat e zhvilluara gjatë 2017.
- Për te gjitha kritereve e vendosura në DST, nga njësia e prokurimit nuk është bërë argumentimi, arsyet e vendosjes së tyre, në kundërshtim me pikën nr.2 të nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Nga auditimi i kritereve të veçanta të kualifikimit dhe i specifikimeve teknike të DST konstatohet se AK ka përcaktuar ndër të tjera si më poshtë:

Specifikime teknike kryesore te mjetit :

Rruli duhet të jetë e tipit gjysme levizese me shasi te artikulluar,hidraulik.

Marka e mjetit te jete DYNAPAC CC211 viti i prodhimit 1992 - 1993

Pesha e mjetit duhet te jete 7500 kg – 12000 kg.

Gjatesia e mjetit 4m-6m

Përcaktimi i markës së mjetit për të cilin po kryhet tenderi, është në kundërshtim me nenin 23 pika 5 e LPP .

11. Procedura e prokurimit me objekt: Blerje kamioni për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, Bashkia Skrapar, me fond limit 1,250,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në 04.05.2017.

Anomalitë e konstatuara në hartimin e kritereve të DST

Dokumentet e tenderit janë hartuar nga njësia e prokurimit, sipas urdhrit të prokurimit nr.14 datë 20.04.2017 të Drejtorit të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, z. M. K..

Në dosjen e prokurimit nuk ndodhet asnjë dokumentacion i vlefshëm për përllogaritjen e vlerës së limit të kontratës në kundërshtim me nenin 59 të VKM 914 datë 29.12.2014, i ndryshuar, pika 1.

Dosja e prokurimit përmban vetëm një dokument tip me emërtimin Proces-Verbal, i pa protokolluar, mbi përcaktimin e fondit limit të objektit "Blerje kamioni" me datë 19.04.2017, i firmosur nga z. N. K. i cili është përcaktuar sipas Urdhrit të Titullarit edhe anëtar i KVO në kundërshtim të neneve 58 dhe 61 pika 2 të VKM 914. Në dokument thuhet se përcaktimi i vlerës së kontratës nga AK është bazuar në manualet e MPPTT, çmimet e botuara nga INSTATI-i dhe në VKM 629 datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit ..." dhe ato të tregut.

Mungon në dosjen e prokurimit Formularët e deklarimit të konfliktit të interesave nga ana e NJHDT pasi nga ana e njësisë ky formular është plotësuar vetëm një herë në fillim të vitit për të gjithë procedurat e zhvilluara gjatë 2017.

- Për te gjitha kritereve e vendosura në DST, nga njësia e prokurimit nuk është bërë argumentimi, arsyet e vendosjes së tyre, në kundërshtim me pikën nr.2 të nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Nga auditimi i kritereve të veçanta të kualifikimit dhe i specifikimeve teknike të DST konstatohet se AK ka përcaktuar markën e mjetit *M. B.*

Përcaktimi i markës së mjetit për të cilin po kryhet tenderi është në kundërshtim me nenin 23 pika 5 e LPP. Vendosja e këtij kriteri krijon diskriminim për OE e tjerë prezent në treg për ofrimin e këtij malli si dhe nuk është në përputhje me LPP i cili ka si qëllim nxitjen e pjesëmarrjes, konkurencës si dhe trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik bazuar kjo në nenin 1 të LPP.

Për veprimet dhe mosveprimet, lidhur me anomalitë e konstatuara në hartimin e kritereve të veçanta të DST në 2 procedurat e mësipërme të prokurimit, ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJP të cilët kanë hartuar DST: znj. E. H., me detyrë juriste e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, njësi vartëse e Bashkisë Skrapar, znj. L. H., me detyrë përgjegjëse e sektorit të gjelbërimit, me arsim të lartë, z. A. H. me arsim të lartë, me detyrë ish përgjegjës i sektorit të pastrimit, ndërprerë marrëdhëniet e punës.

12 Procedura e prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i Zyrave të M.K.Z -së Skrapar", me fond limit 5,904,913 lekë, zhvilluar më 27.04.2018.

Anomalitë e konstatuara në hartimin e DST

Dokumentet e tenderit janë hartuar nga njësia e prokurimit, sipas urdhrit të prokurimit nr.18 datë 16.04.2018, të ish Kryetarit të Bashkisë Skrapar.

- Vihet re se, në te gjitha kritereve e vendosura nga NJP, nuk janë argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Nga kriteret e vendosura nga NJP vihet re kriter i vendosur jo në përputhje me LPP dhe më konkretisht:

- Sipas listpageses për shofera, manovratoret dhe punonjësit në lartësi operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratat e punës dhe *Policat sigurimit për jetën të aksidenteve personale.*Ky kriter është i paargumentuar dhe i panevojshëm pasi nuk parashikohet në nenin 26 të VKM 914, datë 29.12.2014.

Për veprimet dhe mosveprimet, lidhur me anomalitë e konstatuara në hartimin e kritereve të veçanta të DST, ngarkohen me përgjegjësianëtarët e NJP të cilët kanë hartuar DST: znj. R. L., kryetare, juriste, z. E. Y., anëtar, ekonomist, z. A. L. anëtar, inxhinier, me detyrë drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit të teritorit dhe Kadastrës.

13. Procedura e prokurimit me objekt"Blerje ushqimesh për konvitktin e shkollës së mesme " Ramiz Aranitasi", me fond limit 1,293,634 lekë pa TVSH zhvilluar më 08.04.2019.

Anomalitë e konstatuara në hartimin e DST:

- Në të gjitha kritereve e vendosura nga NJP, nuk janë argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, në kundërshtim me pikën 2 të nenit nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

	• Nga kriteret e vendosura nga NJP vihet re se disa prej tyre janë jo në përputhje me LPP, kjo pasi vendosja e tyre krijon mundësi diskriminimi për OE e tjerë prezent në treg për kryerjen e punimeve të përcaktuara nga AK dhe më konkretisht: -Operatori ekonomik te paraqesë licencen kategoria II.1.A.1- "Prodhim përpunim dhe shpërndarje me shumice e ushqimeve për njerëz" te leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit. Licenca duhet të jetë në emër të tij pasi duhet ti përkasë operatorit të interesuar te ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga Autoriteti Kontraktor, ky kriter diskriminon OE e tjerë të pranishëm në treg të cilët mund të paraqesin një kontratë furnizimi me OE të tjerë në formën e BOE të cilët mund të plotësojnë të gjitha kriteret. -Licencë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) për artikullin bukë -Operatori ekonomik të paraqesë Licence leshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL) përartikujt e qumështit dhe nënproduktet e tij, këto kritere janë të panevojshëm pasi penalizon OE të cilët këtë produkt mund ta sigurojnë nëpërmjet kontratave të bashkëpunimit tek OE të tjerë prezent në treg të cilët disponojnë licenzën përkatëse për prodhim dhe tregim të produkteve. -Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standartet në fuqi për sigurinë ushqimore. Vetëdeklarim ku te deklaroje se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore. Ky kriter është i paargumentuar, i panevojshëm dhe i pabazuar në bazë ligjore. ***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJP të cilët kanë hartuar DST:*** znj. M. B. (kryetare), me detyrë inspektore ushqimi, z. E. Y. (anëtar), znj. J. S. (anëtar), përcaktuar në këtë cilësi sipas urdhërit të prokurimit nr.8, datë 25.03.2019 të kryetarit të bashkisë.
Kriteri:	***Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*** - pikën nr.5 të nenit 26- Kontratat për punë publike, nenin 61 pika nr.2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, nenin nr.1 "Objekti dhe qëllimi", pika (c) dhe (ç), neni 20 "Mosdiskriminimi", të ligjit nr.9643,datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
Ndikimi/ Efekti	Mos argumentimi i kritereve, vendosja e tyre jo *në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës,* është mos zbatim i kërkesave ligjore për hartimin e kritereve të DST, nuk motivojnë operatorët ekonomik për pjesëmarrje në tender, duke ulur numrin e tyre në këtë proces, e si rrjedhojë edhe konkurrencën. Në raste të vecanta si vendosja e përvojës 10 vjecare për punonjësit,etj, këto kritere kanë efekt përjashtues për një kategori të caktuar OE.
Shkaku:	Mos zbatim i kuadrit rregullator në fuqi në hartimin e kritereve të veçanta të DST.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim	Në hartimin e kritereve të vecanta DST, njësia e prokurimit të mbaj procesverbal ku të jap argumente për secilin kriter të vendosur. Argumentimi të bëhet duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin, afatin e punimeve, etj., si dhe në kuadrin rregullator në fuqi për fushën e prokurimeve publike.

Në katër raste nga njësia e prokurimit nuk është mbajtur procesverbal për dokumentimin e argumentimit të kritereve të veçanta të DST.

Titulli i Gjetjes:	Mos hartimi procesverbalit për argumentimin e kritereve të veçanta të DST.
Situata:	***1. Procedura e prokurimit me objekt "Ndërtim Lulishte Lagja "5 Shtatori", Corovodë, me***

	fond limit 4,166,648 lekë, zhvilluar më 12.06.2018 *Anomalitë e konstatuara në hartimin e DST* Dokumentet e tenderit janë hartuar nga njësia e prokurimit, sipas urdhrit të prokurimit nr.38, datë 28.05.2018, të ish Kryetarit të Bashkisë Skrapar. • Në të gjitha kritereve e vendosura nga NJP, nuk janë argumentuar arsyet e vendosjes së tyre. Nuk është hartuar procesverbali në të cilin dokumentohet argumentimi i kritereve. ***Për veprimet dhe mosveprimet, lidhur me anomalitë e konstatuara në hartimin e kritereve të veçanta të DST, ngarkohen me përgjegjësi***anëtarët e NJP të cilët kanë hartuar DST: znj. R. L., kryetare, juriste, z. E. Y., anëtar, ekonomist, z. A. L. anëtar, inxhinier, me detyrë drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit të teritorit dhe Kadastrës ***2. Procedura e prokurimit me objekt "Rikonstruksion i kanalit ujitës fshati Strafickë, Bashkia Skrapar", me fond limit 2,486,560 lekë, zhvilluar më 23.04.2018.*** Dokumentet e tenderit janë hartuar nga njësia e prokurimit e cila është ngritur me urdhrin nr.14, datë 05.04.2018, të ish Kryetarit të Bashkisë Skrapar. *Anomalitë e konstatuara në hartimin e DST:* • Në të gjitha kritereve e vendosura nga NJP, nuk janë argumentuar arsyet e vendosjes së tyre. Nuk është hartuar procesverbali në të cilin dokumentohet argumentimi i kritereve. ***3. Procedura e prokurimit me objekt "Rikonstruksion i kanalit ujites HEC-Ujanik Gjerbes, Sistemim dhe mbrojtje nga ujrat e larta, perroi fshatit Gjerbes (faza e dyte)", me fond limit 2,839,120 lekë, zhvilluar më 24.04.2018.*** Dokumentet e tenderit janë hartuar nga njësia e prokurimit e cila është ngritur me urdhrin e prokurimit nr.16, datë 11.04.2018 të ish Kryetarit të Bashkisë Skrapar. *Anomalitë e konstatuara në hartimin e DST:* • Në të gjitha kritereve e vendosura nga NJP, nuk janë argumentuar arsyet e vendosjes së tyre. Nuk është hartuar procesverbali në të cilin dokumentohet argumentimi i kritereve. ***Për veprimet dhe mosveprimet, lidhur me anomalitë e konstatuara në hartimin e kritereve të veçanta të DST në 2 procedurat e mësipërme të prokurimit, ngarkohen me përgjegjësi***anëtarët e NJP të cilët kanë hartuar DST***:*** znj. R. L., kryetare, z. E. Y., anëtar, z. G. M.anëtar. ***4. Procedura e prokurimit me objekt "Ndërtimi i kabinës elektrike per konviktin", me fond limit 1,739,278 lekë pa TVSH, zhvilluar më 15.04.2019.*** • Në të gjitha kritereve e vendosura nga NJP, nuk janë argumentuar arsyet e vendosjes së tyre. Nuk është hartuar procesverbali në të cilin dokumentohet argumentimi i kritereve. Preventivi i punimeve është hartuar nga Ing. H. M., ndërsa projekti është hartuar nga Ing. G. I., ku në dosjen e tenderit nuk ndodhet asnjë dokument që të përcaktoj përse këto subjekte janë ngarkuar apo kontraktuar për hartimin e preventivit dhe projektit. ***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi*** anëtarët e NJP të cilët kanë hartuar DST: znj. J. S. (Kryetare), me detyrë ish Përgjegjëse e Sektorit Juridik, Burimeve Njerëzore dhe Prokurimeve, ndërprerë marrëdhëniet e punës më 30.08.2019, z. E. Y. (Anëtar), z. A. L. (Anëtar), përcaktuar në këtë cilësi sipas urdhrit të prokurimit nr.10 datë 01.04.2018, të ish Kryetarit të Bashkisë Skrapar.
Kriteri:	Pika nr. 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
Ndikimi	Mos hartimi i procesverbalit për argumentimin e kritereve, do të thotë se nuk është bërë një punë e duhur përgatitore për vendosjen e tyre, praktikë e cila jo vetëm është në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, por mbart me vete pasiguri në lidhur me faktin nëse kriteret

	e vendosura në DST, janë të lidhura ngushtë me vlerën dhe natyrën e objektit të prokurimit.
Shkaku:	Mos zbatim i kërkesave ligjore për hartmin e kritereve të veçanta të DST
Rëndësia:	E ulët
Rekomandim	Në të ardhmen, hartuesit e DST, të mbajnë procesverbal për hartimin e kritereve të veçanta të DST, ku të argumentojnë konkretisht vendosjen e secilit kriter. Në rastin e kritereve si numri i punonjësve, numri i makinerive etj, argumentimet të mbështeten në llogaritje konkrete të volumit të punimeve, kapacitetit të makinerive, kohëzgjatjes së punimeve etj.

Për KVO. Në tetë raste, mos anullim i procedurës së prokurimit publik dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik, në kushtet kur asnjë prej tyre të cilat kanë paraqitur oferta, nuk plotëson kriteret e vendosura në DST.

Titulli i Gjetjes:	Anomali të KVO në vlerësimin e ofertave. Mos anullim i tenderit, në kushtet kur asnjë nga OE nuk plotëson kriteret e DST. Kualifikim i operatorit ekonomik i cili nuk plotëson këto kritere.
Situata:	***1. Procedura e prokurimit me objekt "Rehabilitimi i kanalit Ujites "Rog- Zaberzan", me fond limit 12,078,754 lekë, zhvilluar në datën 06.04.2017***. *Vlerësimi i ofertave nga KVO* Për krijimin e komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), nga titullari i AK z. N. S., ka dalë urdhri nr.6/1, datë 23.01.2017, pa nr. protokolli, ku janë përcaktuar: z. J. Ç., me detyrë ish n/kryetar i bashkisë, kryetar i KVO, ndërprerë marrëdhëniet e punës për shkak të daljes në pension, z. N. G., anëtar, me detyrë drejtor ekonomik, z. B. M., anëtar, me detyrë përgjegjës i sektorit të planifikimit, zhvillimit të territorit. Në tender kanë marrë pjesë dhe kanë paraqitur oferta dy OE, si më poshtë:

Nr	Operatorët ofertues	Vlera e ofertës pa TVSH	Kualifikimi nga KVO	NIPT
1	OE: "Z." SHPK	12,008,100	Kualifikuar, fitues	J.....K
2	"B. B." SHPK	11,115,717	S'kualifikuar	K.....H

Arsyet e skualifikimit nga KVO të OE "B. B." SHPK
KVO ka skualifikuar OE "B. B.", SHPK për mangësitë si më poshtë:
- Nuk ka paraqitur certifikatën ISO 22000:2005 kërkuar në DST.
Nga auditimi konstatohet se qëndron ky konstatim i KVO.
- KVO: OE "B. B." SHPK nuk plotëson numrin e fadromave te kërkuar, ka paraqitur 2 nga tre të kërkuar.
Nga auditimi konstatohet se qëndron ky konstatim i KVO, pasi për plotësimin e këtij kriteri është paraqitur:
- Mjeti me targa BR 8... A, marrë me qira nga shoqëria "T.", siguracioni i të cilit skadon më datën 23.03.2017, ndërkohë që tenderi zhvillohet në datën 06.04.2017.
- Mjeti me targa PE 2... A, marrë me qira nga shoqëria "S."& "L." SHPK, për të cilin ka skaduar data e certifatës së kontrollit teknik qysh më 12.02.2017.
- KVO: Për OE "B. B." SHPK mungon makineria e prodhimit te elementeve te betonit si dhe certifikatat ISO te kësaj makinerie.
Nga auditimi konstatohet se qëndron ky konstatim i KVO.

Mbi kualifikimin e OE "Z." SHPK

Nga auditimi konstatohet se ky OE nuk plotëson kriterin për mjekun e shoqërisë, pasi nuk ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar në DST, mungon:

-"Leje individuale për ushtrimin e profesionit të mjekut", e cila është kërkuar në kriteret e veçanta të DST, pika (h) rubrika 2.3. Kapaciteti teknik.

- Nuk plotëson kriterin për inxhinier elektrik, sepse për këtë qëllim ka paraqitur dokumentacion për inxhinier elektronik (për kompjuter) për z. A. A., por në DST është kërkuar inxhinier elektrik.

Gjithashtu kjo diplomë është fotokopje e pa noterizuar, pasi është noterizuar kontrata e punës, bashkangjitur së cilës është fotokopje e diplomës, me vulë të noterit, por pa dokument të këtij të fundit për të shprehur njësimin e fotokopjes me origjinalin.

Diploma e inxhinierit mekanik G. S. dhe diploma e inxhinierit të ndërtimit R. L. janë të pa noterizuara, nuk vërtetohet fotokopja me origjinalin.

Në këto kushte nga KVO duhej të mos ishte kualifikuar OE "Z." SHPK dhe nuk duhej t'i ishte propozuar titullarit në raportin përmbledhës për shpalljen fitues.

Tenderi duhej të ishte anulluar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi *tre anëtarët e KVO:* z. J. Ç., me detyrë ish n/kryetar i bashkisë, ndërprerë marrëdhëniet e punës për shkak të daljes në pension, z. N. G., anëtar, me detyrë drejtor ekonomik, z. B. M., anëtar, me detyrë përgjegjës i sektorit të planifikimit, zhvillimit të territorit.

Kundërshti nga subjekti i audituar: Për vlerësimin e ofertave, nga z. N. G. dhe B. M., janë bërë kundërshti, në të cilat në mënyrë të përmbledhur thuhet: a) z. A. A. është inxhinier elektrik, vërtetuar kjo me CV e tij bashkëlidhur kontratës së noterizuar, ku shprehet se në vitet 196-2002 ka mbaruar Universitetin Politeknik në Tiranë, dega inxhinieri elektrike dhe në vitin 2002 ka mbaruar një vit studimet për inxhinier elektronik. Gjithashtu ka eksperiencë pune si inxhinier elektrik dhe po ashtu vazhdon të punojë.

b) Nuk qëndron pretendimi i audituesit se diploma e inxhinierëve A. A., R. L. dhe G. S. janë fotokopje të pa noterizuara, sepse diplomat janë të vulosura me vulën e noterit, pranë të cilit është bërë kontrata e punës.

Qëndrim i grupit të auditimit*: a) Ajo që përcakton profilin e një punonjësi është diploma, jo CV dhe as kontrata e punës. Bazuar në diplomën nr.3089 të z. A. A., ngarkuar në sistem nga OE "Z.", shpk, vërtetohet se z. A. A. është diplomuar në degën elektronikë dhe i është dhënë titulli inxhinier elektronik, drejtimi kompjutera. Nuk është e vërtetë ajo që pretendoni ju se z. A. A. ka mbaruar në degën inxhinieri elektrike.*

b) Në DST është kërkuar që çdo dokument të jetë origjinal ose fotokopje e noterizuar. Fotokopja është e noterizuar kur noteri, në një dokument të posaçëm, është shprehur me shkrim se fotokopja është e njëvlershme me origjinalin, duke përcaktuar edhe emrin e dokumentit për të cilin shprehet. Mungon një dokument i tillë për punonjësit e mësipërm. Kontrata e punës është bërë përpara noterit, i cili i ka bashkangjitur kontratës edhe fotokopjen e diplomës dhe e ka vulosur, por kjo nuk vërteton njehsimin e fotokopjes me origjinalin (pasi noteri nuk është shprehur për këtë gjë).

Për arsye se nuk keni fakte dhe argumente të reja ligjore, kundërshtitë tuaja nuk merren parasysh.

2. Procedura e prokurimit me objekt"Blerje Rruli", me fond limit 2,083,333 lekë, zhvilluar në datën 24.02.2017.

Vlerësimi i ofertave nga KVO

Me urdhër e titullarit të AK nr. 5 datë 13.02.2017 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) i përbërë nga z.V. N., kryetar , me detyrë Përgjegjës Finance, z.A. M., anëtar, me detyrë P/sektori i mirëmbajtjes, dhe z.N. K., anëtar, me detyrë teknik ndërtimi pranë N.Sh.P.
Në dosjen e prokurimit ndodhet vetëm Raporti Përmbledhës i datës 10.03.2017 i miratuar nga titullari i AK ku:
Nga vlerësimi rezulton se është kualifikuar 1 operator i vetëm pjesëmarës në garë, OE "Q. 0." i cili është shpallur fitues.
OE të kualifikuar.
OE "Q. 0." shpk është kualifikuar dhe shpallur fitues. Nga auditimi i dokumentacionit të operatorit të shpallur fitues dhe vlerësimi i kryer nga KVO rezultojnë këto mangësi:
Në dst është përcaktuar
Furnizime te se njejtes natyre *ne nje vlere* ***40% te fondit limit****, te realizuara ne tre vitet e fundit financiar. Kjo do te vertetohet me dokumentat e meposhtem:*
Kur furnizimi i se njejtes natyre eshte e realizuar me institucione shteterore, Operatori ekonomik do ta vertetoje duke paraqitur Kontraten e nenshkruar me institucionin, te shoqeruar detyrimisht me vertetimin e leshuar nga Institucioni shteteror per realizimin e sukseshem te kesaj kontrate ***ose Fatura tatimore shitje*** *ku te jene shenuar sakte datat, shumat, sasite e mallrave te furnizuara dhe emri e nenshkrimi i personit bleres(ne rastin kur keto furnizime jane realizuar me subjekte private)*
OE ka paraqitur faturën me nr. 10 serial 4.....2 datë 30.01.2017 për shitjen e mallit "Sondë shpimi e përdorur" me vlerë 6000 euro me TVSH. Sipas kursit të këmbimit të asaj periudhe i përcaktuar edhe në faturën tatimore vlerë e saj rezulton të jetë 6,000 x 136.57 = 819,420 lekë e cila është më e vogël se 40 % e fondit limit (40% x 2,083,333= 833,333.20 lekë).
Sipas DST është përcaktuar:
2. Operatori ekonomik duhet te jete i pajisur me leje mjedisore (QKL).Operatori duhet te kete ne pronesi ose me qira Magazine , kjo te pasqyrohet me pamje ku te duket qarte . Kjo pike te jete e verifikueshme nga Autoriteti Kontraktor .Servisi te jete i regjistruar ne Q.K.B.
Në asnjë nga dokumentat e paraqitura në SEP nga OE nuk evidentohet magazina / servisi.

3.Operatori ekonomik duhet te paraqesi certifikate ***ISO 118001-2007*** *per tregetimin e makinerive dhe pajisjeve industriale (e vlefshme)*
4.Operatori ekonomik duhet te paraqesi deshmi nga administrata tatimore per punesimin e jo me pak se 3 punonjeve per periudhen tetor 2015 - Janar 2016 ku te perfshihet Inxhinieri Mekanik si drejtues teknik i kompanise. Duhet te paraqese : Listpagesat, Formularet FDP, Formularet e te ardhurave te punesimit (TAP) dhe mandatpagesat.Per Inxhinierin mekanik duhet te paraqitet kontrata noteriale e punes , si dhe te kete experience pune mbi 5 vjet.
Për kërkesat 3,4 nga ana e OE nuk është paraqitur asnjë dokumentacion ku të vërtetohet pajisja me ISO përkatëse sidhe dokumentacioni i nevojshëm për Inxhinierin mekanik pranë shoqërisë.
Sa më sipër, ky OE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE "Q. 0." shpk, dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. **KVO duhet të kishte anuluar tenderin** pasi nuk jemi në kushtet e plotësimi të kritereve të përcaktuar në nenin 58 të LPP, dhe moskryerja e këtij veprimi

është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar,
Në tenderin me objekt "Blerje rruli", KVO ka kualifikuar dhe propozuar për shpalljen fitues një operatorë ekonomik i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DST, me vlerë të ofertës 2,050,000 lekë pa TVSH., duke vepruar në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi në fushën e prokurimit publik. KVO duhet të kishte s'kualifikuar OE "Q. 0." shpk dhe nuk duhet t'i kishte rekomanduar titullarit shpalljen fitues të tij, duhet të kishte anulluar tenderin, për arsye se operatorët ekonomik pjesëmarrës nuk plotëson kriteret e vendosura në DST.
Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO: z. V. N., kryetar, me detyrë Përgjegjës Finance, z.A. M., anëtar, me detyrë ish përgjegjës i sektorit të mirëmbajtjes rrugëve rurale, ndërprerë marrëdhëniet e punës, z.N. K., anëtar, me detyrë teknik ndërtimi.

3. Procedura e prokurimit me objekt "Rikonstruksion i Zyrave të M.K.Z -së , Skrapar", me fond limit 5,904,913 lekë, zhvilluar më 27.04.2018.
Vlerësimi i ofertave nga KVO
Me urdhër e titullarit të AK nr. 7 datë 16.04.2018 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) i përbërë nga z.S. C., kryetar, me detyrë ish n/kryetar bashkie, ndërprerë marrëdhëniet e punës për shkak të daljes në pension, z.N. G., anëtar, me detyrë P/sek të financës, dhe z.B. M., anëtar, me detyrë P/ sektori në sektorin e Planifikim të Territorit dhe Urbanistikës.
Në dosjen e prokurimit ndodhet vetëm Raporti Përmbledhës i datës 15.05.2018 i miratuar nga titullari i AK ku:
Nga vlerësimi rezulton se janë s'kualifikuar 2 operatorë ekonomik OE "SH. 07"shpk dhe "G. K. M." shpk, dhe kualifikuar 5 operator, OE "A. është shpallur fitues.
Kualifikimet dhe s'kualifikimet jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Oferta në lekë pa TVSH	Kualifikuar/s'kualifikuar
1	A.	4,001,630	Kualifikohet, Fitues
2	E.	4,213,540	Kualifikohet
3	K.	4,428,685	Kualifikohet
4	Sh.	4,878,553	Kualifikohet
5	F.	5,177,370	Kualifikohet
6	"SH. 07"	5,779,720	Skualifikohet
7	G. K. M.	5,644,230	Skualifikohet

Janë s'kualifikuar ofertuesit:
1-"SH. 07"Shpk " ka këto mangësi:
Nuk ploteson piken 2.3 Kapaciteti teknik ne germat a,c,d,e, dhe f,
Nuk ka paraqitur kopje te bilanceve per periudhn 2015,2016,2017
Nuk ka vertetim qe konfirmon shlyerjen e detyrimeve taksave dhe tarifave vendore.
Mungon licenca e shoqerise dhe nuk ka mjetet e kerkuara stafin e kerkuar,
Nuk ka paraqitur deklaraten per kontrata ne proces qe mund te kete ky operator me autoritete te tjera kontraktore.
2-"G. K. M." shpk "ka këto mangësi:
Nuk ploteson pikes 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar,germat a dhe d
Nuk ka pune te natyres se ngjashme,
Nuk ka ka paraqitur specialistet dhe inxhinieret.

Nuk ka deklaruar kontratat e lidhura ne proces.te license shoqerise mungon kategoria NP 12.
OE të kualifikuar.
OE "A." shpk është kualifikuar dhe shpallur fitues. Nga auditimi i dokumentacionit të operatorit të shpallur fitues dhe vlerësimi i kryer nga KVO rezultojnë këto mangësi:
Në kriteret e vendosura në DST është përcaktuar Sipas listpageses Për shofera, manovratoret dhe punonjësit në lartësi operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratat e punës dhe **Policat sigurimit për jetën të aksidenteve personale**
Për këtë kërkesë nga dokumentat e paraqitura në OE konstatohet se nuk është paraqitur asnjë policë sigurimi nga ana e tij edhe pse është vendosur si kërkesë e veçantë nga ana e NJHDT, fakt ky i cili nuk është evidentuar nga ana e KVO.
Sa më sipër, ky OE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE "A." shpk, dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. KVO duhet të kishte anuluar tenderin pasi asnjë nga OE e tjerë të shpallur fitues nuk e plotësojnë kriterin e vendosur nga NJHDT dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë: z.S. C., kryetar, me detyrë ish n/kryetar bashkie, ndërprerë marrëdhëniet e punës për shkak të daljes në pension, z.N. G., anëtar, me detyrë P/sek të financës, dhe z.B. M., anëtar, me detyrë P/ sektori në sektorin e Planifikim të Territorit dhe Urbanistikës.

4. Procedura e prokurimit me objekt "Rikonstruksion i kanalit ujitës fshati Strafickë, Bashkia Skrapar", me fond limit 2,486,560 lekë, zhvilluar më 23.04.2018.
Vlerësimi i ofertave nga KVO
Me urdhër e titullarit të AK nr. 5 datë 05.04.2018 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) i përbërë nga z.S. C., kryetar , me detyrë ish n/kryetar bashkie, ndërprerë marrëdhëniet e punës për shkak të daljes në pension, z.B. Z., anëtar, me detyrë P/sek të Bordit të ujitjes dhe kullimit, dhe z.B. M., anëtar, me detyrë P/ sektori në sektorin e Planifikim të Territorit dhe Urbanistikës.
Në dosjen e prokurimit ndodhet vetëm Raporti Përmbledhës i datës 11.05.2018 i miratuar nga titullari i AK ku:
Nga vlerësimi rezulton se ka skualifikuar një operatorë ekonomik. OE "Q. 0.", dhe kualifikuar 5 operator ku OE "A." është shpallur fitues.
Kualifikimet dhe s'kualifikimet jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Oferta në lekë pa TVSH	Kualifikuar/s'kualifikuar
1	"Q. 0."	1,540,100	Skualifikuar
2	A.	1,675,000	Kualifikohet, Fitues
3	F.	1,712,000	Kualifikohet
4	S.	2,029,375	Kualifikohet
5	Sh.	2,172,050	Kualifikohet
6	E.	2,189,050	Kualifikohet

Është s'kualifikuar ofertuesi:
1-"Q. 0."Shpk **"** ka këto mangësi:
-Nuk ploteson piken 2.3 "Kapaciteti teknik" , germen **"g"** , mungojne certifikatat Iso .
-Nuk ploteson piken 2.3 "Kapaciteti teknik" germa **"a".**Nekontrat pune te ngjashme nuk ka paraqitur faturen tatimore te kerkuar,certifikata e marjes ne dorezim te punimeve mungojne firmat e anetareve te komisionit .

-Nuk ploteson piken 2.3 Kapacitetit teknik germa **"gj",**nuk ka paraqitur dokumentacionin e kerkuarper makinerite kamionet, mungon certifikaten e pronesise,certifikata e kontrollit teknik,vertetimi i pageses per taksat vendore, dhe fotot.

OE të kualifikuar.

OE "A." shpk është kualifikuar dhe shpallur fitues.Me shkresën nr. 100/1 datë 21.05.2018 OE "A." që kërkuar tërheqjen e ofertës me arsyetimin se është në pamundësi të përfundimit të punimeve brenda afatit të caktuar. AK pas administrimit të kërkesës për tëheqje e OE "A." ka nënshkruar kontratën me OE të renditur të dytin si ofertë e vlefshme. Oferta e paraqitur nga OE "F." përmbush kriteret e nenit 58 të LPP pasi diferenca me ofertën e OE "A." është nën 2% të fondit limit.

Lidhur me dokumentacionin e paraqitur nga OE "A." i kualifikuar fillimisht si ofertë fituese u konstatuan mangësitë si më poshtë:

-Në DST është kërkuar "c) *Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2018, pranë njësive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitet*" OE ka dorëzuar vetëm Vërtetim për vitin 2017.

-Dokumentacioni i paraqitur për mjetet e kërkuara sipas DST ka mangësi, mungonë siguracioni për dy mjete dhe foto për një nga mjetet e dorëzuar. Mungojnë fotot për mjetet "Fadromë" dhe "Eskavator".

Lidhur me dokumenacioni e paraqitur nga OE "F." i shpallur fitues dhe lidhur kontrata e sipërmarrjes nga ana e AK nga auditimi rezultoj se:

OE "F." ka lidhur paraprakisht edhe 3 kontrata të mëparshme me Bashkinë Skrapar;

-Rikonstruksion i Shkolles shkolles Vendreshe, lidhur kontrata më datë 04.05.2018 me afat 45 ditë,

-Ndertim kanali ujites Fshati Munushtir, lidhur kontrata më datë 23.05.2018 me afat 45 ditë

-Rikonstruksion i kanalit ujites HEC-Ujanik Gjerbes, Sistemim dhe mbrojtje nga ujrat e larta ,perroi fshatit Gjerbes (faza e dyte), lidhur kontrata me datë 23.05.2018 me afat 45 ditë,

për të cilat ka vënë në dispozicion mjetet e tij. Nga verifikimi i tyre rezulton se mejtet e paraqitura në këtë procedurë janë të angazhuara në procedurat më sipër për të cilat janë lidhur kontrata dhe si rrjedhojë OE "F." nuk plotëson kriterin e vendosur në DST për 2 (dy) kamion.

Për mjetin e paraqitur "Fadromë", *makineria rezuton e paregjistruara dhe e pashoqëruar me leje qarkullimi, certifikatë të kontrollit teknik, dhe policë sigurimi në kundërshtim me përcaktimet e Kodit Rrugor të Republikes së Shqipërië*

Neni 113-Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike,

2. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike duhen regjistruar në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, që i lëshojnë lejen e qarkullimit atij që vërtëton se është pronari i mjetit.

4. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen, duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje, e cila përmban të dhënat e regjistrimit.

Për pajisjen "Motosaldatrice" është paraqitur faturë e biznesit të vogël dhe më konkretisht fatura me nr. 21, Serial 2729022 datë 20.02.2009. Sipas përcaktimeve të DST thuhet se *:"...Faturat qe nuk jane sipas formatit te miratuar me tvsh (faturat e biznesit te vogel) duhet te shoqerohen me kuponin tatimor ..."* për të cilën mungon kuponi tatimor bashkëlidhur faturës.

Sa më sipër, ky OE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE "F." shpk, dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit

shpalljen fitues të tij. KVO duhet të kishte anuluar tenderin pasi nuk jemi në kushtet e plotësimi të kritereve të përcaktuar në nenin 58 të LPP, dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO: z. S. C., kryetar , me detyrë ish n/kryetar bashkie, ndërprerë marrëdhëniet e punës për shkak të daljes në pension, z. B. Z., anëtar, me detyrë P/sek të Bordit të ujitjes dhe kullimit, dhe z.B. M., anëtar, me detyrë P/ sektori në sektorin e Planifikim të Territorit dhe Urbanistikës.

5. Procedura e prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i kanalit ujitës HEC-Ujanik Gjerbes, Sistemim dhe mbrojtje nga ujrat e larta ,perroi fshatit Gjerbes (faza e dyte)", me fond limit 2,839,120 lekë, zhvilluar më 24.04.2018

Vlerësimi i ofertave nga KVO

Me urdhër e titullarit të AK nr. 6 datë 11.04.2018 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) i përbërë nga z.S. C., kryetar , me detyrë zv.Kryetar, z.B. Z., anëtar, me detyrë P/sek të Bordit të ujitjes dhe kullimit, dhe z.B. M., anëtar, me detyrë P/ sektori në sektorin e Planifikim të Territorit dhe Urbanistikës.

KVO ka nënshkruar formularin e deklarimit se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit.

Në dosjen e prokurimit ndodhet vetëm Raporti Përmbledhës i datës 11.05.2018 i miratuar nga titullari i AK ku:

Nga vlerësimi rezulton se ka skualifikuar një operatorë ekonomik. OE "Q. 0." dhe kualifikuar 2 operator ku OE "F." është shpallur fitues.

Kualifikimet dhe s'kualifikimet jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Oferta në lekë pa TVSH	Kualifikuar/s'kualifikuar
1	"Q. 0."	1,809,100	Skualifikuar
2	F.	2,110,600	Kualifikohet, Fitues
3	E.	2,408,298	Kualifikohet

Është s'kualifikuar ofertuesi:

1-"Q. 0."Shpk " ka këto mangësi:

-Nuk ploteson piken 2.3 "Kapaciteti teknik" , germen **"g"** , mungojne certifikatat Iso .

-Nuk ploteson piken 2.3 "Kapaciteti teknik" germa **"a".**Nekontrat pune te ngjashme nuk ka paraqitur faturen tatimore te kerkuar,certifikata e marjes ne dorezim te punimeve mungojne firmat e anetareve te komisionit .

-Nuk ploteson piken 2.3 Kapacitetit teknik germa **"gj",**nuk ka paraqitur dokumentacionin e kerkuarper makinerite kamionet, mungon certifikaten e pronesise,certifikata e kontrollit teknik,vertetimi i pageses per taksat vendore, dhe fotot.

-Nuk plotëson gërmën b) të pikës 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar, operatori ekonomik ka llogarin rrjedhëse bankare më pak se 10% të fondit limit

OE të kualifikuar.

OE "F." shpk është kualifikuar dhe shpallur fitues.

Lidhur me dokumenacioni e paraqitur nga OE "F." i shpallur fitues dhe lidhur kontrata e sipërmarrjes me nr.1246 prot., datë 23.05.2018 nga ana e AK nga auditimi rezultoj se:

OE "F." ka lidhur paraprakisht edhe 2 kontrata të mëparshme me Bashkinë Skrapar;

-Rikonstruksion i Shkolles shkolles Vendreshe, lidhur kontrata më datë 04.05.2018 me

afat 45 ditë,
-Ndertim kanali ujites Fshati Munushtir, lidhur kontrata më datë 23.05.2018 me afat 45 ditë
për të cilat ka vënë në dispozicion mjetet e tij. Nga verifikimi i tyre rezulton se mjetet e paraqitura në këtë procedurë janë të angazhuara në procedurat më sipër për të cilat janë lidhur kontrata dhe si rrjedhojë OE "F." nuk plotëson kriterin e vendosur në DST për 1 (një) kamion dhe 1(një) fadromë. Për të arritur në këtë rezultat duke parë se OE ka paraqitur deklaraten mbi disponibilitetin e mjeteve sipas Shtojcës 9 me të njëjtat mjete, janë konsideruar sipas rastit mjete të cilët janë kërkuar sipas DST për procedurat përkatëëse dhe duke skartuar mjetet e angazhuara në kontratat e mëparshme u arrit në përfundimin më sipër të shprehur.
Gjithaështu për mjetin e paraqitur "Fadromë", *makineria rezuton e paregjistruara dhe e pashoqëruar me leje qarkullimi, certifikatë të kontrollit teknik, dhe policë sigurimi në kundërshtim me përcaktimet e Kodit Rrugor të Republikes së Shqipërië*
Neni 113 Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike,
2. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike duhen regjistruar në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, që i lëshojnë lejen e qarkullimit atij që vërtëton se është pronari i mjetit.
4. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen, duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje, e cila përmban të dhënat e regjistrimit.
Sa më sipër, ky OE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE "F." shpk, dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij.
KVO duhet të kishte anulluar tenderin pasi nuk jemi në kushtet e plotësimi të kritereve të përcaktuar në nenin 58 të LPP, **oferta e paraqitur nga OE "E." nuk përmbush kriteret e nenit 58 të LPP pasi diferenca me ofertën e OE "F." nuk është nën 2% të fondit limit**.
Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO: z. S. C., kryetar, me detyrë ish-zv.Kryetar, z. B. Z., anëtar, me detyrë P/sek të Bordit të ujitjes dhe kullimit, dhe z.B. M., anëtar, me detyrë P/ sektori në sektorin e Planifikim të Territorit dhe Urbanistikës.

6. Procedura e prokurimit me objekt "Blerje ushqimesh për konvitktin e shkollës së mesme "Ramiz Aranitasi", me fond limit 1,293,634 lekë, zhvilluar më 08.04.2019.
Vlerësimi i ofertave nga KVO
Në tender ka paraqitur ofertë vetën OE "4S" i cili është shpallur fitues.
Nga auditimi i dokumentacionit të operatorit të shpallur fitues dhe vlerësimi i kryer nga KVO rezultojnë këto mangësi:
Në kriteret e vendosura në DST është përcaktuar:
1. Operatoret ekonomike duhet të këtë në ose në përdorim kundrejt kontratave përkatëse të noterizuara, për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës, ambjente te përshtatshme per prodhimin dhe magazinimin e artikullit buke. Ambjentet duhet te plotësojnë kushtet higjeno-sanitare të jenë të pajisur me çertifikate pronësie (origjinal ose kopje e noterizuar) dhe leje higjeno-sanitare të lëshuar nga inspektoriati shëndetsor
Nga verifikimi i dokumentave të paraqitur rezulton se mungon certifikata e pronësisë së objektit të paraqitur për të cilin është lidhur kontrata e qerasë.
2. Operatori duhet të ketë në pronësi ose përdorim kundrejt kontratave

përkatëse të noterizuara për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës ***Baxho/Njësi tregtimi Bulmeti/ ambiente per magazinimin e artikujve të bulmetit.*** *Ambjentet duhet te plotësojnë kushtet higjeno-sanitare dhe të jenë të pajisur me çertifikate pronësie (origjinal ose kopje e noterizuar), dhe leje higjeno-sanitare të lëshuar nga inspektoriati shëndetsor.*

Nga verifikimi i dokumentave të paraqitur rezulton se mungon certifikata e pronësisë së objektit të paraqitur për të cilin është lidhur kontrata e qerasë.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokument për pronësi ose përdorim kundrejt kontratave përkatëse të noterizuara, **Njesi tregtare ushqimore / fruta perime ose ambiente per magazinimin e artikujve te tjere ushqimore.** Ambjentet duhet te plotësojnë kushtet higjeno-sanitare dhe të jenë të pajisur me çertifikate pronësie (origjinal ose kopje e noterizuar) dhe leje higjeno-sanitare të lëshuar nga inspektoriati shëndetsor.

Nga verifikimi i dokumentave të paraqitur rezulton se mungon certifikata e pronësisë së objektit të paraqitur për të cilin është lidhur kontrata e qerasë.

Operatori ekonomik të paraqesë Licence leshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL) për artikujt e qumështit dhe nënproduktet e tij.

Nga verifikimi i dokumentave të paraqitura në SEP rezulton se nga ana e OE nuk është paraqitur licenza për artikutj e qumështit.

Bazuar në nenin 53 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar në zbatim të tij sipas të cilit thuhet se *"... autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dokumentat e tenderit...."* oferta duhet të konsiderohej e pavlefshme dhe tenderi **duhet të anullohej**.

KVO duhet të kishte s'kualifikuar OE "4 S" SHPK dhe nuk duhet t'i kishte rekomanduar titullarit shpalljen fitues të tij.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO: nga z. F. K., kryetar, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, z.N. G., anëtar, me detyrë Drejtor i financës, dhe z.A. T., anëtar, me detyrë administrator Njesia Administrative Qender.

7. Procedura e prokurimit me objekt "Ndertimi i kabines elektrike per konviktin", me fond limit 1,739,278 lekë, zhvilluar më 15.04.2019.

<u>Vlerësimi i ofertave nga KVO</u>

Në tender ka paraqitur ofertë vetën një OE: BOE "2A.., i cili është kualifikuar nga KVO dhe është shpallur fitues nga AK.

Në lidhje me dokumentacionin e paraqitur nga BOE nga auditimi rezultoj se: është përcaktuar si kriter i veçantë pasjisja e OE me licensën N.P-11, e cila mungon tek licensa e OE 2A.. Sipas kontratës së deklaruar nga BOE është përcaktuar në marrëveshjen e bashkëpunimit se punimet shoqëritë **do ti kryejnë së bashku** sipas % të rënë dakort.

Bazuar në neni 74 pika 3 e Vkm 914, *"...Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit...".*

Gjithashtu sipas DST është kërkuar një nr mesatar punonjësish prej 7 punonjës (4 punonjës të jenë Specialist elektriçist të pajisur me çertifikatë për të punuar në linjat e tensinit të mesëm). Nga auditimi rezulton se janë paraqitur vetëm elektriçist të OE F.dhe nuk është paraqitur asnjë nga ana e OE 2A..

Sa më sipër, ky BOE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar BOE "2A.." shpk, dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. **KVO duhet të kishte anuluar tenderin** pasi nuk jemi në kushtet e plotësimi të kritereve të përcaktuar në nenin 58 të LPP, dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e

ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO: nga z. F. K., kryetar, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, z.N. G., anëtar, me detyrë Drejtor i Financës, z.B. M., anëtar, me detyrë P/ Sektori në sektorin e Planifikim të Territorit dhe Urbanistikës.

8.*Procedura e prokurimit me objekt "Rikonstruksion i zyrave te Njësisë Administrative Qendër & Ndërmarrjes Shërbimeve Publike", me fond limit 7,717,656 lekë, zhvilluar në datën 02.02.2017*.
Për krijimin e komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), nga titullari i AK z. N. S., ka dalë urdhri nr. nr2/1., datë 13.01.2017, pa nr. protokolli, ku janë përcaktuar: z. V. N., me detyrë përgjegjës i financës, z. N. K. me detyrë teknik ndërtimi, z. A. M., me detyrë ish përgjegjës i sektorit të mirëmbajtjes rrugëve rurale, ndërprerë marrëdhëniet e punës.
Vlerësimi ofertave
Në tender kanë marrë pjesë dhe kanë paraqitur oferta tre OE, si më poshtë:

Nr	Operatorët ofertues	Vlera e ofertës pa TVSH	Kualifikimi nga KVO	NIPT
1	BOE A. C. C. shpk	6,285,980	S'kualifikuar	J.....G&J97511807Ë
2	OE "S.C." shpk	6,821,995	Kualifikuar,	L.....F
3	OE "B. B." shpk	7,166,645	Kualifikuar	K.....H

Arsyet e skualifikimit nga KVO të BOE "A. C. C." SHPK
- Nuk ka paraqitur çertifikatat ISO sipas kërkesës së përcaktuar në DST.
Nga auditimi konstatohet se në DST janë kërkuar:
- Çertifikata e cilësisë së punimeve për ndërtime civile, ISO 9001-2008 (e vlefshme), e cila është paraqitur nga ofertuesi;
- Çertifikatë e menaxhimit te mjedisit ISO 14001-2004 (e vlefshme) e cila ***nuk është paraqitur nga ofertuesi*;**
- Çertifikatë mbi kushtet e sigurisë dhe shëndetit te punonjësve OHSAS 18001-2007 e cila është paraqitur nga ofertuesi;
- Çertifikatë për sistemet e integruar te menaxhimit PASS 99:2012 (e vlefshme), e cila ***nuk është paraqitur nga ofertuesi***;
- Çertifikate per sistemet e integruar te menaxhimit ISO 39001:2012, e cila ***nuk është paraqitur nga ofertuesi*;**
- Sipas KVO: – Eksperti zjarrfikës nuk figuron ne listepagesat e tre muajve te fundit te vitit 2016 .
Mangësitë në certifikatat e kërkuara e skualifikojnëBOE "A. C. C." SHPK.
Për ekspertin zjarrfikës: Në datën 03.01.2017, është lidhur kontratë individuale e punës midis shoqërisë "A." SHPK dhe z. R. B., në të cilën në nenin nr.1 është përcaktuar se z. R. B. do të kryej detyrën e zjarrfikësit. Për këtë qëllim nga z. R. B. është paraqitur edhe licencën për shërbime ndërhyrëse në rast emergjencash, nga Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile.
Fakti se nuk është në listëpagesën e shoqërisë tre muajt e fundit, nuk është domethënës, përbën devijim të vogël.
Për sa më sipër arsyetimi i KVO se shoqëria "A." SHPK nuk plotësohet kriterin për punonjësin zjarrfikës nuk qëndron.
KVO : Vërtetimi për tarifat vendore me nr. 16 date 25.05.2016, i paraqitur nga shoqëria "A." SHPK nuk ka vulën zyrtare të instuticionit.
Nga auditimi konstatohet se konstatimi i KVO nuk qëndron, pasi vërtetimi në fjalë ka

	vulën me përshkrimin "Bashkia Elbasan, drejtoria tatim-taksave". *Sipas KVO shoqëria "C. "SHPK ka këto mangësi në DST:* - Mungon çertifikata e marrjes ne dorëzim te punëve te ngjashme për objektin: "Rehabilitim i pjesshëm dhe instalim i sistemit t e ngrohjes ne shkollën e mesme Sinan Tafaj". Nga auditimi konstatohet se nuk qëndron arsyetimi i mësipërm i bërë nga KVO, sepse: Për të plotësuar kriterin e përvojës së punëve të ngjashme, OE "C." SHPK ka paraqitur a) formularin e vlerësimit, b)aktin e kolaudimit, c)situacionin përfundimtar të shpenzimeve, d)kontratën, e)faturat e likuidimit, për objektin e prokurimit "Rehabilitim i pjesshëm dhe instalim i sistemit të ngrohjes në shkollën e mesme Sinan Tafaj Tiranë", me vlerë 27.6 milion lekë me TVSH, ku OE "C." SHPK, si pjesë e BOE ka kryer 90% të punimeve, vlerë e konsiderueshme po të krahasohet me vlerën e tenderit që po prokurohet. Certifikata e marrjes në dorëzim bëhet nëse do të plotësohet akti i kolaudimit. Pra me dokumentet e paraqitura OE plotëson kriterin e kërkuar. <u>*Mbi kualifikimin e OE "S.C." SHPK*</u> - Nga auditimi konstatohet se nuk plotëson kriterin për ekspertin zjarrfikës. Për këtë qëllim është paraqitur kontrata individuale e punës e datës 16.02.2016, e lidhur midis OE "S.C." shpk dhe z. V. D., në pozicionin e ekspertit zjarrfikës, por ky person nuk figuron në listëpagesën e shoqërisë. - OE "S.C." shpk nuk plotëson kriterin për 2 (dy) punonjës murator me kualifikime teknike nga IQT, pasi nuk ka asnjë murator me këtë kualifikim nga IQT. - Nuk plotëson kriterin për vinç, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për këtë qëllim. Në këto kushte, nga KVO duhet të ishte skualifikuar OE "S.C." shpk. Nga komisioni i vlerësimit të ofertave është kualifikuar operatori ekonomik "S.C." SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 6,821,995 lekë, i cili ka mangësi të theksuara, duke mos plotësuar dukshëm kriteret e vendosura në DST, ndërsa është s'kualifikuar BOE "A. C. C." SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 6,285,980 lekë, për mangësi shumë më të të vogla se operatori i kualifikuar, duke vepruar me dy standarde nga KVO. Për sa më sipër nga KVO **duhet të kishte anuluar tenderin.** ***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi tre anëtarët e KVO*** z.V. N., me detyrë përgjegjës i financës, z. N. K. me detyrë teknik ndërtimi, z.A. M., me detyrë ish përgjegjës i sektorit të mirëmbajtjes rrugëve rurale, ndërprerë marrëdhëniet e punës. *Pas përfundimit të akt konstatimeve, nga subjekti janë bërë kundërshti të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit në fazën e projekt raportit të auditimit, marrë parasysh vetëm elementi i fondit limit. Është bërë e njëjta kundërshti në raport, duke përsëritur kundërshtinë e parë dhe për këtë arsye nuk ka sens trajtimi i saj, pasi nuk është paraqitur as dokument dhe as argument i ri.*
Kriteri:	***Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*** ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm: neni 1 "Objekti dhe qëllimi", pika d, neni 2, "Parimet e përzgjedhjes", neni 24 "Anulimi i një procedure prokurimi", pika nr.1, germa (ç), neni 46 "Kualifikimi i ofertuesve", pika 1, nenin 53 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3 dhe pika 5, neni 55, "Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese", pika 1**,** germa a.
Ndikimi	Mos anullimi i tenderit dhe kualifikimin e një operatori ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e DST, përveçse është veprim në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, është edhe veprim me dy standarde, duke mbajtur dy qëndrime për të njëjtin problem. Gjithashtu kualifikimi i një OE i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në DST, ka rrisk për AK, pasi ky OE për arsye të mangësive nuk jep garanci për zbatimin me sukses dhe

	me cilësi të kontratës.
Shkaku:	Mos zbatim i kuadrit rregullator në fuqi për kualifikimin dhe vlerësimin e ofertave të paraqitura nga OE.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim	Në rastet kur OE pjesëmarrës në tender nuk plotësojnë kriteret e DST, komisioni i vlerësimit të ofertave, duhet të anullojë tenderin.

Për KVO

Titulli i Gjetjes:	Kualifikim i OE i cili nuk plotëson kriteret e DST dhe skualifikim i OE i cili i plotëson këto kritere, me pasojëdëm ekonomikk në vlerën 48,000 lekë për shkak të diferencës së ofertave, si dhe përdorim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet në vlerën 1,248,000 lekë, për shkak të kualifikimit të OE, në kushtet kur ka paraqitur një mjet i cili përsa i përket vitit të prodhimit nuk është kërkuar në DST (i prodhuar 13 vjet më parë nga sa është kërkuar në DST).
Situata:	***1. Procedura e prokurimit me objekt: Blerje kamioni për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, Bashkia Skrapar", me fond limit 1,250,000 lekë, zhvilluar më 04.05.2017.*** <u>*Vlerësimi i ofertave nga KVO*</u> Me urdhër e titullarit të AK nr. 9 datë 21.04.2017 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) i përbërë nga z.V. N., kryetar , me detyrë Përgjegjës Finance, z.A. M., anëtar, me detyrë P/sektori, dhe z. N. K., anëtar, me detyrë teknik ndërtimi pranë N.Sh.P. Në dosjen e prokurimit, në Raportin Përmbledhës të datës 19.05.2017, të hartuar nga KVO dhe i miratuar nga titullari i AK, konstatohet se nga KVO . është s'kualifikuar një operatorë ekonomik: OE "A. G." me ofertë ekonomike në vlerë 1,200,000 lekë, dhe kualifikuar 1 operator ekonomik: "Q. 0." SHPK me vlerë të ofertës ekonomike 1,248,000 lekë i cili është shpallur fitues. KVO në raportin përmbledhës ka përshkruar: Është s'kualifikuar ofertuesi: 1- "A. G." ShPK" për këto mangësi: *- KVO-ja pasi kontrolloj të gjithë dokumentacionin e prezantuar në ofertën e këtij operatori* ***<u>dhe qe rezultoi e rregullt</u>****, për të vazhduar më tej në atë te vlerësimit të mjetit fizikisht mbi gjendjen e tij teknike , kërkoj që ky operator ekonomik të sillte mjetin pranë ndërmarrjes shërbimeve publike, që komisioni i vlerësimit të ofertave të bënte vlerësimin përfundimtar, krahasuare me të dhënat e hedhura në sistem.* *Edhe pse këtij operatori i është kontaktuar dy here me telefon dhe i është bërë kërkesë te portali kërkesat nga KVO, nuk kemi marre asnjë përgjigje për sjelljen e mjetit, pasi afati kohor i vlerësimit te ofertave skadonte ne dt. 10.05.2017 .* **Nga auditmi konstatohet se** KVO duhet të kishte shpallur fitues OE "A. G." Shpk, i cili ka rezultuar prej vetë KVO se dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kriteret e vendosura në DST. Komisioni i vlerësimit të ofertave nuk ka detyrë ligjore të kërkojë të kontaktoj me telefon apo në portal me operatorin ekonomik që plotëson kriteret, për ti thënë se duhet të paraqesë mjetin për tu verifikuar nga KVO. Nëse duhet paraqitur ose jo mjeti, koha e paraqitjes,etj., janë përcaktuar në DST dhe janë bërë të njohura për të gjithë OE. Në DST nuk është përcaktuar se operatorët duhet të paraqesin mjetin për verifikim te KVO. Në DST është përcaktuar është përcaktuar qartë se "*Afati i lëvrimit 30 ditë nga momenti i*

lidhjes se kontratës. Përpara dorëzimit te mallit nga operatori fitues, do te kryhet kontrolli i mjetit i cili duhet te jete ne përputhje me specifikimet teknike te cituara me lart".

Nuk ka qenë detyra e KVO të bëjë verifikimin e mjetit nëse përputhen të dhënat e tij me ato të DST dhe për këtë arsye veprimet e KVO në këtë rast janë të pa ligjshme. Pasi operatori ekonomik shpallet fitues bazuar në vlerësimin e dokumentacionit, bëhet njoftimi i tij në sistem, lidhet kontrata dhe pastaj bëhet dorëzimi i mallit (mjetit), i cili verifikohet nëse është ose jo sipas specifikimeve teknike dhe kritereve të përcaktuara në DST, nga një komision tjetër, ai i marrjes në dorëzim të mjetit. KVO ka vepruar me dy standarde, pasi jo vetëm që ka kualifikuar një operatorë ekonomik ("Q. 0." SHPK), i cili ka paraqitur dokumente për një mjet të vitit të prodhimit 1977, i cili nuk është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor (në DST është kërkuar mjet me vit prodhimi 1990 e mbrapa), pra nuk plotëson dukshëm kriteret e vendosura në DST, por pas shpalljes fitues të tij, nuk ka kërkuar që prej tij të paraqitej mjeti në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, për tu vlerësuar nga KVO, ashtu si ka vepruar në rastin me OE "A. G." ShPK, të cilin e ka s'kualifikuar padrejtësisht vetëm për mos prurjen e mjetit (gjë që nuk është kërkuar në DST, por vetë KVO e ka shtuar këtë kërkesë ektra).

OE të kualifikuar.

OE "Q. 0." SHPK është kualifikuar dhe shpallur fitues. Nga auditimi i dokumentacionit të operatorit të shpallur fitues dhe vlerësimi i kryer nga KVO rezultojnë këto mangësi:

- Në DST është përcaktuar tek Specifikimet teknike veç të tjerave dhe viti i prodhimit të mjetit duhet të jetë pas vitit 1990. Në dokumentet e ngarkuar në SEP dhe konkretisht tek skedari "*Dokumente dhe foto të kamionit AA...GL"* mjeti i paraqitur sipas "*çertifikatës së pronësisë së mjetit*" dhe lejes së qarkullimit është evidentuar se viti i prodhimit të mjetit është viti 1977.

Sa më sipër OE "Q. 0." SHPK nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar këtë OE dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. Titullari i AK z. M. K.**ka qenë në kushtet e dijenisë së anomalisë së bërë nga KVO**, sepse kjo anomali i është bërë e ditur në raportin përmbledhës të hartuar prej KVO (të cilin Titullari e ka miratur), ku shprehet (KVO-ja) se: *KVO-ja pasi kontrolloj te gjithë dokumentacionin e prezantuare ne ofertën e këtij operatori* ***dhe qe rezultoi e rregullt****....* Pra dokumentacioni i kërkuar është i rregullt. Titullari i AK z. M. K., nuk duhet të kishte miratuar raportin përmbledhës të KVO dhe nuk duhet të kishte shpallur fitues OE "Q. 0." SHPK me NIPT **K.....C**.

Si përfundim nga KVO duhet të ishte kualifikuar dhe shpallur fitues OE "A. G." SHPK", me vlerë të ofertës ekonomike 1,200,000 lekë dhe duhet të ishte s'kualifikuar OE "Q. 0." SHPK, me vlerë të ofertës 1,248,000 lekë. Mos kryerja e këtyre veprimeve nga KVO jo vetëm që ka shkaktuar **një dëm ekonomik në vlerën 48,000 lekë**, por ajo që është më kryesorja ka vepruar me dy standarde në qëndrimin e saj midis dy operatorëve. Nga marrja e një mjeti me vit prodhimi 1977, i cili është me një amortizim maksimal, fondet e shpenzuara për të janë pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet, për shkak të shpenzimeve që shoqërojnë mjetin për mirëmbajtjen e tij, në vitet pasuese. Kjo vërtetohet edhe me shpenzimet konkrete për mirëmbajtjen e tijë, të cilat bazuar në të dhënat e

	Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike për tre vitet 2017-201 kanë një vlerë prej 574,720 lekë. Brenda vitit të parë, kohë brenda garancisë prej 12 muaj përcaktuar në specifikimet teknike të DST janë kryer shpenzime në vlerën 180,400 lekë. **Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi** anëtarët e KVO i përbërë: z. V. N., kryetar, me detyrë Përgjegjës Finance, z. A. M., anëtar, me detyrë P/sektori, z. N. K., anëtar, me detyrë teknik ndërtimi, si dhe Titullarin e Autoritetit Kontraktor, z. M. K., i cili nëpërmjet dokumentit "Raporti përmbledhës" përgatitur nga KVO, dokument i cili është miratuar prej tij, **ka qenë i informuar se shkaku i skualifikimit tëOE "A. G." SHPK është i paligjshëm** (vetë KVO në këtë dokument ka informuar Titullarin se pasi kontrolloj te gjithë dokumentacioninOE "A. G." SHPK, oferta e tij rezultoi e rregullt dhe nga ana tjetër e skualifikon). Si përfundim nga veprimet e mos veprimet e pa ligjshme të komisionit të vlerësimit të ofertave, Titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe komisionit të marrjes në dorëzim të mallit (i cili trajtohet vecmas në këtë raport), Autoriteti Kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, ka blerë një mjet i cili nuk ka qenë objekt i procedurës së prokurimit të zhvilluarprej tij (Blerje kamioni për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, Bashkia Skrapar"), sepse kamioni i blerëështë i vitit të prodhimit 1977, ndërsa qëllimi i zhvillimit të tenderit ka qenë kamion i vitit të prodhimit 1990 e mbrapa.
Kriteri:	***Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*** ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm: neni 1 "Objekti dhe qëllimi", pika d, neni 2, "Parimet e përzgjedhjes", neni 24 "Anulimi i një procedure prokurimi", pika nr.1, gërma (ç), neni 46 "Kualifikimi i ofertuesve", pika 1, nenin 53 "Shqyrtimi i ofertave", neni 55, "Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese", pika 1**,** germa a.
Ndikimi	1. Kualifikimi i OE "Q. 0." SHPK dhe marrja në dorëzim e mjetit të dorëzuar prej tij, në kushtet kur ky mjet nuk plotëson specifikimet teknike të vendosura në DST, si dhe kërkesat e kontratës së furnizimit nr. 06, datë 12.06.2017, me objekt "Blerje kamioni", ka sjellë si pasojë marrjen në dorëzim të një aktivi i cili është minimalisht 13 vjet më i vjetër se ai i përcaktuar në DST dhe kontratë, duke sjellë përdorim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet në vlerën 1,250,000 lekë, mos zbatim të kuadrit rregullator në fuqi, si dhe qëndrim me dy standarde të AK ndaj operatorve ekonomik. Kjo vërtetohet edhe me shpenzimet konkrete për mirëmbajtjen e tijë, të cilat bazuar në të dhënat e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike për tre vitet 2017-2019 kanë një vlerë prej 574,720 lekë. Vetëm brenda vitit të parë, kohë brenda garancisë prej 12 muaj përcaktuar në specifikimet teknike të DST janë kryer shpenzime në vlerën 180,400 lekë.
Shkaku:	Mos zbatim i kuadrit rregullator në fuqi për vlerësimin e ofertave të OE
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim	KVO të vlerësoj drejtë plotësimin ose jo të kritereve nga operatorët pjesëmarrës, duke i dhënë përparësi ofertës e cila ka vlerën më të ulët dhe plotëson kriteret e vendosura në DST.

Në një rast është kualifikuar operatori ekonomik me ofertën anomalish të ulët, pa kërkuar sqarime dhe argumentime prej tij për ofertën.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Skrapar

Titulli i Gjetjes:	Kualifikim i operatorit ekonomik me ofertën anomalish të ulët, pa kërkuar më parë sqarime dhe argumentime për vlerën e ofertës, duke krijuar rrisk për realizimin me cilësi dhe sukses të kontratës.
Situata:	***1.Procedura e prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i rrugës se fshatit Munushtir" me fond limit* 18,583,333 *lekë, zhvilluar më* 31.03.2018.** Vlerësimi i ofertave nga KVO Nga vlerësimi rezulton se janë s'kualifikuar 2 operatorë ekonomik OE "A." shpk dhe "K.A." shpk, dhe kualifikuar 1 operator, OE "D.i cili është shpallur fitues. Kualifikimet dhe s'kualifikimet jepen në tabelën e mëposhtme: Nr. | Subjekti | Oferta në lekë pa TVSH | Kualifikuar/s'kualifikuar 1 | D.C. | 11,047,059 | Kualifikohet, Fitues 2 | A. | 17,868,700 | Skualifikohet 3 | K.A. | 18,455,850 | Skualifikohet OE "D.C." shpk është kualifikuar dhe shpallur fitues. Nga auditimi i dokumentacionit të operatorit të shpallur fitues dhe vlerësimi i kryer nga KVO rezultojnë këto mangësi: Oferta e paraqitur nga OE sipas përllogaritjeve (oferta e paraqitur është më e ulët se 25% e FL) rezulton ofertë anomalisht e ulët dhe më konkretisht sipas pikës 3.4 të DST nga ana e AK duhet: *3.4.1 Nëse oferta e dorëzuar, rezulton anomalisht e ulët në lidhje me punët e ofruara, atëherë Autoriteti Kontraktor i kërkon Ofertuesit në fjalë të justifikojë çmimin e ofruar. Nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim që të bindë Autoritetin Kontraktor, atëherë ky i fundit ka të drejtë të refuzojë ofertën.* *3.4.2 Oferta do të cilësohet anomalisht e ulët sipas përcaktimit të bërë në nenin 66 të Kreut VIItë RrPP.* *Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25 përqind e fondit limit të përllogaritur.* *Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP.* *Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe dokumentojë me prova shkresore sqarimet mbi elementin/elementët e veçantë të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.* Nga ana e KVO nuk janë kërkuar sqarime për argumentimin e ofertës anomalish të ulët.
Kriteri:	VKM nr.914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar nenit 56 -Oferta anomalisht e ulët, neni 56 i LPP.
Ndikimi/ Efekti:	Shkelje e procedurave të prokurimit publik, heqja e mundësisë për autoritetin kontraktor për të marrë sqarime nga ofertuesit nëse ofertat anomalisht të ulta janë praktikisht të realizueshme, duke ulur shanset për realizim të kontratës me vlerë më të ulët.
Shkaku:	Mos zbatim i kërkesave ligjore për kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorit ekonomik
Rëndësia:	E mesme
Rekomandim	Në raset e paraqitjes së ofertave anomalish të ulëta, KVO ti sugjerojë titullarit për të kërkuar shpjegime me shkrim nga ofertuesit për argumentimin e vlerës së ulët të ofertës.

Në dy raste është bërë marrja në dorëzim e mjeteve të transportit pa verifikuar më parë përputhjen e mjeteve me kriteret dhe specifikimet e vendosura në DST dhe në kontratën e furnizimit.

Titulli i Gjetjes:	Marrja në dorëzim e aktiveve pa verifikuar përputhjen e tyre me kriteret dhe specifikimet e vendosura në DST dhe në kontratën e furnizimit.
Situata:	**1. *Procedura e prokurimit me objekt "Blerje Rruli ", me fond limit* 2,083,333 *lekë, zhvilluar më* 24.02.2017.** *Marrja në dorëzim e mjetit* Nga auditimi konstatohet se Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, nuk ka nxjerrë urdhër për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të mallit (rrulit), veprime të cilat janë në kundërshtim me udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, rubrika "Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara", pika 42, ku thuhet: Titullari i njësisë miraton urdhërin për ngritjen e komisjonit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues. Hyrja në magazinë është bërë sipas fletë-hyrjes nr. 12 datë 24.03.2017 nga magazinieri znj. M. Xh.. Veprimet ose mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e AK z. M. K. me detyrë ish drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike pranë Bashkisë Skrapar. ***2.Procedura e prokurimit me objekt: Blerje kamioni për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, Bashkia Skrapar, me fond limit 1,250,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në 04.05.2017*** *Marrja në dorëzim e mjetit* Nga auditimi konstatohet se Drejtori i ndërmarrjes së shërbimeve publike, në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, ka nxjerrë urdhër për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të mallit (Kamioni) sipas urdhrit të brendshëm nr. 13 datë 13.06.2017, ku janë përcaktuar anëtarët e komisionit personat: K. M., D. M. dhe B. B.. Komisioni ka mbajtur Proces Verbalin me datë 14.06.2017 mbi marrjen në dorëzim të mjetit tip Benz, Kamion 3 aks ngjyrë të kuqe për të cilin ka verifikuar vetëm 6 element të tij si: motorrin, grupin e timonit, kamjon, kazanin, pjesët xhenerike dhe gomat ku është shprehur vetëm për gjendjen e tyre nëse janë "në rregull", ndërkohë nuk është bërë evidentimi dhe vlerësimi i mjetit sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në DST. Përpara marrjes në dorëzim të mallit, komisioni nuk ka kryer të gjitha verifikimet e nevojshme, nëse përputheshin të dhënat e mjetit, me specifikimet e përcaktuara në DST dhe kërkesat e kontratës së furnizimit. Në DST është përcaktuar se mjeti duhet të jetë i vitit të prodhimit pas vitit 1990, ndërsa mjeti që është marrë në dorëzim prej komisionit sipas "*çertifikatës së pronësisë së mjetit*" dhe lejes së qarkullimit, është i vitit të prodhimit 1977. Pavarësisht se OE është shpallur fitues nga KVO, komisioni i marrjes në dorëzim, duhet të mos pranonte mallin, pasi ai nuk përputhet me spesifikimet teknike. Sipas përcaktimeve të Udhëzimit 30 datë 27.12.2011 të MF "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" përcaktohet se komisioni i marrjes në dorëzim të aktiveve vepron si më poshtë: 1.Kryen verifikimin fizik të sasisë, cilësisë dhe çmimit

	2.*Verifikon përputhshmërinë me specifikimet të rëna dakort më parë* 3.Verifikon plotësinë e dokumentave mbështetës. Në rast mospërputhje njoftohet shitësi për veprim sipas parimit 45 të Udhëzimit. Hyrja në magazinë është bërë sipas fletë-hyrjes nr. 23 datë 13.06.2017 nga magazinieri znj. M. Xh.. Gjithashtu komisioni i marrjes në dorëzim të mjetit ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në kontratën e furnizimit nr. 06, datë 12.06.2017, me objekt "Blerje kamioni", nënshkruar midis Kontraktuesit "Q. 0."dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Bashkia Skrapar, përfaqësuar dhe nënshkruar nga drejtori i kësaj ndërmarrje z. M. K.. Në këtë kontratë midis të tjerash komisioni I marrjes në dorëzim duhet të zbatonte këto kërkesa: *Neni 1 i kontratës: këto kushte të përgjithshme të kontratës do të zbatohen për blerjen e mallrave të prokuruara me anë të procedurës kërkesë për propozim* *Neni2: Objekt i kontratës do të thotë të gjitha mallrat dhe shërbimet në lidhje me to që kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.* *Neni 8 -Qëllimi i furnizimit dhe përshtatshmëria e mallrave me specifikimet: Kontraktuesi dhe të dorëzojë mallrat me cilësi, sasi dhe lloj të specifikuar në kontratë…* *Neni 9. Përshtatshmëria e mallrave me standardet teknike:* *Mallrat e furnizuara sipas kontratës, duhet të jenë konformë kodeve dhe standardeve teknike, të parashikuara në specifikimet teknike.* *Neni 12, Pika 12.4: Autoriteti kontraktor do të refuzojë çdo mall i cili nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konformë specifikimeve teknike dhe kushteve të përcaktuara në zbatimin e kontratës* Veprimet ose mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi komisionin e marrjes në dorëzim të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, Bashkia Skrapar i përbërë nga z. K. M. me detyrë mekanik, z. D. M. me detyrë shofer dhe z. B. B. me detyrë manovrator.
Kriteri:	Udhëzimit 30 datë 27.12.2011 të MF "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"; Kontrata e furnizimit nr. 06, datë 12.06.2017, me objekt "Blerje kamioni".
Ndikimi/ Efekti:	Marrja në dorëzim e aktiveve pa verifikuar përputhjen e kritereve dhe specifikimeve të vendosura në DST, si dhe specifikimeve të përcaktuara në kontratën e furnizimit, ka sjellë si pasojë marrjen në dorëzim të një aktivi i cili është minimalisht 13 vjet më i vjetër se ai i përcaktuar në DST dhe kontratë, duke sjellë përdorim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet.
Shkaku:	Mos zbatim i kërkesave ligjore në fuqi për marrjen në dorëzim të mallrave
Rëndësia:	E mesme
Rekomandim	Të eliminohen praktikat e marrjes në dorëzim të mallit pa verifikuar përputhshmërinë e tij me specifikimet e vendosura në DST dhe kontratën e furnizimit.

D.2. Hartimi dhe zbatimi i kontratave të punimeve

1. *Hartimi dhe zbatimi i kontratës së punimeve me objekt "Rehabilitimi i kanalit ujitës "Rog - Zaberzan", Bashkia Skrapar, me vlerë të kontratës 14,409,720 lekë me TVSH, nr. 1090 prot., datë 08.05.2017datë.*

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
- Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt i zbatimit dhe projekti i azhurnuar, Situacioni përfundimtar, Libreza e masave, etj.

Titulli i Gjetjes	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin "Rehabilitimi i kanalit ujitës "Rog - Zaberzan", Bashkia Skrapar, nga zbatuesi i punimeve OE "Z." SHPK, për zërin e punimeve 4, 7 dhe 10.
Situata:	Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **1,107,550 lekë pa TVSH.** Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës"Prishje strukturë betoni", "FV tuba çeliku Ø > 200 mm, i hidroizoluar në fabrikë me t=4mm" dhe "Transport materiale me traktor dhe auto", për pasojë vlera e kësaj diference është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. ***Vlera prej 1,107,550 lekë, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Skrapar. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:*** 1) Z. F. B. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes; 2) Z. G. S. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara; ***Kundërshti nga subjekti i audituar**: Përsa më sipër janë bërë kundërshti nga mbikëqyrësi i punimeve z. F. B., ku në mënyrë të përmbledhur thuhet:* *1. Kundërshtojmë pretendimin e audituesit pasi gjendja ekzistuese e kanalit ka pasur një formë gjysmë trapezoidale ashtu sikurse është paraqitur dhe në librin e masave. Njëra anë e tij ka qenë i mbështetur mbi një strukturë brutobetoni e cila ishte e amortizuar Po ashtu prishja e saj ishte e nevojshme për të ndërtuar një seksion më të madh të kanalit për të garantuar prurjen e kërkuar. Kjo strukturë ka qenë me përmasa 0.4 m gjerësi dhe 0.3 m trashësi në një gjatësi prej 1069.2 ml nga e cila ka dalë dhe volume i prishjes në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar. Në këto kushte nuk mendojmë se kemi të bëjmë me mangësi volumesh për këtë zë pune por sasia në fakt është e njëjtë me atë të situacionuar.* *2. Sqarojmë se sasia që ju keni analizuar më sipër i referohet vetëm betonit të përdorur për veshjen e kanalit. Por në librin e masave ndodhen dhe diferenca tjetër e betonit që është përdorur në këtë objekt dhe konkretisht. Në librin e masave ndodhet zëri Struktura monolite betoni C 16/20 mur pritës, ku ndodhen të paraqitura me piketa ndërtimi i tyre dhe ka një volum prej 51 m3 (L=129.5 ml x 1.3 m lartësi x 0.3 m trashësi.) Gjithashtu një volum tjetër ku është marrë ky zë pune i cili është paraqitur në librin e masave është Struktura monolite betoni C 16/20 Jastëk mbështetës nën tub çeliku. Në të gjitha segmentet ku është vendosur tub çeliku ky i fundit është mbështetur mbi bazamente betoni për të garantuar qëndrueshmërinë e tij. Të dhënat me piketa dhe dimensione jepen të detajuara në librin e masave dhe kjo sasi është 2.7 m^3. Po ashtu në librin e masave ndodhet Struktura monolite betoni C 16/20 Portal tubi çeliku ku në të gjitha segmentet ku është vendosur tubi i çelikut janë realizuar portale betoni hyrëse dhe dalëse për të garantuar qëndrueshmërinë e tubit në ngarkesë. Ky volum paraqitet i detajuar në librin e masave dhe ka një sasi prej 4 m^3. Pra në total volumi i betonit është 288.17 m^3 beton për veshje kanali + 51 m^3 beton për mure betoni + 6.7 m^3 për portalet dhe jastëkët në tubat e*

	çelikut = 346 m3. Në këto kushte nuk mendojmë se kemi të bëjmë me mangësi volumesh për këtë zë pune por sasia në fakt është e njëjtë me atë të situacionuar. *3. Sqarojmë se në tabelën e librit të masave ka ndodhur një lapsus në mbledhjen e gjatësive totale të tubit mbi të cilin ju keni mbështetur llogaritjen tuaj. Në bazë të kësaj tabele, nëse mbledhim shumatoren e çdo gjatësie të tubit të vendosur sasia totale e gjatësisë së vendosur është (L=317.56 ml gjatësi e tubit me d=400 mm, t=4mm dhe peshë 7850 kg/ml) dhe sasia është 12.564 ton.* *4... Sqarojmë se zëri i transportit nuk është përmendur detajuar në rubrikë më vete në librin e masave, por duke pasur parasysh terrenin në te cilin ndodhet objekti, i cili është shumë i pafavorshëm për rrugë aksesi dhe materialet janë transportuar të gjitha. Në këtë sasi janë përfshirë këto zëra pune: (Gjysma e materialit të gërmuar,Gërmim kanalesh në toke te zakonshme, me krahë, me seksion deri 0.75 m² (2000x 0.55ml), Prishje struktura betoni, Shtresë zhavor lumi t=4cm, Struktura monolite betoni C 16/20 me trashësi 8 - 10 cm, F.V. tuba çeliku φ>200 te h/izoluar ne fabrike me t= 4 mm, Mur guri mbajtës e themele, llaç çimento M50, Mbushje me zhavorr pas mureve).* ***Qëndrim i grupit të auditimit**: 1.Përsa i përket zërit 4. "Prishje strukture betoni", argumenti i sjellë ka të bëjë me vizatimet në librin e masave, sipas të cilit përsëri rezulton që prishja është bërë ashtu siç është argumentuar nga ana e grupit të auditimit në aktkonstatimin nr. 1, datë 26.02.2020. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.* *2. Argumenti i sjellë në observacion, merret në konsideratë dhe do të reflektohet në vlerën e dëmit ekonomik.* *3. Nga riverifikimi i llogarive dhe projektit të azhurnuar, rezulton se në tabelën e librit të masave është vendosur gjatësia 132 m nga pik2 – pik8, ndërkohë që kjo gjatësi është 112 m. Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.* *4. Për këtë pikë të observacionit sqarojmë se gjatë llogaritjes, nga ana e grupit të auditimit janë marrë në konsideratë zërat e përmendur në observacion, përveç An-49 "Prishje struktura betoni", me sasi 128 m^3, e cila sipas manualit e ka transportin të përfshirë dhe nga rillogaritja me të gjithë zërat e tjerë të përmendur në observacion, diferenca si punim i pakryer del aq sa është cituar në akt-konstatimin nr. 2, datë 26.02.2020. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.*
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janënë përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1090 prot datë 08.05.2017. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit pa nr. prot, datë 09.05.2017. - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve,sipas aktit pa nr prot, datë 31.07.2017.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Skrapar.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit, si dhe të grupit të marrjes së përkohshme në dorëzim.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandime:	Nga Bashkia Skrapar të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,107,550 lekë** pa TVSH

	nga OE "Z." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1090 prot datë 08.05.2017 me "Rehabilitimi i kanalit ujitës "Rog - Zaberzan*", Bashkia Skrapar,* vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.Të kryhen riparimet e sipërfaqes prej 150 m^2, të dëmtuar për shkak të cilësisë jo të mirë të punimeve.

2. Hartimi dhe zbatimi i kontratës së punimeve me objekt "Rikualifikimi i hapësirave përreth Pallatit të Kulturës, rruga me trafik të kufizuar/pedonalja "Pasho Hysi", rruga automobilistike "Pasho Hysi", Bashkia Skrapar, me vlerë të kontratës 264,704,108 lekë pa TVSH, nr. 1451 prot datë 11.07.2016

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
- Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt i zbatimit dhe projekti i azhurnuar, Situacioni përfundimtar, Libreza e masave, etj.

Titulli i Gjetjes	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin "Rikualifikimi i hapësirave përreth Pallatit të Kulturës, rruga me trafik të kufizuar/pedonalja "Pasho Hysi", rruga automobilistike "Pasho Hysi", Bashkia Skrapar, nga zbatuesi i punimeve BOE fitues ""D.C." SHPK & "A. L. I." SHPK" SHPK, për zërin e punimeve2.14, 2.15 dhe III.11.
Situata:	Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **376,380 lekë pa TVSH**. Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punimeve "Prishje bazament betoni të busteve", "Transport mbetjesh dhe dheu" dhe "Shtresë ll.ç 2 cm 1:2 (poshtë bordurave)", për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. ***Vlera prej 376,380lekë, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Skrapar.*** ***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:*** Z. A. K. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes Z. V. T.,me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara. ***Kundërshti nga subjekti i audituar****: Përsa më sipër janë bërë kundërshti nga mbikëqyrësi i punimeve z. A. K., ku në mënyrë të përmbledhur thuhet:* *1. Referuar librezës së masave kemi dy bazamente shoqëruar me vizatimin përkatës. Volumet e llogaritura nga përmasat në vizatimet bashkëlidhur librezës, janë të sakta. Kërkojmë që diferenca e volumit të bazamentit të hiqet, duke marrë në konsideratë përmasat e vizatimit që shoqërojnë librezën.* *2. Në librezën e masave është pasqyruar saktë e gjithë sasia e prishjeve. Kjo sasi është më e madhe se sasia e pasqyruar në librin e masave dhe situacionin përfundimtar të punimeve. Mendojmë se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me diferencë volumesh midis*

	librit të masave dhe situacionit përfundimtar të punimeve të kryera në fakt. *3. Diferenca e konstatuar nga ana juaj në librezën e masave, 14 copë veshje me elementë druri të stolave të gurit, janë montuar në terren, por janë dëmtuar nga qytetarët pas periudhës së garancisë...* *4. Në analizën e çmimit të bordurave të betonit, nuk është vendosur "Shtresë ll.ç 2 cm 1:2", pasi në preventivin fitues zëri "Shtresë ll.ç 2 cm 1:2" ishte zë më vete. Kjo ishte arsyeja se edhe çmimin për FV bordura betoni 20 x 35 cm është dhënë më e ulët se manuali, pasi është dhënë çmim veç për Shtresë ll.ç 2 cm sipas preventivit, prandaj kërkojmë që kjo diferencë e pasqyruar si dëm ekonomik, të hiqet.* ***Qëndrim i grupit të auditimit**: 1. Përsa i përket zërit 2.14. "Prishje bazament betoni të busteve", nga ana jonë diferenca e volumit nuk qëndron tek përmasat e dhëna në librin e masave por në veprimet aritmetike. Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.* *2. Përsa i përket zërit 2.15. "Transport mbetjesh dhe dheu deri në 3 km", nga ana jonë janë llogaritur të gjitha volumet që duhen transportuar, të cilat janë llogaritur gabim nga ana juaj. Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.* *3. Përsa i përket zërit. 5.3 "Veshje me elementë druri e konstruksione metalike e stolave të gurit", nga ana jonë janë llogaritur diferencat në volume sipas librit të masave të hartuar nga kontraktori dhe të miratuar nga mbikëqyrësi.Përsa sipër, ky pretendimnuk merret në konsideratë.* *4. Për këtë pikë të observacionit sqarojmë se gjatë llogaritjes, nga ana e grupit të auditimit është gjykuar që zëri i manualit 3.618 "FV bordura betoni 20 x 35 cm", i cili është në preventiv me po këtë numër analize, e ka të përfshirë shtresën e llaçit. Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.*
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1451 prot datë 11.07.2016. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1553, datë 20.07.2016. - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit pa nr prot, datë 26.07.2017.
Ndikimi/ Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Skrapar.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
Rëndësia:	I ulët.
Rekomandime:	Nga Bashkia Skrapar të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 376,380lekë pa TVSH nga BOE fitues "D.C." SHPK & "A. L. I." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1451 prot datë 11.07.2016 me "Rikualifikimi i hapësirave përreth pallatit të Kulturës, rruga me trafik të kufizuar/pedonalja "Pasho Hysi", rruga automobilistike "Pasho Hysi*", Bashkia Skrapar,* vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

3. Hartimi dhe zbatimi i kontratës së punimeve me objekt "Rikonstruksion i kanalit ujitës Vendreshë (Dega e majtë dhe e djathtë)" Bashkia Skrapar, me vlerë të kontratës 35,035,060 lekë me TVSH, datë 01.12.2016.

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik.

Situata: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Rikonstruksion i kanalit ujitës Vendreshë (Dega e majtë dhe e djathtë)" Bashkia Skrapar, me vlerë 35,035,060 lekë me TVSH, fituar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "F." SHPK& "Sh. 07" SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të disa zërave të punimeve të kryera në objekt, në vlerën **399,493 lekë pa TVSH**.

Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

Ka patur likuidime për punime ndërtimit të pakryera, për zërat e punimeve: Gërmim toke seksion i detyruar puseta + tombino + ura; F.V tuba b/a 1000 mm dhe Hidroizolim si dhe penalitet për punime jashtë kontrate.

Nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet dhe zërat e punës të pasqyruara në situacionin përfundimtar si dhe atyre të kryera në fakt, rezultoi se këta zëra punimesh nuk janë kryer sipas volumeve të preventivit të ndryshuar, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **399,493.70 lekë pa TVSH**, nga ku:

- Vlera prej 189,945 lekë pa TVSH, përfaqëson dëm ekonomik, për punime të pakryera sipas volumeve të situacionuara krahasuar me volumet e kryera në fakt.
- Vlera prej 209,548.70 lekë, përfaqëson dëm ekonomik për shkak të ndryshimit të çmimeve (rritje dhe ulje) për 9 (nëntë) zëra punimesh duke u përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar.

***Komente nga subjekti i audituar**: Për sa më sipër janë bërë kundërshti nga mbikëqyrësi i punimeve "A." SHPK dhe sipërmarrësi i punimeve "F." SHPK,* mbi akt-konstatimin Nr. 5 *përcjellë në mënyrë elektronike, ku në mënyrë të përmbledhur thuhet:*

***1**.Për zërin me Nr. rendor 8. me përshkrim "Ndërtim Ure Auto Hd=2m, B=5m →Hd=1m L=5.5ml" e cila është një nën objekt i ketij objekti dhe përfshin në vetvete zërat e punimeve, sasitë dhe çmimet te cilat janë pjese e këtij preventivi punimesh e janë sipas analizës me vlerë 173,063 lekë. Pas azhornimit të punimeve për këtë nen objekt, nuk ndryshuar asnjë çmim për punimet e ofruara, por pas ndryshimeve të volumeve në këto analiza të nën objektit ka ardhur për rrjedhojë ndryshim i vlerës se analizës komplekse (të këtij nën objekti) i cili në preventivin përmbledhës reflektohet si çmim i tij (si çmim i nën objektit).*

***2.** Për zërin me Nr.rendor 9. Me analize An.3 ,me përshkrim «Kalim me tub çeliku ø508mm δ=7mm L=6m →5ml» , analize e cila përfshin ne vetvete zërat e punimeve, sasitë dhe çmimet, te cilat janë pjese e këtij preventivi punimesh e jane sipas analizës me vlerë 172,509 lekë. Pas azhornimit të punimeve për këtë nën objekt, nuk ka ndryshuar asnjë çmim për punimet e kryera.*

3 Për zërin me Nr.rendor 10. Me analize An.4 ,me përshkrim "Kalim me tub çeliku ø508mm δ=7mmL=8m " gjatësia e te ciles rezulton L→6ml» , analize e cila përfshin ne vetvete zerat e punimeve, sasitë dhe çmimet, të cilat janë pjese e këtij preventivi punimesh me vlerë 212,920 lekë. Pas azhornimit të punimeve për këtë nën objekt, nuk ka ndryshuar asnjë çmim për punimet e kryera.

4. Për zërin me Nr.rendor 11. Me analize An.5 ,me përshkrim "Kalim me tub celiku ø508mm δ=7mmL=16m " gjatësia e te ciles rezulton L→12ml" , analize e cila përfshin ne vetvete

zerat e punimeve, sasit dhe çmimet, të cilat janë pjese e këtij preventivi punimesh me vlerë 331,008 lekë, por pas azhornimit të punimeve nuk ka ndryshuar asnjë çmim për punimet e kryera.
5. Për zërin me Nr. rendor 12. Me analize An.6 ,me përshkrim "Kalim me tub celiku ø508mm δ=7mm, L=20m" gjatësia e të cilës rezulton L→14ml" , analize e cila përfshin ne vetvete zërat e punimeve, sasitë dhe çmimet, të cilat janë pjesë e këtij preventivi punimesh me vlerë 390,224 lekë.Pas azhornimit të punimeve për këtë nën objekt, nuk ka ndryshuar asnjë çmim për punimet e kryera.
6. Për zërin me Nr. rendor 13. Me analize An.7, me përshkrim «Kalim me tubo çeliku ø508mm δ=7mmL=30ml →L= 33 ml" gjatësia e te cilës rezulton L→33m+L=18m» , analize e cila përfshin në vetvete zërate punimeve, sasit dhe çmimet, të cilat janë pjesë e këtij preventivi punimesh jane me çmim 540,484 lekë, por pas azhurnimit çmimi është bërë 978,215 lekë (Lum sum).
7. Për zërin me Nr. rendor 14. Me analize An.8 ,me përshkrim «Ndertim Ure Auto Hd=2m, B=10m→hd=1ml=7.5", analize e cila përfshin ne vetvete zërat e punimeve, sasitë dhe çmimet, te cilat janë pjese e këtij preventivi Lum Sum me vlerë 456,786, por pas azhornimit është bërë 256,655 lekë.
8 Për zërin me Nr .rendor 15. Me analize An.9 ,me përshkrim «Riparim H+D Tub Celiku ø508mm L=8m→L=6m, , L=24m , L=35m, L=40m, L=46m , L=66.9 m", analize e cila përfshin ne vetvete zërat e punimeve, sasitë dhe çmimet , te cilat jane pjese e ketij preventivi punimesh me çmim 98,755 lekë pas ndryshimeve është bërë 715,551 lekë.
9. Për zërin "Gërmim dheu themel muri mbajtës", ju sqarojmë se nisur nga azhornimi i bere ne këtë objekt, detajimit në librezën e masave për çdo piketë në të cilat janë ndërtuar muret mbajtëse, volumi i këtij zëri të punimeve del(rezulton) aq sa është paguar në situacionin përfundimtar sepse muret mbajtëse janë piketuar dhe ndërtuar në zonat ku kanalet vaditëse të të dy krahëve kanë patur rrëshqitje, pra nuk ka patur gjurme të kanalit për shkak të masivit të dherave të cilet duhet të gërmohen më parë për të realizuar themelin e murit mbajtës prej betoni. Për këtë arsye është pasqyruar në librezë sasia reale e gërmimit për formim të themelit të murit mbajtës dhe jo me tepër siç shpreheni Ju në këtë paragraf.
Qëndrimi i grupit të auditimit:
Lidhur me argumentet e paraqitura për pikat nga 1 deri 9, grupi i auditimit pasi e lexoi me kujdes sqaron:
- Trajtimi nga ana Juaj i mosndryshimit të çmimeve në variantin Lum SUM (LS) është në kundërshtim me llojin e kontratëst, sepse kjo kontratë për punë publike nuk është e tipit me "çelësa në dorë". Pavarësisht se nuk keni ndryshuar çmimet për nën zërat, në situacionin përfundimtar keni ndryshuar çmimet. Ne, mendojmë se, në kushtet e ndryshimit të volumeve të nënzërave të zërit të punimeve LS, duhej që të kishit reflektuar vetëm ndryshimin e volumit të zërit të punimit si Lum Sum dhe jo çmim e tij. Kontrata me nr. 2533 prot, datë 01.12.2016 me objekt "Rikonstruksioni i kanalit ujitës Vendreshë (dega e majtë dhe e djathtë)" është me matje në bazë të çmimeve fikse, në rastet kur vëllimi i punëve të specifikuara në projekt mund të ndryshojë gjatërealizimit. Në këtë rast, kontraktori është i detyruar të ruajë, pa asnjë ndryshim çmimet për njësi (si për nënzërat edhe për zërin LS) të përcaktuara në ofertën e dorëzuar.
- Ndryshimi i çmimeve në situacionin përfundimtar krahasuar me çmimet në preventivin bazë apo të ndryshuar, është në kundërshtim me kontratën për punë publike me nr. 2533 prot, datë 01.12.2016 me objekt "Rikonstruksion i kanalit ujitës Vendreshë (Dega e majtë dhe e djathtë)"Bashkia Skrapar , neni 28: çmimi i kontratës, pika 28.1, ku citon se: çmimet e kontraktorit për punët e kryera sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar

nga kontraktori në ofertën e tij. Pra, pavarësisht ndryshimit të volumeve të nën zërave brenda zërit të punimeve Lum Sum, nuk duhet të ndryshojë çmimi asnjëherë. Në situacionin përfundimtar, por edhe në preventivin e rishikuar, duhej të ndryshonte volumi/sasia dhe jo çmimi. Sa më sipët trajtuar, grupi i auditimit nuk e merr në konsideratë observacionin e paraqitur.

- Lidhur me zërin "Gërmim dheu themel muri mbajtës", ju sqarojmë se, pavarësisht pretendimit se muret mbajtese janë piketuar dhe ndërtuar në zonat ku kanalet vaditëse të të dy krahëve kanë patur rrëshqitje, argumenti Juaj nuk qëndron sepse referuar librezës së masave, gjatësia e gërmimit të dheut nuk është e njëjtë me gjatësinë e themelit dhe të murit mbajtës. Sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit pa Nr. Prot, Datë 28.11.2016 dhe kontratën e zbatimit të punimeve nr. prot. 2533, datë 01.12.2016, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Skrapar dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik "F." SHPK & "Sh. 07" SHPK.

Impakti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Skrapar.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt preventivit. Vlera prej **399,493 lekë pa TVSH**, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Skrapar.Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: **znj. N. M., me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.**

Rëndësia: E ulët

Për këtë rekomandojmë: Nga Bashkia Skrapar, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **399,493 lekë pa TVSH** nga Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve Ekonomik "F." SHPK& "Sh. 07" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2533 prot, datë 01.12.2016 me objekt "Rikonstruksioni i kanalit ujitës Vendreshë (dega e majtë dhe e djathtë)", Bashkia Skrapar, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

4. Hartimi dhe zbatimi i kontratës së punimeve me objekt "Rikonstruksion i rrugës Alush Grepcka" Bashkia Skrapar, me vlerë të kontratës 30,596,460 lekë me TVSH, datë 16.03.2017.

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik.

Situata: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Rikonstruksion i rrugës Alush Grepcka" Bashkia Skrapar, me vlerë 30,596,460 lekë me TVSH, fituar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "F." SHPK & "Sh. 07" SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera në objekt, në vlerën **276,688 lekë pa TVSH.**

Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

Ka patur likuidime për punime ndërtimit të pakryera, për zërat e punimeve: Shtresë pllaka betoni h=6cm; shtresë stabilizanti trotuar h=15 cm dhepllaka trotuari betoni h= 6 cm. Nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet dhe zërat e punës të

pasqyruara në situacionin përfundimtar si dhe atyre të kryera në fakt, rezultoi se këta zëra punimesh nuk janë kryer sipas volumeve të preventivit të ndryshuar, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën 276,688 lekë pa TVSH.

***Komente nga subjekti i audituar**: Për sa më sipër janë bërë kundërshti nga mbikëqyrësi i punimeve "A." SHPK dhe sipërmarrësi i punimeve "F." SHPK, përcjellë në mënyrë elektronike, mbi Akt-Konstatimin Nr. 6, datë 26.02.2020 ku në mënyrë të përmbledhur thuhet: 1. Për zërin me Nr.rendor 4. me përshkrim "Shtrese pllaka trotuari betoni h=6cm" të cilin Ju keni referuar si ze ne manualin teknik te cmimeve te ndërtimit e konkretisht zerit me nr. Analize 3,620 ku sipas manualit parashikohet edhe shtrese betoni me trashësi h=6cm, me titull "Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka", Ju sqarojmë se zëri me nr. Rendor 4 në preventiv ka pershkrimin "Shtrese pllaka trotuari betoni h=6cm" dhe jo siç e pershkruan analiza me numer 3,620, pra janë dy përshkrime te ndryshme nga njera-tjetra, e njëkohësisht preventivi i tenderuar nuk i është referuar numrit të analizës teknike (3,620), por është bosh. Ndërkaq në këto rrethana nga ana e kompanisë kontraktore çmimi njësi për këtë zë punimi është bazuar në analizen teknike të hartuar nga vete kjo e fundit e cila nuk përmban shtrese betoni h=6cm apo 10cm, por vetem pllaka betoni për trotuar h=6cm, shtrese rëre niveluese h=4÷5cm dhe transport te materialeve, te cilën po Jua veme në dispozicion.*

***2.** Për zërin me Nr.rendor II & IV. me përshkrim"Shtrese stabilizanti trotuar h=15cm" dhe "Shtrese pllaka trotuari betoni h=6cm", sqarojmë se nisur nga azhornimi i bërë në këtë objekt, detajimit në librezën e masave për çdo zë të sipërpërmendur, sipërfaqet e trotuarit të cilat janë vendosur pemët përbejnë një sipërfaqe pre 574m^2 dhe jo 615m^2, pasi sasia e plote prej 615m^2 të trotuarit jane përfshire edhe sheshet para pallateve dhe rrugicat hyrëse ne banesat private, prandaj shprehim se kjo diference duhet te përllogaritet ne këtë forme: (Shtrese stabilizanti trotuar h=15cm; 574m^2 – 551m^2 = 23m^2 * 617l/m^2= 14,191 leke; Pllaka trotuari betoni h=6cm 574m^2 – 551m^2 = 23m^2 * 1400l/m^2= 32,200 leke; Total ne leke pa tvsh 46,391 leke).*

Në përfundim për të gjitha konstatimet tuaja, mbështetur në përshkrimet e sqarimet e mësipërme të bera nga ne si mbikëqyrës punimesh, me bashkëpunimin edhe te sipërmarrësit si edhe në mbështetje të librezës së masave të secilit zë pune, nga ku del që nuk ekzistojnë diferenca volumesh në punimet e realizuara, ndaj lutemi merrni në konsideratë këtë observacion dhe rivlerësoni situatën e objektit.

***Qëndrimi i grupit të auditimit:** 1. Lidhur për zërin e punimeve 4(3.620) "Shtrese pllaka trotuari betoni h=6cm", grupi i auditimit pasi e lexoi me kujdes sqaron: Qëllimi i observacionit të bërë nga subjekti i audituar, është të paraqesë fakte dhe argumente të cilat provojnë të kundërtën e problematikës së trajtuar nga grupi i auditimit, pra të justifikojnë kryerjen e punimeve të ndërtimit. Në fakt, ju në observacionin Tuaj, për punimet në trotuar, nuk keni provuar se, është realizuar shtresa e betonit në zbatim të zërit 3(2.262) "Shtresë betoni trotuar M-150, h=10 cm" si dhe shtresa e betonit si nën zë punimi tek zëri 4(3.620) "Shtresa pllaka trotuari betoni h=6cm", pra nuk keni argumentuar as paraqitur ndonjë fotografi të paketës së trotuarit, që krijon idenë e realizimit të dy shtresave të betonit, prandaj observacioni nuk merret në konsideratë.*

2. Lidhur me diferencën e sipërfaqes të pllakave në trotuar, për shkak të mos zbritjes së pemëve, kemi zbritur 64 copë pemë x 1 m^2= 64 m^2 dhe nuk jemi dakord me llogaritjen që keni bërë, sepse sipërfaqja për t'u zbritur është 64 m^2 dhe jo 23 m^2, siç e keni llogaritur ju. Sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit pa Nr. Prot, Datë 28.11.2016 dhe kontratën e zbatimit të punimeve pa nr. prot., datë 21.03.2017, kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 646 prot, datë 16.03.2017 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Skrapar dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik "F." SHPK & "Sh. 07" SHPK.

Impakti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Skrapar në vlerën **276,688 lekë pa TVSH.**

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt preventivit. Vlera prej276,688 lekë pa TVSH, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Skrapar.Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. E. M., me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.

Rëndësia: E ulët

Për këtë rekomandojmë: Nga Bashkia Skrapar, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **276,688 lekë pa TVSH** nga Bashkimi i përkohshëm i Operatorëve Ekonomik "F." SHPK& "Sh. 07" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 646 prot, datë 16.03.2017 me objekt "Rikonstruksion i rrugës Alush Grepcka", Bashkia Skrapar, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

5. Hartimi dhe zbatimi i kontratës së punimeve me objekt "Rikonstruksion i zyrave të M.K.Z-së Bashkia Skrapar" me vlerë të kontratës 4,801,956 lekë me TVSH, datë 22.05.2018.

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik.

Situata: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Rikonstruksion i zyrave të M.K.Z-së Bashkia Skrapar" Bashkia Skrapar, me vlerë 4,801,956 lekë me TVSH, fituar nga Operatori Ekonomik "A." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera në objekt, në vlerën **197,543 lekë pa TVSH**.

Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

Ka patur likuidime për punime ndërtimit të pakryera, për zërat e punimeve: Prishje suva mur i brendshëm; suvatim muri i brendshëm, shtresë me pllaka gress. Nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet dhe zërat e punës të pasqyruara në situacionin përfundimtar si dhe atyre të kryera në fakt, rezultoi se këta zëra punimesh nuk janë kryer sipas volumeve të preventivit të ndryshuar, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën 197,543 lekë pa TVSH.

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit pa Nr. Prot, Datë 21.05.2018

dhe kontratën e zbatimit të punimeve me nr. 1224 prot., datë 22.05.2018, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Skrapar dhe Operatorit Ekonomik "A." SHPK.
Impakti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Skrapar **197,543 lekë pa TVSH**
Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas projekt preventivit. Vlera prej 197,543 lekë pa TVSH, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Skrapar. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. N. V., me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.
Rëndësia: Eulët
Për këtë rekomandojmë: Nga Bashkia Skrapar, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **197,543 lekë pa TVSH** nga Operatori Ekonomik "A." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1224 prot, datë 22.05.2018 me objekt "Rikonstruksion i zyrave të M.K.Z-së Bashkia Skrapar", Bashkia Skrapar, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

E. Zbatimi i rekomandimeve.

1-<u>Titulli gjetjes:</u>Realizimi i Rekomandimeve për ndryshime ligjore, masa organizative, masa shpërblim dëmi dhe masave disiplinore, sipas cilësimeve në plan veprimin të hartuar nga subjekti audituar, duke pasqyruar punën e bërë, të analizuar për Rekomandimit e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga Rekomandimit nuk janë pranuar.

Situata: Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve **paraqitet si më poshtë:**

<u>a . Për përmirësimin e gjendjes janë</u> *rekomanduar* ***11 masa organizative****, nga të cilat janë pranuar plotësisht 11 masa, nga të pranuarat* **,** janë zbatuar plotësisht 6 masa, janë në proces zbatimi 4 masa, është e pazbatuara 1 masa.

b.<u>Për **shpërblim dëmi** janë rekomanduar</u>*12 masa me vlerë* **368,826 mijë lekë**, nga verifikimi rezultoi se *deri më datë 31.12.2019,*vlera debitore nuk është kontabilizuar dhe pasqyruar në llogarinë 468 – "Debitorë të tjerë", të Pasqyrave Financiare më datën 31.12.2018 (bilanci vjetor 2018).

Nga verifikimi rezultoi se nga shuma e rekomanduar nga KLSH për vlerën **368,826 mijë lekë,** deri në datën e mbajtjes së këtij akti është bërë i mundur të arkëtohet vlera **206 mijë lekë** (ose 0.05% e rekomandimit) dhe mbetet për arkëtim vlera **368,620 mijë lekë**, *nga e cila:* në proces arkëtimi 94 mijë lekë, në proces gjyqësore vlera 363,229 mijë lekë dhe nuk pranohet nga subjektet e atakuara vlera 768 mijë lekë.

<u>c. Janë rekomanduar 8 masa disiplinore</u>*, gjendja e të cilave paraqitet;*

c.1-Për 2 punonjës për shkelej në fushën e prokurimeve është rekomanduar masa disiplinore ***"Largim nga Shërbimi civil"***, nga verifikimi rezulton se *:* .

Nga ana e KLSh është kërkuar ***"Largim nga Shërbimi civil" për z. N. G. dhe z. B. M. për t***ë meta e mangësi të konstatuara në zbatimin e ligjit nr, 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, në cilësinë e anëtarit të KVO në tenderat me objekt; "Ndërtim i unazës Jug-lindore të qytetit Çorovodë " (Faza e

dytë) viti 2014, "Sistemim asfaltim dhe ndriçim i segmentit rrugorë Akitekt Kasemi" viti 2014 dhe **trajtim të pabarabartë të ofertuesve duke shkaktuar dëmekonomik 7,698,208 lekë** pasi nuk është zbatuar kriteri themelorë i DST të tenderit "Çmimi më i ulët". Me Vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë datë 04.10.2018 është vendosur pushimi i çështjes për të akuzuarit. Si rrjedhojë ezaurohet masa e kërkuar nga KLSH në lidhje me këta persona.

c.2-Nga 3 masa disiplinore *"*Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj"parashikuar në nenin 58 shkronja (b), nga verifikimi rezulton se:

Për tre punonjës me kontratë nga 1/3 e pagës për gjashtë muaj eshte zëvëndësuar me 1/5 për muaj.

- me urdhër nr 61/1 datë 31.05.2016 për z. Sh. Ç. me detyrë ish-Pergjegjës i taksave e tarifave vendore ;
- me urdhër nr 61/2 datë 31.05.2016 për z. V. N. me detyrë ish-Pergjegjës i taksave e tarifave vendore ;
- me urdhër nr 61/1 datë 31.05.2016 për zj.R. L. me detyrë juriste në Bashkinë Skrapar.
- me urdhër nr 61/2/1, datë 31.10.2016 për zj.R. L. është pezulluar masa disiplinore 1/5 e pagës për një muaj deri në marjen e formës së prerë të procesit gjyqësor të nisur.

c.3- Nga 3 masa disiplinore "Vërejtje deri në Zgjidhje të kontratës së Punës"nga verifikimi rezultoj se: Janë zbatuar masat e dhëna nga KLSH, për z. F. T. për të cilin është kërkuar zgjidhje e kontratës së punës duke qenë se është pjesë e KVO për të cilën është shprehur Gjykata konsiderohet e ezauruar masa e dhënë ndaj tij.

d.*Kërkuar* ***APP****,****3 masa administrative****, Për këtë rekomandim Agjencia e Prokurimit Publik, ka dërguar vendimi nr.58 datë 24.06.2016 në të cilin ka vendosur* të dënojë me gjobë 3 punonjës në vlerën 70,000 lekë seicili, ndërsa për 3 punonjnës i është propozuar titullarit të AK marrjen e masës disiplinore, ku nga verifikimi rezultoi se nga ana e AK nuk është marë asnjë masë.

Në lidhje me vendimin e APP nuk është ndërmarë asnjë veprim, si për marrjen e masa disiplinore ndaj anëtareve të NJP po ashtu dhe për kontabilizimin dhe arkëtimin e gjobës së anëtarëve të KVO për vlerën 70.000 lekë, pasi cështja ka qënë në proces gjyqësor, ku me vendimin nr 60-2018 datë 04.10.2018 të Gjykatës së Apelit Vlorë çështja është pushuar. Gjykata është shprehur në lidhje me faktin se ka pasur vepër penale apo jo në ngarkim të shtetasve, ndërsa përgjegjësia dhe masa administrative e vendosur nga APP nuk është kundërshtuar në Gjykatën Administrative përkatëse.

Për gjobat e vendosura nga APP, me vendimin nr.58, datë 24.06.2016 **nga Bashkia Skrapar,Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Financës të kontabilizohen vlera e vendimeve të gjobave të vendosura nga APP, KLSH rikërkon që të meren masat e mëposhtme:**

a) Të marrë masa për dërgimin në Gjykatë dhe kthimin në tituj ekzekutiv, të vendimeve të gjobave të vendosura nga APP, sikurse parashikohet në ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", konkretisht në nenin 24-*Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv.*

b) Të marë masa për llogaritjen e kamat vonesave për gjobat e vendosura nga APP,bazuar në ligjin nr.10279,datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative"**,neni 30-"Arkëtimi i shumave të detyrimeve"**ku parashikohet se:

3.Pas kalimit të këtij afati, për çdo ditë vonesë paguhet **kamat 2 për qind në muaj të masës gjobës**, me përjashtim të rasteve kur ligji i posaçëm parashikon përqindje të ndryshme për kamatëvonesat.

c. Kryetari i bashkisë, **të fillojë procedurat e largimit nga puna**,ndaj personit përgjegjës i cili nuk ka nisur procedurat e nevojshme ligjore të vënies në ekzekutim të aktit administrativ (vendimit të gjobës), bazuar në ligjin nr.10279,datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative"**,** pika 5) ku parashikohet se **-neni 44 " Përgjegjësia e punonjësit të organit administrativ"**, në rast se gjobat dhe detyrimet e tjera, të vendosura nga vendimi për kundërvajtjen administrative, nuk paguhen për mosveprim të punonjësit të organit administrativ, i cili ka miratuar vendimin përkatës dhe detyrimin që të kërkojë arkëtimin e shumave, apo për shkak se punonjësi nuk nis procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ, **atëherë ndaj tij fillojnë procedurat e largimit nga puna.**

d. Drejtoria Juridike, bazuar në nenet 151 dhe 152, të "Kodit Procedurës Civile në RSH", të marrin masa dhe të kërkojë në Gjykatë rivendosjen në afat për vendimet e dënimit me gjobë të vendosura nga APP, të cilave u ka kaluar afati ligjor 2 vjeçar, duke shtuar në kërkesat drejtuar Gjykatës edhe llogaritjen e kamat vonesave .

e) *Bazuar në ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar,pika 4. Përgjegjësia për vjeljen e gjobave, të vendosura sipas pikës 1, të këtij neni, është e autoritetit kontraktor.Për mos nxjerrjen e urdhrave dhe njoftimeve për ekzekutimin e vendimit të APP nr. nr.58, datë 24.06.2016,për 3 persona në vlerën në total prej 210.000 lekë dhe mos fillimin e procedurave ligjore për kryerjen e ndalesave z. N. S., ish-kryetari i Bashkisë Skrapar, bëhet përgjegjës për kalimin e afateve ligjore të parashkrimit të vendimeve prej 2 vjetësh (vlerave) të gjobave të përcaktuar në nenin 46 të ligjit nr.10279,datë 20.05.2010"Për kundërvajtjet administrative",sipas vendimeve administrative të dënimit me gjobë.*

*e.**Masa administrativë për IMT bashkia Skrapar*.** Me shkresën 1196/14 datë 13.05.2016 Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka kërkuar kryetarit të Bashkisë Skrapar që nëpërmjet Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit strukture pranë bashkisë që të vlerësojë shkeljet e konstatuaranga auditimi i kryer në "Bashkinë Skrapar"të paraqitura në këtë shkresë dhe dokumentacionin bashkëlidhur të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur dënimin me gjobë për tre mbikëqyrësit dhe një kolaudator të punimeve.

Gjatë auditimit rezultoi se pavarësisht nga puna e bërë, për disa nga masat e mësipërme, jeni mjaftuar vetëm me nxjerrjen e urdhrave për kryerjen e ndalesave, pa u shoqëruar në të gjitha rastet me padi gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara, për pasojë ndaj personave shkaktarë nuk ka filluar kryerja e ndalesave, duke u bërë përgjegjës për kalimin e afateve ligjore të kërkimit të dëmit, përcaktuar në nenin 115, të Kodit Civil në R.SH dhe nenit 203 të Kodit Punës në R.SH (prej 3 vjetësh) apo të parashkrimit të vendimeve (vlerave) të gjobave përcaktuar në nenin 46 të ligjit "Për kundërvajtjet Administrative" (brenda 2 vjetësh), sipas vendimeve administrative të dënimit me gjobë.

1.Nga verifikimi, rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Skrapar rekomandimet mbi auditimin e kryer me objekt "Dërgim Raporti Përfundimtar dhe rekomandime" me shkresën nr. 1196/14 datë 13.05.2016, protokolluar në subjekt

me shkresën nr. 1028 datë 17.05.2016, ndërsa nga Bashkia Skrapar për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën nr. 1175 datë 06.06.2016 me objekt "dërgim plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve".
Pra përgjigja e Bashkisë Skrapar për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit 20 ditë nga data e dërgimit të shkresës, siç shprehet dhe në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2914 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit", nenin 15 germa (j) të drejtat e KLSH.

Zbatuar

2. Raporti Përfundimtar i auditimit të KLSh dhe rekomandimet e auditimit janë derguar me shkresën e saj nr. 1196/14 datë 13.05.2016, protokolluar në subjekt me shkresën nr. 1028 datë 17.05.2016, ndërsa nga Bashkia Skrapar për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën nr. 258/1 date 21.02.2017.

Zbatuar

Kriteri:	Veprim në shkelje të nenit 15, shkronja (j) dhe nenit 30 pika 2, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2914 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit" "Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Skrapar".
Impakti	Mos ndjekje të procedurave në arkëtimin e detyrimeve për masa shpërblim dëmi në vlerën 368,826 mijë lekë.
Shkaku	Përgjegjësi e strukturave drejtues.
Rëndësia:	**E lartë**
Rekomandimi:	Kryetari i Bashkisë në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak të analizojë Raportin e Auditimit të kryer në Bashkinë Skrapar, duke analizuar të gjitha shkeljet dhe rekomandimet e dhëna nga KLSH për nxjerrjen e përgjegjësive të personave përgjegjës dhe marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve dhe përmirësimin e punës në të ardhmen, kjo në zbatim të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", nenit 50-Auditimi i jashtëm pika 4 dhe 5 ku përcaktohet se;. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo audites të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht ne këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij.

VI. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Llogaria 215 "Mjete transporti" për vitin 2017 ka vlerën 85,652,568 lekë, për vitin 2018 ka vlerën 36,938,529 lekë dhe për vitin 2019 vlerën 20,145,397 lekë (vlerë neto kontabël). Për periudhën e auditur 2017-2019 kjo llogari nuk pasqyron saktë vlerën e mjeteve të transportit për arsye se në këtë llogari është paraqitur edhe vlera bruto 8,106,500 lekë (vlerë neto 2,178,637 lekë për vitin 2019), që përfaqëson 4 mjete transporti të cilat nuk ekzistojë, nuk ka fletë inventari, nuk ka person përgjegjës material. Këto aktive për vitin 2017 dhe 2018 nuk i janë nënshtruar procesit të inventarizimit. Bazuar në rezultatet e komisionit të inventarizimit për vitin 2019 (detyrë që është kryer gjatë vitit 2020), këto mjete nuk gjenden, nuk ekzistojnë. Gjithashtu nga sektori i aseteve raportohet se njësia vendore ka 16 mjete të transporti të dëmtuara në vlerën historike 33,060,842 lekë, por ky klasifikim është jo argumentues, sepse nuk u paraqit dokumentacion që të vërtetojë se këto mjete i janë nënshtruar vlerësimit të tyre nga komisioni i vlerësimit të aktiveve, i cili ka tagrin e një përcaktimi të tillë.
U konstatuan mos rakordime midis gjendjes së aktiveve që disponon në mënyrë shkresore Sektori i Aseteve dhe gjendjes që disponon Nëpunësi Zbatues.
Veprimet dhe mos veprimet e mësipërme, përbëjnë mungesë përgjegjësie nga ana e nëpunësit zbatues, përgjegjësit të sektorit të aseteve dhe komisioneve të inventarizimit për vitin 2017 dhe 2018, si dhe janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*", kapitulli II, pika 11, aneksi 1,pika 2/1,Trajtimi kontabël dhe rastet e daljeve të aktiveve afat gjata, germat "e" dhe "f" dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pikat 12, 26, 27, 30, 31,74, 81, 85 *(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 31-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Skrapar të vlerësoj me komision gjendjen e 16 mjete të transporti të dëmtuara në vlerën historike 33,060,842 lekë dhe pas përfundimit të vlerësimit të përcaktojë listën e mjeteve të dëmtuara. Pas kësaj për mjetet të cilat rezultojnë se nuk mund të rikthehen në gjendje pune për shkak të kostove të larta të riparimit, të vazhdohet me procedurat e mëtejshme të nxjerrjes jashtë përdorimit e shitjen e tyre për skrap. Ky proces të përshpejtohet, me qëllim që të mos mbahen mjete të dëmtuara nën ruajtje, në kushtet kur për to nuk ka vende të posaçme dhe persona përgjegjës për ruajtjen e tyre për 24 orë dhe, në këtë mënyrë mjetet pavarësisht gjendjes që kanë, bëhen objekt i humbjes apo i vjedhjes.Për katër mjetet e transportit të cilat nuk gjenden, pasi të bëhen zhdëmtimet nga personat përgjegjës (trajtuar më gjerë te rubrika e dëmit ekonomik), të bëhen rregullimet përkatëse në librat kontabël. Regjistri i aseteve të mbahet si nga Sektori i aseteve edhe nga Drejtori ekonomik dhe në mënyrë periodike të rakordohet mes tyre për saktësinë e tij.

Deri më datën 30.06.2020

2. Gjetje nga auditimi: Bazuar në pasqyrat financiare Llogaria 210 "Toka, troje, terrene" dhe llogaria nr. 211 "Pyje, kullota, plantacione", për të tre vitet 2017, 2018 dhe 2019 kanë respektivisht vlerën e pa ndryshueshme 2,843,818 lekë dhe 6,851,988 lekë. Vlerat e këtyre llogarive nuk pasqyrojnë saktë pasurinë reale të njësisë vendore për shkak se në to nuk janë përfshirë një numër i konsiderueshëm asetesh të njësisë vendore, të cilat me VKM të posaçme kanë kaluar në pronësi të saj. Njësia vendore nuk ka marrë masa për regjistrimin e këtyre pasurive në ZVRPP dhe mungesa e certifikatave të pronësisë, ka sjellë edhe mos pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare. Nga njësia vendore për këto prona nuk është hartuar regjistër i aktiveve, nuk ka një listë përfundimtare se cili është numri dhe vlera e tyre të cilat

janë të pa regjistruara në ZVRPP. Këto asete nuk janë inventarizuar për periudhën 2017-2019. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, neni 15, pika 1 dhe 2, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", kapitulli IV. pika 74 dhe 96 dhe të UMF nr. 8 datë 9.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*" *(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 31-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1. Rekomandim: Titullari i njësisë vendore dhe Drejtori Ekonomik, të marrin masa për saktësimin e aseteve të llogarisë "210 "Toka, Troje, Terrene*"* dhe llogarisë nr**.** 211 "Pyje, kullota, plantacione, duke kryer inventarizimin e tyre dhe hartimin e regjistrit kontabël, me të gjitha të dhënat e nevojshme (vendndodhje, sipërfaqja etj.). Në vijim të këtyre veprimeve të merren masa për regjistrimin e këtyre aseteve në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare.

Deri më datën 30.09.2020

3. Gjetje nga auditimi: Bashkia Skrapar në datën 31.12.2019 ka detyrime të prapambetura për faturat e pa likuiduara në vlerën 42,810 mijë lekë, nga e cila vlera prej 28,092 mijë lekë i përket Bashkisë dhe vlera prej14,718 mijë lekë i përket Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike. Vlera 28,092 mijë lekë (vetëm Bashkia) përbëhet nga detyrime për investime në vlerën 8,005 mijë lekë, detyrime për shërbime në vlerën 471 mijë lekë, për mirëmbajtje në vlerën 2,839 mijë lekë, detyrime të tjera 8,523 mijë lekë, detyrime për vendimet gjyqësore të cilat kanë marrë formën e prerë për vlerën 8,252 mijë lekë. Nga shuma e mësipërme prej 28,092 mijë lekë, vlera prej 17,113 mijë lekë i përket faturave të pa likuiduara (kreditorëve) për periudhën janar 2017-dhjetor 2019.

Për vlerën 14,718 mijë lekë, detyrim i prapambetur më 31.12.2019, e cila i përket Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, peshën specifike e zënë detyrimet për energjinë elektrike, në vlerën 9,770 mijë lekë, ose 66% të totalit të të gjithë detyrimeve, nga i cili vlera prej 6,386 mijë lekë është principal, ndërsa vlera prej 6,555 mijë lekë është kamat-vonesë. Ky detyrim i mbartur i përket periudhës dy vjeçare 2010-2011 dhe vjen si rezultat i mos kryerjes në kohë të pagesave për 17 kontrata të energjisë elektrike për ndriçimin rrugor të qytetit. Nga auditimi konstatohet se nuk janë marrë të gjitha masat e duhura për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar, neni 40 "E drejta për të kryer shpenzime"; UMF nr. 5, datë 27.02.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura" ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014;Udhëzimin plotësues nr. 2 të MF, datë 10.01.2018 "Për buxhetin e vitit 2018", pikat 82-91 "Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore"; UMF nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore" *(Më hollësisht trajtuar në pikën B.1, faqe 18-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Skrapar të analizohet situata e detyrimeve të prapambetura dhe të nxirren përgjegjësitë për këtë situatë. Të mos marren anagazhime te reja buxhetore (shpenzime të reja), pa paguar detyrimet e prapambetura, si dhe në vazhdim të mos krijohen detyrimeve të reja të prapambetura. Kjo të realizohet duke mos marrë angazhime buxhetore, pa pasur fonde në dispozicion në llogarinë e thesarit. Për detyrimet e prapambetura, të hartohet një grafik për likuidimin e tyre, duke zbatuar radhën e pagesave sipas kronologjisë së tyre. Të paraqitet në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara si dhe planin për likuidimin e tyre.

Në mbledhjen me të afërt të Këshillit Bashkiak

4. Gjetje nga auditimi: Në llogarinë nr. 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*", nuk është likuiduar vlera 5,434 mijë lekë, e cila përfaqëson detyrime të Bashkisë Skrapar ndaj subjekteve, si garanci për punime të kryera për 24 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia dhe ish Komunat. Nga njësia vendore nuk janë marrë masa për zbatimin e detyrimeve kontraktuale, duke mos u njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme. Për sa më sipër është vepruar në kundërshtim me UMF nr. 8 datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", si dhe kushtet e kontratës të lidhur midis palëve*(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 31-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

<u>4.1.Rekomandim</u>: Kryetari i Bashkisë Skrapar të analizojë cilat janë shkaqet e mos likuidimit të vlerës 5,434,875 lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së punimeve për 24 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim. Nga Titullari dhe Drejtorit ekonomik të merren masa për likuidimin e vlerës së mësipërme, por duke analizuar më parë gjendjen nëse është përmbyllur garancia e defekteve të punimeve dhe nëse janë bërë korrigjimet e punimeve për çdo kontratë së cilës nuk i është likuiduar kjo garanci. Nëse ka defekte dhe mos realizime të punimeve, atëhere kjo vlerë nuk duhet të likuidohet.

Deri më datën 30.06.2020

5. Gjetje nga auditimi: Bazuar në të dhënat e marra nga Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Skrapar dhe sipas të dhënave të zyrës së Kadastrës të Bashkisë, planifikimi i të ardhurve nga taksa mbi pasurinë, e cila përbëhet nga taksa mbi ndërtesën, taksa mbi truallin dhe taksa mbi tokën bujqësore, ka ardhur duke u zvogëluar për vitin 2018 dhe 2019 krahasuar me vitin 2017.

Planifikimi për taksën mbi pasurinë për vitin 2017 ka vlerën 13,069,000 lekë, për vitin 2018 kjo taksë është planifikuar 9,198,000 lekë, ose 3,871,000 lekë më pak, ndërsa për vitin 2019 planfikimi është 10,035,000 lekë, ose 3,034,000 lekë më pak se viti 2017. Këto ulje me ndryshime të sipërfaqeve të pasurive, janë të pa argumentuara nga sektori i taksave dhe tarifave vendore, duke mos dhenë shpjegime konkrete *(Më hollësisht trajtuar në pikën B1, faqe 18-22 dhe B.2, faqe 22-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

<u>5.1. Rekomandim:</u>Kryetari i Bashkisë Skrapar të analizojë situatën dhe të përcaktoj shkaqet e diferencave në planifikimin e taksës mbi pasurinë për vitin 2018 dhe 2019. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për një planifikim të saktë të taksës mbi pasurinë (taksa mbi ndërtesën, taksa mbi truallin dhe taksa mbi tokën bujqësore), bazuar në të dhënat konkrete zyrtare, për tokën bujqësore, tokën truall dhe sipërfaqen e ndërtesës.

Deri më datën 31.07.2020

6. Gjetje nga auditimi: Bashkia Skrapar nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Nuk janë hartuar rregulla për mbrojtjen dhe ruajtjen e të dhënave elektronike (sistem rezervë back-up), si dhe ruajtjen e aktiveve, mungesë e cila reflektohet edhe në mos evidentimin e mungesës fizike të katër mjeteve të transportit për një periudhë tre vjeçare. Nuk është hartuar regjistri i riskut, dokumenti i listës (hartës) së proceseve të punës dhe dokumenti i gjurmës së auditimit nga asnjë sektor dhe drejtori, si dhe në nivel institucioni. Nuk njihet si duhet nga menaxherët kryesor baza ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Në fund të çdo viti vlerësimi i funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit nuk është bërë si duhet nga menaxherët kryesor, duke mos përcaktuar nga njëri vit në tjetrin, pikat e dobëta të këtij sistemi, e mbi bazën e tyre marrjen e masave për përmirësimin e sistemit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim

me kërkesat e nenit 8, 16, 22, 23, 24, të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe kërkesat e "Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin", miratuar me urdhër të Ministrit të Financave, nr. 8980, dt. 15.07.2010 *(Më hollësisht trajtuar në pikën A, faqe 15-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Skrapar dhe menaxherët kryesor të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësinë vendore. Për këtë më parë të kryhen trajnime për njohjen e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe kërkesat e "Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin". Të hartohen rregulla për ruajtjen e aktiveve, për llojet e raporteve, frekuencën e raportimit me shkrim te Titullari nga secila drejtori/sektor, etj. Në nivel sektori, drejtorie dhe institucioni të hartohet regjistri i riskut, gjurma e auditimit dhe lista (harta) e proceseve të punës.

Deri më datën 31.08.2020

7. Gjetje nga auditimi: Në njësinë vendore Bashkia Skrapar struktura e njësisë së auditimit të brendshëm është miratuar me tre punonjës, por kjo strukturë është e pa plotësuar, pasi aktualisht kryen detyrën e audituesit të brendshëm vetëm një punonjës. Mungesa e plotë e stafit të kësaj strukture ka sjellë si pasojë edhe numrin e ulët të auditimeve, mos mbulimin me auditim të të gjitha fushave kryesore të aktivitetit të njësisë vendore, por edhe mos arritjen e duhur të cilësinë e auditimeve, pasi zbulimet nuk justifikojnë problematikat ekzistuese të konstatuara nga grupi i auditimit. Planifikimi i auditiveve të miratuara nuk është realizuar, pasi nga shtatë auditime të planifikuara (2 auditime financiare, 3 auditime përputhshmërie, 2 auditime të kombinuara) janë realizuar katër prej tyre.

Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka kryer auditime në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, të tilla si prokurimet publike, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, taksat dhe tarifat vendore, etj. Për këtë arsye kjo njësi nuk i ka dhënë mbështetjen e duhur Kryetarit të Bashkisë për arritjen e objektivave, pasi nuk janë kryer auditive bazuar në vlerësimin objektiv të riskut. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e pikës 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, nenin nr. 5 dhe nr. 6 të ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" *(Më hollësisht trajtuar në pikën A, faqe 15-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Skrapar të marrë masa për plotësimin e njësisë së auditit të brendshëm me tre punonjës. Njësia e Auditimit të Brendshëm, në planet e saj vjetore të programoj auditime në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, si ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, të ardhurat, pasqyrat financiare etj., në mënyrë që nëpërmjet rekomandimeve përkatëse ti jepet mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave. Kjo njësi të ketë në monitorim të vazhdueshëm funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Deri më datën 30.09.2020

8. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2017-2019 kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës 18 punonjës (me detyra të ndryshme si nënkryetar, shef kabineti, drejtor shërbimesh, punonjës taksash, përgjegjës shërbimesh, magazinier etj), të cilët përpara largimit nga puna nuk kanë bërë dorëzimin e detyrës me procesverbal (dorëzimin e dosjeve shkresore, elektronike, pra të gjithë punës së krijuar prej tyre gjatë qëndrimit në institucion). Nuk janë hartuar rregulla të shkruara për veprimet që duhet të kryhen nga punonjësi gjatë marrjes dhe dorëzimin e detyrës, si dhe veprimet që kryejnë strukturat e tjera të institucionit në këtë proces (Njësia e burimeve njerëzore, Financa etj.). Këto veprime nuk garantojnë ruajtjen e aktiveve, bazën e të

dhënave, transmetimin e të dhënave lidhur me punën nga një punonjës te tjetri, duke krijuar vështirësi për punonjësit e rinj. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 13, VKM nr. 124, datë 17.2.2016 "Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil, pikat 27 deri 30, Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, nenin 25 "Detyrimi i dhënies llogari dhe i kthimit" *(Më hollësisht trajtuar në pikën A, faqe 15-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1. Rekomandimi: Nga Titullari i njësisë vendore të hartohen rregulla të shkruara për veprimet që kryhen nga punonjësi dhe strukturat përkatëse të kësaj njësie gjatë marrjen dhe dorëzimin e detyrës. Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Financës, të marrin të gjitha masat e nevojshme që përpara largimit nga puna, punonjësi të bëjë dorëzimin e plotë të dokumentacionit që ka për shkak të detyrës, si dhe të inventarit fizik në ngarkim, sipas kartelës përkatëse për këtë qëllim.

Deri më datën 31.07.2020

9. Gjetje nga auditimi: Bashkia Skrapar është audituar nga KLSH në vitin 2016 dhe në vijim është bërë verifikimi i zbatimit të rekomandimeve. Me shkresën nr. 1113/101, datë 31.01.2017 është rikërkuar zbatimi i masave të pa zbatuara. Nga 11 masa organizative të rekomanduara e të pranuara janë zbatuar plotësisht 5 masa, janë në proces zbatimi 5 masa dhe nuk është zbatuar 1 masë. Nga 12 masa për shpërblim e dëmi në vlerën 368,826 mijë lekë është zbatuar 1 masë me vlerë 206 mijë lekë, vlera prej 363,229 mijë lekë është në proces gjyqësore dhe nuk është arkëtuar vlera 768 mijë lekë. Në zbatim të rekomandimeve të KLSH, Agjencia e Prokurimit Publik ka dërguar vendimi nr. 58 datë 24.06.2016, në të cilin ka vendosur të dënojë me gjobë tre punonjës në vlerën 70,000 lekë secili, por kjo masë nuk është zbatuar *(Më hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 90-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të KLSH në auditimin e mëparshëm. Të vazhdojë ndjekja dhe zbatimi i masave që rezultojnë ende të pa zbatuara dhe të përshpejtojë ato që janë në proces. Për këtë nga Titullari i njësisë vendore të hartohet plan pune i veçantë.

Deri më datën 30.06.2020

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15 germa (b) dhe (c) *–Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", **nga Titullari i Njësisë Publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **5,296,896 lekë si më poshtë:**

1. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2017 dhe 2018 procesi i inventarizimit për aktivet e llogarisë 215 "Mjete transporti" nuk është kryer i plotë, pasi në këtë proces nuk është përfshirë inventarizimi i katër mjeteve të transportit me vlerë kontabël 8,158,500 lekë dhe vlerë të mbetur **2,178,637 lekë**. Për periudhën objekt auditimi 2017-2019, Bashkia Skrapar

nuk disponon asnjë dokument lidhur me këto mjete, nuk ka fletë inventari, nuk ka person përgjegjës material, këto mjete nuk administrohen nga njësia vendore. Sipas rezultateve të inventarizimit të vitit 2019 (i kryer gjatë viti 2020), këto mjete nuk gjenden, nuk ekzistojnë.
Në mungesë të dokumenteve për periudhën 2017-2019, për të nxjerr përgjegjësinë materiale grupi i auditimit ju referua fletëve të inventarizimit dhe procesverbaleve të dorëzimit, përpara kësaj periudhe, nga e cila rezulton:
1- Bazuar në fletën e inventarizimit të vitit 2016, për mjetin tip "Ford Tranzit", nga inventari ish Bashkisë Çorovodë, me vlerë kontabël 400,000 lekë, personi përgjegjës material konstatohet z. F. Z., me detyrë ish drejtues mjeti, ndërprerë marrëdhëniet e punës me vendimin nr. 66 datë 17.09.2019. Kjo fletë inventarizimi është nënshkruar prej tij. Referuar tabelës së amortizimit të mjeteve të transportit të paraqitur nga Drejtori Ekonomik i Bashkisë Skrapar, **vlera e mbetur e këtij mjeti është 144,935 lekë.**
2- Bazuar në fletën e inventarizimit të ish Komunës Qendër, e cila i përket viti 2014, për mjetin tip "Fadrom", nga inventari i ish Komunës Qendër, me vlerë kontabël 2,498,500 lekë, personi përgjegjës material konstatohet z. B. B., (ish punonjës në ish Komunën Qendër), aktualisht punonjës i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, njësi vartëse e Bashkisë Skrapar, me detyrë manovrator. Kjo fletë inventari është nënshkruar prej z. B. B.. Referuar tabelës së amortizimit të mjeteve të transportit, **vlera e mbetur e këtij mjeti është 379,218 lekë.**
3- Bazuar në proces-verbalin e datës 05.08.2015, për dorëzimin e mjetit tip "Fadrom Fernec", me vlerë kontabël 3,280,000 lekë, nga Njësia Administrative Çepan në Bashkinë Skrapar, mbajtur midis tre përfaqësuesve: përfaqësuesve të Njësisë Administrative Çepan, z. A. H. dhe komisionit të Bashkisë Skrapar (të ngritur për zbatimin e VKM nr. 510,datë 10.06.2015), konstatohet si përgjegjës material për mjetin "Fadrom Fernec 865", z. A. H., ish punonjës i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, njësi vartëse e Bashkisë Skrapar, me detyrë ish ekonomist, ndërprerë marrëdhëniet e punës me urdhrin nr. 63, datë 10.12.2015.
Ky procesverbal është nënshkruar prej z. A. H.. Referuar tabelës së amortizimit të mjeteve të transportit, **vlera e mbetur e këtij mjeti është 1,188,466 lekë.**
4. Bazuar në proces-verbalin e datës 07.08.2015, për dorëzimin e automjetit "Land Rover L....8", me vlerë kontabël 1,980,000 lekë, nga inventari i ish Komunës Zhepë, mbajtur midis tre përfaqësuesve: përfaqësuesve të Njësisë Administrative Zhepë, z. A. H. dhe komisionit të Bashkisë Skrapar (të ngritur për zbatimin e VKM nr. 510, datë 10.06.2015), ashtu si për mjetin "Fadrom Fernec 865", edhe për këtë mjet, konstatohet si përgjegjës material z. A. H.. Procesverbali i datës 07.08.2015 është nënshkruar prej tij. Bashkia Skrapar nuk ka paraqitur dokumente të tjera për këtë mjet për periudhën pas vitit 2015, për të vërtetuar ndryshimin e përgjegjësisë materiale të mjetit. Bazuar në tabelën e amortizimit të mjeteve të transportit të Drejtorit Ekonomik të Bashkisë Skrapar, **vlera e mbetur e këtij mjeti është 466,018 lekë.**
Bashkia Skrapar, për katër mjetet e mësipërm nuk ka paraqitur dokumente të tjera, për të vërtetuar ndryshimin e përgjegjësisë materiale nga personat e lartëpërmendur.
Nga z. A. H. dhe z. F. Z., përpara ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, nuk është bërë prej tyre dorëzimi me procesverbal i mjetit (aktivit) që kanë pasur në ngarkim.
Gjithashtu z. B. B., aktualisht në marrëdhënie pune, nuk vërteton dorëzimin e mjetit që ka pasur në ngarkim, as në ish Komunën Qendër as në Bashkinë Skrapar pas reformës administrativo-teritoriale. Veprimet dhe mos veprimet e mësipërme lidhur me mos dorëzimin e aktiveve dhe humbjen e tyre, ngarkojnë me përgjegjësi personat e mësipërm material dhe janë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 12, 13, 23 *(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 28-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandim: Titullari i Njësisë Vendore dhe Drejtori Ekonomik, të marrin masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **2,178,637 lekë**, si detyrim për zhdëmtimin financiar nga personat e mëposhtëm, përgjegjës material të katër mjeteve të cilat nuk gjenden:
- Z. F. Z., për mjetin tip "Ford Tranzit", për vlerën e mbetur 144,935 lekë;
- Z. B. B., për mjetin tip "Fadrom", për vlerën e mbetur 379,218 lekë;
- Z. A. H., për mjetin tip "Fadrom Fernec", për vlerën e mbetur 1,188,466 lekë, si dhe për mjetin tip "Land Rover L....8", për vlerën e mbetur 466,018 lekë.

Deri më datën 30.06.2020

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *"Rehabilitimi i kanalit ujitës "Rog-Zaberzan", Bashkia Skrapar,* me vlerë të kontratës 12,008,100 lekë pa TVSH, shpallur fitues OE "Z." SHPK, në disa zëra punimesh si "Prishje strukturë betoni", "FV tuba çeliku Ø > 200 mm, i hidroizoluar në fabrikë me t=4mm" dhe "Transport materiale me traktor dhe auto, rezultuan diferenca në volume pune të paguara, por të pakryera në fakt, në vlerën 1,107,550 lekë pa TVSH, e cila është dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe të njësisë vendore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1090 prot., datë 08.05.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Skrapar dhe OE "Z." SHPK *(Më hollësisht trajtuar në pikën D.2, faqe 80-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Skrapar të merren masa për arkëtimin e vlerës **1,107,550 lekë pa TVSH** nga OE "Z." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1090 prot., datë 08.05.2017, me objekt "Rehabilitimi i kanalit ujitës "Rog - Zaberzan", Bashkia Skrapar, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Deri më datën 30.06.2020

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *"Rikualifikimi i hapësirave përreth pallatit të Kulturës, rruga me trafik të kufizuar/pedonalja "Pasho Hysi", rruga automobilistike "Pasho Hysi", Bashkia Skrapar,* me vlerë të kontratës 220,586,757 lekë pa TVSH, shpallur fitues BOE "D.C." SHPK & "A. L. I." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të paguara, por të pakryera fakt, në vlerën 376,380 lekë pa TVSH, e cila është dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe të njësisë vendore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1451 prot., datë 11.07.2016, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Skrapar dhe BOE "D.C." SHPK & "A. L. I." SHPK" SHPK *(Më hollësisht trajtuar në pikën D.2, faqe 80-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandim: Nga Bashkia Skrapar të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **376,380 lekë pa TVSH** nga BOE "D.C." SHPK & "A. L. I." SHPK" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1451 prot datë 11.07.2016, me objekt "Rikualifikimi i hapësirave përreth pallatit të Kulturës, rruga me trafik të kufizuar/pedonalja "Pasho Hysi", rruga automobilistike "Pasho Hysi", Bashkia Skrapar, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Deri më datën 30.06.2020

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "*Rikonstruksion i kanalit ujitës Vendreshë(Dega e majtë dhe e djathtë), Bashkia Skrapar"*, me vlerë 29,195,883 lekë pa TVSH, shpallur fitues Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "F." SHPK & "Sh. 07" SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të disa zërave të punimeve të kryera në objekt, në vlerën **399,493 lekë pa TVSH,** e cila është dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe të njësisë vendore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2533 prot., datë 01.12.2016 të lidhur ndërmjet Autoritetit

Kontraktor Bashkia Skrapar dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik "F." & "Sh. 07" SHPK *(Më hollësisht trajtuar në pikën D.2, faqe 80-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandim: Nga Bashkia Skrapar, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **399,493 lekë pa TVSH** nga Bashkimi i përkohshëm i Operatorëve Ekonomik "F." SHPK& "Sh. 07" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2533 prot, datë 01.12.2016 me objekt "Rikonstruksioni i kanalit ujitës Vendreshë (dega e majtë dhe e djathtë)", Bashkia Skrapar, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Deri më datën 30.06.2020

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *"Rikonstruksion i rrugës "Alush Grepcka" Bashkia Skrapar"*, me vlerë 25,497,050 lekë pa TVSH, shpallur fitues Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "F." SHPK & "Sh. 07" SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të disa zërave të punimeve të kryera në objekt, në vlerën **276,688 lekë pa TVSH,** e cila është dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe të njësisë vendore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 646 prot., datë 16.03.2017 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Skrapar dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik "F." SHPK & "Sh. 07" SHPK *(Më hollësisht trajtuar në pikën D.2, faqe 80-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandim: Nga Bashkia Skrapar, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **276,688 lekë pa TVSH** nga Bashkimi i përkohshëm i Operatorëve Ekonomik "F." SHPK& "Sh. 07" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 646 prot, datë 16.03.2017 me objekt "Rikonstruksion i rrugës Alush Grepcka", Bashkia Skrapar, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Deri më datën 30.06.2020

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *"Rikonstruksion i zyrave të M.K.Z-së Bashkia Skrapar"*, me vlerë 4,001,630 lekë pa TVSH shpallur fitues Operatori Ekonomik "A." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera në objekt, në vlerën **197,543 lekë pa TVSH,** e cila është dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe të njësisë vendore.. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1224 prot, datë 22.05.2018 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Skrapar dhe Operatorit Ekonomik "A." SHPK *(Më hollësisht trajtuar në pikën D.2, faqe 80-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandim: Nga Bashkia Skrapar, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **197,543 lekë pa TVSH** nga Operatori Ekonomik "A." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1224 prot., datë 22.05.2018 me objekt "Rikonstruksion i zyrave të M.K.Z-së Bashkia Skrapar", Bashkia Skrapar, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Deri më datën 30.06.2020

7. Gjetje nga auditimi: Bazuar në kontratat e dhënies me qira të fondit pyjor e kullosor, lidhur midis Bashkisë Skrapar dhe subjekteve private, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi për ndërtimin e HEC-ve, për periudhën janar 2017 deri më 31.12.2019, u konstatua se nga Drejtoria Juridike dhe Ndërmarrja e Shërbimit Pyjor të Bashkisë Skrapar, nuk janë aplikuar saktë tarifat e përdorimit të fondit pyjor e kullosor. Nga rillogaritjet e kryera rezulton se në vlerat e kontratave janë llogaritur **712,605 lekë** detyrime më pak, e cila përbën **dëm ekonomik për buxhetin e njësisë vendore**, për katër subjekte private. Veprimet e mësipërme janë në

kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në VKM nr 391, datë 21.06.2006 "*Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave",* i ndryshuar, lidhja nr. 2 "*Tarifat dysheme për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjorë dhe kullosorë publik për ushtrimin e veprimtarive", pika 11- Për shtrirje tubacionesh dhe linjash në sipërfaqe, si dhe ndërtim kanalesh (uji, naftë, gazi, tensioni elektrik etj. (Më hollësisht trajtuar në pikën B.2, faqe 80-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandim: Nga Titullari i Njësisë Vendore, Drejtori Ekonomik dhe Juridik, të merren të gjitha masat e duhura ligjore, për arkëtimin e detyrimit prej **712,605 lekë**, nga subjektet e mëposhtme:

- Subjekti "H. V. E." SHPK për vlerën 170,810 leëk;
- Subjekti "K. M. E." SHPK për vlerën 288,600 lekë;
- Subjekti "D. E. G." SHPK për vlerën 228,360 lekë;
- Subjekti "N. E." SHPK për vlerën 25,835.

Deri më datën 30.06.2020

8. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e programimit dhe realizimit të të ardhurave, u konstatua se nga sektori i taksave dhe tarifave vendore nuk është aplikuar tarifa e pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit, për 19 subjekte të cilët janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit publik dhe kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Skrapar, duke u llogaritur një e ardhur e pa planifikuar në vlerën. Duke llogaritur kohëzgjatjen në muaj për aktivitetin e ushtruar nga subjektet, si dhe vlerat e tarivave të miratuar në paketën fiskale, këto mos planifikime kanë shkaktuar të ardhura të munguara të cilat llogariten në vlerën 282,246 lekë, për 19 subjekte, sipas listës të paraqitur në aneksin nr. 2/10 në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Kreut VII, neni 35, Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr. 1, datë 21.01.2016 "Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2016", i ndryshuar *(Më hollësisht trajtuar në pikën B.2, faqe 22-31të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandim: Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren të gjitha masat e duhura që në të ardhmen të llogariten tarifa vendore për subjektet që zhvillojnë aktivitet në teritorin e njësisë vendore, në përputhje me kohëzgjatjen e punimeve që ata kryejnë.

Deri më datën 30.06.2020

9.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: "*Blerje kamioni për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, Bashkia Skrapar*", me fond limit 1,250,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më 04.05.2017, kanë marrë pjesë dy operatorë ekonomik:"A. G." SHPK me vlerë të ofertës ekonomike 1,200,000 lekë dhe "Q. 0." SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 1,248,000 lekë. Nga KVO është skualifikuar OE "A. G." SHPK, i cili i plotëson kriteret e vendosura në DST (konstatuar dhe pranuar kjo edhe nga vetë KVO). Pasi KVO ka konstatuar se ky OE plotëson kriteret, ka argumentuar s'kualifikimin e tij, në përshkrimet e bëra në sistem në fazën e vlerësimit të ofertave dhe në dokumentin "Raporti përmbledhës", drejtuar Titullarit të Autoritetit Kontraktor, si vijon:*"KVO-ja pasi kontrolloj te gjithë dokumentacionin e prezantuar ne ofertën e këtij operatori (OE "A. G." SHPK) dhe qe rezultoi e rregullt, për te vazhduar më tej, në atë të vlerësimit të mjetit fizikisht mbi gjendjen e tij teknike , kërkoj që ky operator ekonomik të sillte mjetin pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, që komisioni i vlerësimit të ofertave të bënte vlerësimin përfundimtar, krahasuare me të dhënat e hedhura në sistem. Edhe pse këtij operatori i është kontaktuar dy here me telefon dhe i është bere kërkesë te portali kërkesat nga KVO, nuk kemi marre asnjë përgjigje për sjelljen e mjetit, pasi afati kohor i vlerësimit te ofertave skadonte ne dt. 10.05.2017".*

Pra KVO ka bërë s'kualifikimin e OE jo për arsye se nuk plotëson kriteret e vendosura në DST, por për arsye se nuk ka paraqitur mjetin fizikisht pranë KVO. Detyra e KVO është që të vlerësoj ofertat e paraqitura, duke i krahasuar të dhënat e këtyre ofertave me kriteret e vendosura ne dokumentet standarde të tenderit (DST). Gjatë këtij vlerësimi, bazuar në nenin 55 -*Kriteretepërcaktimittëofertësfituese*, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar "*Autoriteti Kontraktor nuk duhet të përdor asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit*". Kërkesa e KVO për paraqitjen e mjetit pranë saj për vlerësim, në fazën e vlerësimit të ofertave, është përdorim i një kriteri të pa ligjshëm, i cili nuk është parashikuar në DST të hartuara nga Autoritetit Kontraktor.
Përkundrazi, operatori fitues duhet të paraqiste mjetin pranë AK 30 ditë pas lidhjes së kontratës, pasi në specifikimet teknike (DST) është vendosur kriteri: "*Afati i lëvrimit 30 dite nga momenti i lidhjes se kontratës. Përpara dorëzimit te mallit nga operatori fitues, do te kryhet kontrolli i mjetit i cili duhet te jete ne përputhje me specifikimet teknike te cituara me lart".*
Kontrata lidhet pasi ka përfunduar vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit mbi bazën e dokumenteve të paraqitura nga operatorët ekonomik (jo mbi bazën e paraqitjes së mjetit).
Skualifikimi i OE "A. G." SHPK me vlerë të ofertës 1,200,000 lekë dhe që ka ofruar mundësinë e paraqitjes së mjetit pas vitit 1990, është e pa drejtë.
Nga auditimi i dokumentacionit të "Q. 0." SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 1,248,000 lekë, u konstatua jo vetëm që oferta e tij ka një vlerë më të lartë se ajo e OE të skualifikuar (**48,000 lekë, dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si diferencë midis dy ofertave**), por ky operatorë ekonomik në dokumentet e ngarkuar në sistemin elektronik të APP dhe konkretisht tek skedari "*Dokumenta dhe foto te kamionit A ...L",* mjeti i paraqitur sipas "*çertifikatës së pronësisë së mjetit*" dhe "*lejes së qarkullimit*", rezulton me vit prodhimi vitin 1977. Nga Autoriteti Kontraktor në DST nuk është kërkuar ky mjet, por mjet me vit prodhimi 1990 e mbrapa, por KVO e ka kualifikuar OE "Q. 0." SHPK dhe Titullari i AK e ka shpallur fitues. Konstatohet se nga na e KVO, pas verifikimit të dokumentacionit të OE "Q. 0." SHPK , nuk ka kërkuar prej tij paraqitjen e mjetin pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike për të bërë vlerësimit fizik nga KVO, ashtu si ka vepruar në rastin me OE "A. G." SHPK, duke vepruar kështu me dy standarde.
KVO duhet të kishte kualifikuar OE "A. G." SHPK dhe duhet të kishte skualifikuar OE "Q. 0." SHPK. Gjithashtu Titullari i Autoritetit Kontraktor, **në rrethana të njohjes së parregullsive** (nëpërmjet Raportin përmbledhës të hartuar nga KVO dhe të miratuar prej tij), nuk duhet të kishte miratuar "Raportin përmbledhës" dhe nuk duhet të kishte shpallur fitues OE "Q. 0." SHPK.
Me veprimet dhe mos veprimet e tyre, KVO dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor kanë vepruar në kundërshtim me:
- ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm: neni 1 "Objekti dhe qëllimi", pika d, neni 2, "Parimet e përzgjedhjes",neni 46 "Kualifikimi i ofertuesve", pika 1, nenin 53 "Shqyrtimi i ofertave", neni 55, "Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese";
- VKM nr.914, datë 29.12.2014, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, neni 56 -*Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar*;
- Ligjin nr.10296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 8. *(Më hollësisht trajtuar në pikën D.1, faqe 47-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1.Rekomandim: Nga Titullari i Njësisë Vendore të merren të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës **48,000 lekë,** nga tre anëtrët e KVO dhe ish Titullari i AK, në vlerën 12,000 lekë secili, si më poshtë:
- **Z. M. K.**, me detyrë ish Drejtor iNdërmarrjen e Shërbimeve Publike, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor;
- **Z. V. N.**, me detyrë përgjegjës finance;
- **Z. N. K.,** me detyrë teknik ndërtimi;
- **Z. A. M.**, me detyrë ish përgjegjës i sektorit të mirëmbajtjes së rrugëve rurale,ndërprerë marrëdhëniet e punës.

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËRDORIMIN E KËTYRE FONDEVE ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Skrapar për periudhën 2017-2019 ka pasur si detyrim për likuidimi 26 vendime gjyqësore të formës së prerë, në vlerën totale 16,255,329 lekë, nga të cilat16 vendime gjyqësore, në vlerën totale 4,999,784 lekë, me objekt "Dëmshpërblim për largim të padrejtë nga puna të punonjësve", që i përkasin periudhës 2011-2019, 10 vendime gjyqësore, me objekte të tjera të ndryshme, në vlerën totale11,255,545 lekë që i përkasin periudhës 2001-2006. Nga shuma totale e këtyre detyrimeve, për periudhën 2017-2019 është likuiduar vlera 6,567,908 lekë, nga e cila vlera 2,472,840 lekë, i përket vendimeve gjyqësore për "Dëmshpërblim për largim të padrejtë nga puna të punonjësve" dhe vlera 4,095,068 lekë i përket vendimeve gjyqësore me natyra të tjera të ndryshme.
Si rezultat i mos likuidimit në kohë të detyrimeve për energjinë elektrike nga Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike për periudhën dy vjeçare 2010-2011, për 17 kontrata të energjisë elektrike për ndriçimin rrugor, në datën 29.06.2018 midis Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike dhe OSHEE, është nënshkruar akt-marrëveshje për shlyerjen me këste të detyrimit të konstatuar në vlerën 12,942,139 lekë, me vlerë të këstit mujor 171,257 lekë, nga e cila principal 84,950 lekë dhe 86,308 lekë kamat-vonesë. Për periudhën 18 mujore (korrik 2018-dhjetor 2019), vlera e kamatëvonesës së paguar është 1,553,544 lekë, e cila është shpenzim i kryer jo për mall, punë apo shërbim, por për mos përmbushje në kohë të detyrimeve nga Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike. Si përfundim për periudhën 2017-2019 vlera e shpenzuar prej **8,121,452 lekë** (6,567,908 lekë për vendimet gjyqësore dhe 1,553,544 lekë kamatëvonesë për energjinë elektrike), **përbën efektet negative në buxhetin e njësisë vendore** Bashkia Skrapar, pasi këto fonde nuk janë shpenzuar për investime apo përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve *(Më hollësisht trajtuar në pikën B.1, faqe 18-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
1.1. Rekomandim: Titullar i njësisë vendore të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore, të nxjerr arsyet dhe përgjegjësitë për humbjen e tyre dhe efektin negativ që këto vendime kanë dhënë në buxhetin e njësisë vendore. Drejtoria juridik të ndjek proceset në të gjitha shkallët e gjykimit, duke bërë edhe rekurs. Në rastet e largimeve të punonjësve nga puna, nga sektori juridik dhe titullari të zbatohen të gjitha procedurat e nevojshme të afateve të njoftimit dhe të pagesave të duhura, me qëllim që të ulet risku i humbjes së proceseve gjyqësore. Përpara zbatimit të vendimit gjyqësor Titullari të nxjerr përgjegjësitë administrative, si dhe aktin që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi. Të vlerësohen të gjitha rrisqet që vijnë nga mos likuidimi në kohë i detyrimeve, me qëllim shmangien e pagesave shtesë nga kamatëvonesat apo edhe proceset gjyqësore që mund të hapin kreditorët.

Menjëherë dhe në vijimësi.

2. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: "*Blerje kamioni për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, Bashkia Skrapar*", me fond limit 1,250,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më 04.05.2017, kanë marrë pjesë dy operatorë ekonomik:"A. G." SHPK me vlerë të ofertës ekonomike 1,200,000 lekë dhe "Q. 0." SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 1,248,000 lekë. Nga KVO është s'kualifikuar padrejtësisht OE "A. G." SHPK, i cili i plotëson kriteret e vendosura në DST dhe është kualifikuar padrejtësisht OE "Q. 0." SHPK, i cili nuk i plotëson kriteret e DST (trajtuar më gjerësisht te rubrika e shpërblimit të dëmit).
Pas procesit të kualifikimit dhe shpalljes së fituesit, <u>në procesin e marrjes në dorëzim të mallit</u> janë konstatuar shkelje edhe nga komisioni i marrjes në dorëzim të mjetit dhe ish drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, si vijon:
Për marrjen në dorëzim të mallit (kamionit), nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. M. K., ka dalë urdhri nr. 13 datë 13.06.2017, "Për krijimin e komisionit për marrjen në dorëzim të objektit Blerje Kamioni", në përbërje të së cilit janë z. K. M. me detyrë mekanik, z. D. M. me detyrë drejtues mjeti dhe z. B. B. me detyrë manovrator, të tre punonjës të Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, njësi vartëse e Bashkisë Skrapar.
Në datën 14.06.2017 komisioni për marrjen në dorëzim, ka mbajtur proces verbalin mbi marrjen në dorëzim të mjetit tip Benz, Kamion 3 aks ngjyrë të kuqe.
Përpara marrjes në dorëzim të mallit, komisioni nuk ka kryer të gjitha verifikimet e nevojshme, nëse përputhen të dhënat e mjetit me specifikimet teknike të përcaktuara në DST dhe kërkesat e kontratës së furnizimit. Në specifikimet teknike është përcaktuar se mjeti duhet të jetë me vit prodhimit pas vitit 1990, ndërsa mjeti që është marrë në dorëzim prej komisionit sipas "*çertifikatës së pronësisë së mjetit*" dhe *lejes së qarkullimit*, është i vitit të prodhimit 1977.
Komisioni i marrjes në dorëzim, duhet të mos pranonte mallin (kamionin), pasi ai nuk përputhet me specifikimet teknike, pavarësisht klasifikimit si fitues që ka bërë KVO.
Komisioni i marrjes në dorëzim të mjetit ka vepruar në kundërshtim me:
- kërkesat e përcaktuara në rubrikën "Marrja ne dorëzim e aktiveve të furnizuara", të Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik";*
- kërkesat e përcaktuara në kontratën e furnizimit nr. 06, datë 12.06.2017, me objekt "Blerje kamioni", nënshkruar midis Kontraktuesit "Q. 0." dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Bashkia Skrapar, përfaqësuar dhe nënshkruar nga drejtori i kësaj ndërmarrje z. M. K.. Në këtë kontratë thuhet: *Neni 9. Përshtatshmëria e mallrave me standardet teknike:Mallrat e furnizuara sipas kontratës, duhet të jenë konformë kodeve dhe standardeve teknike, të parashikuara në specifikimet teknike.*
Neni 12, Pika 12.4: Autoriteti kontraktor do të refuzojë çdo mall i cili nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konformë specifikimeve teknike dhe kushteve të përcaktuara në zbatimin e kontratës
Në urdhrin nr. 13 datë 13.06.2017, "Për krijimin e komisionit për marrjen në dorëzim të objektit Blerje Kamioni" të Titullari i Autoritetit Kontraktor z. M. K., është përcaktuar se "*Marrja në dorëzim do të nënshkruhet nga Drejtori i Ndërmarrjes* (pra nga vetë z. M. K.), por një gjë e tillë nuk është bërë, pasi nuk është nënshkruar prej tij në procesverbal, duke mos zbatuar vetë urdhrin e nxjerrë prej tij dhe duke mos monitoruar punën e bërë nga komisioni, i cili ka marrë në dorëzim një mall jashtë specifikimeve të përcaktuara, i cili përsa i përket vitit të prodhimit, nuk përputhet me mjetin e kërkuar në tender.
Fondet e shpenzuara për blerjen e kamionit të vitit 1977, në vlerën **1,248,000 lekë, konsiderohen si fonde të përdorura pa ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet**, kjo edhe për faktin e kohës së amortizimit maksimal të mjetit, e cila është pasqyruar edhe në

shpenzimet e mirëmbajtjes së tij, të cilat për periudhën 2017-2019 kanë një vlerë prej 574,720 lekë.
Si përfundim, nga veprimet e mos veprimet e komisionit të vlerësimit të ofertave, Titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe komisionit të marrjes në dorëzim të mallit, Autoriteti Kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, **ka blerë një mjet i cili nuk ka qenë objekt i procedurës së prokurimit (tenderit të zhvilluar)**në datën 04.05.2017 me objekt "Blerje kamioni për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, Bashkia Skrapar", sepse kamioni i blerë është i vitit të prodhimit 1977, ndërsa qëllimi i zhvillimit të procedurës së prokurimit publik ka qenë blerja e një kamioni me viti prodhimi 1990 e mbrapa *(Më hollësisht trajtuar në pikën D.1, faqe 47-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Skrapar të analizojë situatën dhe shkaqet që kanë sjellë kualifikimin e një operatori ekonomik i cili dukshëm nuk plotëson kriteret e vendosura në DST dhe të marrë masa që të ndërpriten anomali të tilla. Përveç të tjerash, kjo të realizohet edhe me kryerjen e trajnimeve të stafit, i cili do të angazhohet në procedurat e prokurimit publik.
2.2. Rekomandim: Për arsye se fondi limit në vlerën 1,250,000 lekë pa TVSH nga AK është llogaritur për një mjet të vitit të prodhimit 1990 e mbrapa, por në fakt është marrë në dorëzim një mjet i vitit 1977, atëherë nga Kryetari i Bashkisë Skrapar të merren masa për rillogaritje të fondit limit të mjetit që është marrë në dorëzim (si referencë të merren çmimet që jepen nga organet tatimore, doganore, INSTAT, apo operatorë ekonomik të licencuar për tregtimin e mjeteve të transportit). Diferenca në lekë që do të rezultojë, ti bëhen ngarkim ish Titullarit të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, anëtarëve të KVO dhe të komisionit marrjes në dorëzim të mallit.

Deri më datën 31.07.2020

D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1.Gjetje nga auditimi: Nga puna e pa mjaftueshme e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Skrapar, në fund të vitit 2019 janë krijuar debitorë për taksat dhe tarifa vendore në vlerën totale **83,543,320 lekë**, e ardhur e munguar për buxhetin e njësisë vendore. Kjo vlerë përbëhet nga:
-detyrimi prej 67,619,642 lekë nga debitorët e subjekteve fizik/juridik dhe debitorët familjarë për taksat e tokës bujqësore dhe tarifat familjare, të bashkisë qyteti Çorovodë dhe tetë Njësitë Administrative.
-detyrimi prej 15,923,678 lekë nga debitorët e konstatuar nga kontrolle të ndryshme para datës 31.12.2016, të bashkisë qyteti Çorovodë dhe tetë Njësitë Administrative.
Nga auditimi konstatohet se njësia vendore nuk ka shifra të qarta dhe përfundimtare për debitorët nga taksat dhe tarifat vendore, pasi këto shifra kanë qënë kontradiktore në fazën e projektraportit dhe të raportit. Gjithashtu nuk administrohet nga njësia vendore një ndarje e qartë midis vlerës së debitorve të taksapaguesve privat dhe atyre familjar, gjë e cila bën që të mos pasqyrohet edhe në këtë gjetje.
Mos arkëtimi i plotë i detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, përveçse është mos përmbushje e detyrimeve ligjore, sipas detyrës funksionale të punonjësve të kësaj strukture, krijon mungesa financiare në buxhet dhe për pasojë ulë nivelin e investimeve dhe të shpenzimeve të tjera që njësia vendore ka parashikuar në favor të komunitetit. Mungesa e të ardhurave është ndikim i drejtëpërdrejtë në mosrealizimin e buxhetit në zërin e shpenzimeve për periudhën 2017-2019.

Nga Bashkia Skrapar nuk janë ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme ligjore, në rend shterues, për arkëtimin e debitorëve, veprim në kundërshtim me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", nenet 91, të ligjit nr. 9920 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe nenin 12 të Udhëzimit te Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore*(Më hollësisht trajtuar në pikën B.2, faqe 22-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Drejtoria ekonomike, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Skrapar, bazuar në nenin 70 pika 3 "E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, *për të gjitha subjektet e private* të nxjerrë njoftim vlerësimet tatimore dhe në vazhdim të marren masat për arkëtimin e këtij detyrimi, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a-Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore RSH".

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH".

c- Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të aplikohet llogaritja e gjobës në masën 0.06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo dit gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më shumë se 365 ditë (gjobë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat tatimore në RSH", të ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 15.12.2014**.**

d- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të **bëhet kallëzim penal**, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 "Mospagimi i taksave dhe tatimeve".

e- Për debitorët familjar, në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 01, datë 17.01.2019 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019", pika 98, të njoftojë nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës, të ndërtesave dhe tarifat familjare dhe të realizojë arkëtimin e detyrimit. Gjithashtu, për këtë kategori taksapaguesish, Kryetari i Bashkisë të analizojë nëse alternativa e mbledhjes së taksës dhe tarifës për kategorinë familjare nga shoqëria "Ujësjellës" ShA, është më efiçente se praktika e deritanishme e mbledhjes nga vetë njësia vendore.

Nga totali i mësipërm i debitorve, Bashkia Skrapar të saktësojë vlerën e debitove për të taksapaguesve privat dhe atyre familjar.

Deri më datën 31.07.2020

2. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e programimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksimi i subjekteve të ndërtimit që operojnë në fushën e përpunimit të gurit dhe mermerit, referuar dokumentacionit të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Skrapar, për periudhën e viteve 2017-2019, konstatohet se nuk është aplikuar taksa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, tarifa e gjelbërimit dhe tarifa e ndriçimit, për 10 subjekte, sipas aneksit 2/12 në Raportin Përfundimtar të auditimit, **në vlerën 1,610,000 lekë**, **e ardhur e paplanifikuar dhe munguar në buxhetin e njësisë vendore,** veprime në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.4.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar neni 4 dhe 35, Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 1, datë 21.01.2016 "Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2016", i

ndryshuar, të Bashkisë Skrapar *(Më hollësisht trajtuar në pikën B.2, faqe 22-31të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandim: Nga titullari i njësisë vendore, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren të gjitha masat e duhura ligjore, duke përfshirë edhe hapjen e proceseve gjyqësore, për arkëtimin e detyrimit në vlerën prej **1,610,000 lekë,** sipas listës për 10 subjekte të paraqitur në aneksi nr. 2/12 në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Deri më datën 30.06.2020

3. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave nga dhënia me qira e fondit pyjor, u konstatua se në territorin e Bashkisë Skrapar për periudhën 01.01.2017-31.12.2019kanë ushtruar aktivitet 17 subjekte private për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore për nxjerrje guri pllakë, gurë gëlqerorë, gëlqeror mermer dhe gëlqerorë masiv, sipas lejeve minerare të miratuara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Nga Bashkia Skrapar, Ndërmarrja e Shërbimit Pyjor, nuk janë marrë masa për të lidhur kontratë qiraje me këto subjektet private për sipërfaqen totale prej 958.43 ha, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e njësisë vendore në vlerën **889,715,200 lekë,** sipasaneksit nr. 2/11 të paraqitur në Raportin Përfundimtar të Auditimit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr 391, datë 21.06.2006, "*Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave*", i ndryshuar, lidhja nr. 2, pikat 6/1 *(Më hollësisht trajtuar në pikën B.2, faqe 22-31të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Titullari i Njësisë Vendore, Drejtoria Juridike dhe Ndërmarrja e Shërbimit Pyjor, të marrin të gjitha masat e nevojshme ligjore, deri në hapjen e proceseve gjyqësore, për lidhjen e kontratës së qirasë dhe arkëtimin e detyrimit prej 889,715,200 lekë, nga 17 subjektet private, sipas listës në aneksin nr. 2/11 të paraqitur në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.6.2020

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

VII. ANEKSET

Aneksi nr.1. Pika B.1. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit.

Miratimet fillestare të buxhetit për vitin 2017, 2018, 2019, trajtuar nga faqja 15 deri në faqen 19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Buxheti fillestar për vitin 2017. Në lekë

Planifikimi i të ardhurave viti 2017		Planifikimi i shpenzimeve viti 2017	
Burimi i të ardhurave	Vlera	Emërtimi i zërave	Vlera
Të ardhura të planifikuara për vitin 2017	115,000,000	Paga gjithsej	166,069,975
Grant me natyrë të përgjithshme	134,980,000	Sigurime shoqerore	27,780,022
Grant për funksione të reja	87,945,000	Fond per ekzekutim vendime gjyqesore	5,000,000
Total grant + të ardhura	337,925,000	Shpenzime operative & Fonde Shpronesimi	75,561,252
		Fondi Rezerve	2,000,000
		Fondi Kontigjence&Emergjence	3,000,000
		Fonde per familje ne nevoje	450,000
		Fond per Keshillin e Qarkut	700,000
		Investime	57,363,751
		Totali i shpenzimeve	337,925,000

Buxheti fillestar për vitin 2018

Planifikimi i të ardhurave viti 2018		Planifikimi i shpenzimeve viti 2018	
Burimi i të ardhurave	Vlera	Emërtimi i zërave	Vlera
Te ardhura te planifikuara per vitin 2018	100,000,000	Paga gjithsej	169,254,029
Transferta e pakushtezuar	116,888,000	Sigurime shoqerore	28,298,305
Transfert e pakushtezuar trasheguar nga viti 2017	8,472,103	Fond per vendimet gjyqesore	4,000,000
Transferta Specifike e akorduar per vitin 2018	99,711,000	Shpenzime operative&Fonde Shpronesimi	64,548,329
Transfert Specifike e Trasheguar nga viti 2017	2,519,851	Fondi Rezerve	2,000,000
Total grant + të ardhura	327,590,954	Fondi Kontigjence	6,400,000
		Fonde per familje ne nevoje	169,344
		Fondi Veçantë	1,138,000
		Kontribut per Kshillin e Qarkut	450,000
		Investime	51,332,947
		Totali i shpenzimeve	327,590,954

Burimi: Bashkia Skrapar

Buxheti fillestar për vitin 2018

Planifikimi i të ardhurave viti 2019		Planifikimi i shpenzimeve viti 2018	
Burimi i të ardhurave	Vlera	Plani shpenzimeve per paga	186,301,411
Te ardhura vendore te planifikuara per vitin 2019	107,577,000	Plani shpenzimeve per sigurime	31,112,344
Transfert e pakushtezuar akorduar per vitin 2019	119,903,000	Plani shpenzimeve per investime	53,829,636
Transfert specifike e akorduar per vitin 2019	99,619,000	Plani shpenzimeve operative	59,340,609
Transfert e pakushtezuar dhe specifike, trasheguar nga 201 8	5,000,000	Fondi rezerv dhe kontigjences	8,150,000
Totali te ardhura buxhetore per vitin 2019 funksionet e veta	332,099,000	Totali shpenzimeve gjithsej per 2019	338,734,000
Fonde nga buxheti shtetit per funksionet e deleguara gjendje civile dhe gkb	6,635,000		
Tatal te ardhura buxhetore nga funksione te deleguara	6,635,000		
Total grant + të ardhura	338,734,000		

Burimi: Bashkia Skrapar

Aneksi nr.1/1. Pika B.1. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit.Buxheti perfundimtar Plan-Fakt Bashkia +2 Ndërmarrjet e varësisë sipas viteve për periudhën 2017-2019, trajtuar nga faqja 15 deri në faqen 19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

	Buxheti perfundimtar Plan-Fakt Bashkia +2 Ndërmarrjet e varësisë. Viti 2017			
Nr.	**Pershkrimi Shpenzimeve**	**Plani 2017**	**Fakti 2017**	**Realizimi ne %**
	Bashkia pa njësitë vartëse			
1	Artikulli-600 Paga	133,967,712	131,226,523	98.0%
2	Artikulli-601 Sig.Shoqerore	23,014,073	22,044,802	95.8%
3	Artikulli-602 Shpenzime Operative	49,230,636	35,286,874	71.7%
4	Artikulli 230-Projekte	16,500,000	10,500,000	63.6%
5	Artikulli 231 Investime	325,893,647	300,108,444	92.1%
6	Artikulli 604 -Transferta institucioneve	3,707,252	6,332	0.2%
7	Artikulli 604-Emergjencat civile	3,273,280	3,273,280	100.0%
8	Artikulli 606-Ndihme dhe PAK	110,204,199	110,201,777	100.0%
9	Artikull 606-Transferta te tjera	1,664,920	1,590,000	95.5%
10	Artikulli 606-Shperblime lindje	595,000	595,000	100.0%
11	Artikulli 600-Shpenzime per Zgjedhjet	1,532,000	1,498,000	97.8%
12	Artikulli 602-Shpenzime per Zgjedhjet	180,000	165,000	91.7%
	Total Bashkia pa njësitë vartëse	**669,582,719**	**616,496,032**	**92%**
	Ndërmarrja e shërbimeve publike			
1	600 Shpenzime paga	40,802,790	40,609,875	100
2	601 Shpenzime sigurime shoq	6,996,300	6,780,824	97
3	602 Shpenzime operative	28,864,994	21,530,410	75
4	230+231 Investime	15,368,394	14,609,074	95
	Total Ndërmarrja e shërbimeve publike	**92,032,478**	**83,530,183**	**91**
	Ndërmarrja e shërbimit pyjor			
1	600Shpenzime paga	10,891,214	9,848,731	90
2	601 Shpenzime sigurime shoq	1,881,228	1,646,439	88
3	602 Shpenzime operative	2,393,650	1,062,820	44
4	230+231 Investime	540,000	510,600	95
	Total Ndërmarrja e shërbimit pyjor	**15,706,092**	**13,068,590**	**83**
	Total Bashkia +2 Ndërmarrjet e varësisë	**777,321,289**	**713,094,805**	**92**

Burimi: *Burimi: Bashkia Skrapar*

Në lekë

	Buxheti perfundimtar Plan-Fakt Bashkia +2 Ndërmarrjet e varësisë. Viti 2018			
Nr.	**Pershkrimi Shpenzimeve**	**Plani 2018**	**Fakti 2018**	**Realizimi në %**
	Bashkia pa njësitë vartëse			

1	Artikulli-600 Paga	136,041,345	132,566,376	97%
2	Artikulli-601 Sig.Shoqerore	22,663,197	22,265,483	98%
3	Artikulli-602 Shpenzime Operative	48,732,906	33,392,535	68%
4	Artikulli 230-Projekte	14,090,745	14,034,060	100%
5	Artikulli 231 Investime	68,827,497	62,204,868	90%
6	Artikulli 604 -Transferta institucioneve	169,568	5,320	3%
7	Artikulli 604-Emergjencat civile	0	0	0%
8	Artikulli 606-Ndihme dhe PAK	119,835,000	119,832,404	100%
9	Artikull 606-Transferta te tjera	1,341,252	889,988	66%
10	Artikulli 606-Shperblime lindje	160,000	160,000	100%
	Total Bashkia pa njësitë vartëse	**411,861,510**	**385,351,034**	**94%**
	Ndërmarrja e shërbimeve publike			
1	600 Shpenzime paga	40,468,020	40,260,481	99
2	601 Shpenzime sigurime shoq	6,765,829	6,723,365	99
3	602 Shpenzime operative	34,455,551	22,184,541	64
4	230+231 Investime	3,010,178	2,807,120	93
5	**Total Ndërmarrja e shërbimeve publike**	**84,699,578**	**71,975,507**	**85**
	Ndërmarrja e shërbimit pyjor			
1	600 Shpenzime paga	12,788,718	11,034,388	86
2	601 Shpenzime sigurime shoq	1,818,636	1,684,235	93
3	602 Shpenzime operative	2,238,180	1,733,646	77
4	230+231 Investime	390,200	389,400	100
5	604+606+609 Transefrta	63,000	57,200	91
	Total Ndërmarrja e shërbimit pyjor	**17,298,734**	**14,898,869**	**86**
	Total Bashkia +2 Ndërmarrjet e varësisë	**513,859,822**	**472,225,410**	**92**

Burimi: *Burimi: Bashkia Skrapar*

Në lekë

Buxheti perfundimtar Plan-Fakt Bashkia +2 Ndërmarrjet e varësisë. Viti 2019				
Nr.	**Pershkrimi Shpenzimeve**	**Plani 2019**	**Fakti 2019**	**Realizimi ne %**
	Bashkia pa njësitë vartëse			
1	Artikulli-600 Paga	151,299,133	133,479,710	88%
2	Artikulli-601 Sig.Shoqerore	23,213,906	22,206,548	96%
3	Artikulli-602 Shpenzime Operative	36,839,776	31,107,339	84%
4	Artikulli 230-Projekte	27,173,221	27,173,221	100%
5	Artikulli 231 Investime	83,982,337	52,496,862	62%
6	Artikulli 604 -Transferta institucioneve	112,293	13,238	12%
7	Artikulli 604-Emergjencat civile	0	0	0%
8	Artikulli 606-Ndihme dhe PAK	110,594,000	110,415,797	99%
9	Artikull 606-Transferta te tjera	1,759,572	190,100	11%
10	Artikulli 606-Shperblime lindje	0	0	0%

11	Artikulli 600-Shpenzime per Zgjedhjet	945,400	874,500	93%
12	Artikulli 602-Shpenzime per Zgjedhjet	183,000	183,000	100%
	Total Bashkia pa njësitë vartëse	**436,102,638**	**378,140,315**	**87**
	Ndërmarrja e shërbimeve publike			
	600 Shpenzime paga	45,062,553	40,751,381	90.43292
	601 Shpenzime sigurime shoq	6,826,529	6,806,751	99.71028
	602 Shpenzime operative	25,591,687	17,917,484	70.01291
	604+606+609 Transefrta	87,313	87,313	100
	Total Ndërmarrja e shërbimeve publike	**77,568,082**	**65,562,929**	**85**
	Ndërmarrja e shërbimit pyjor			
	600 Shpenzime paga	11,687,813	9,786,239	84
	601 Shpenzime sigurime shoq	1,861,012	1,634,339	88
	602 Shpenzime operative	2,444,966	789,659	32
	604+606+609 Transefrta	97,750	97,750	100
	Total Ndërmarrja e shërbimit pyjor	**16,091,541**	**12,307,987**	**76**
	Total Bashkia +2 Ndërmarrjet e varësisë	**529,762,261**	**456,011,231**	**86**

Burimi: Bashkia Skrapar

Aneksi nr.1/2. Pika B.1. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit.
Pagesat e kryera për zbatimin e vendimeve gjyqësore për largimet e pa drejta nga puna për periudhën 2017-2019, trajtuar nga faqja 15 deri në faqen 19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nr	Emer mbiemer i paditësit	Pozicioni i punës së paditësit	Objekti padisë	Nr. dhe data vendimit të Gj. Apelit	Vlera në lekë e dëmshpërblimit, sipas vendimit te Gjykates së Apelit	Pagesa e kryer gjatë vitit 2017	Pagesa e kryer gjatë vitit 2018	Pagesa e kryer gjatë vitit 2019	Detyrimi i ngelur në 31.12.2019 për tu zbatuar në vitin 2020 e në vazhdim
1	G. Y.	Drejtor i Nd.Sh.Publike	Largim nga puna	Vendim Nr.196. dt.29.09.2009	349,138	49,138			
2	I. I.	Punonjes Bibloteke	Largim nga puna	Vendim nr.1361,date 25.11.2011	516,500	100,000	55,000	25,000	96,500
3	M. C.		Largim nga puna	Vendim nr.	438,900	100,000	55,000	25,000	18,900
4	K. K.	Llogaritar i mesem	Largim nga puna	Vendim nr.1257,date 10,11,20011	545,600	95,600	-		-
5	D. D.	Arketare	Largim nga puna	Vendim nr.1257,date 10,11,20011	843,200	100,000	55,000	25,000	423,200
6	F. Ç.	Finacjere	Largim nga puna	Vendim nr.1257,date 10,11,20011	570,400	100,000	55,000	25,000	150,400
7	L. Q.	Protokoll Arkive	Largim nga puna	Vendim nr.381.dt.12.0	639,040	100,000	55,000	25,000	229,040

				3.2012					
8	T. P.			Vendim nr.1257,date 10,11,20011	118,142	-	-		118,142
9	Zh. D.	Sanitare ne konvikt	Largim nga puna	Vendim nr.588,date 17.04.2012	267,310	107,310	-		-
10	D. Ç.	Punonjes i Komunes Çepan	Largim nga puna	Vendim nr.43,dt.27.11. 2007	211,432	36,432	-		
11	B. H.	Punonjes kadastre ish Komuna Qender	Largim nga puna	Vendim nr.1151 dt.19.02.2012	469,134	-	50,000		419,134
12	A. K.	Veteriner bashkia Çorovode	Largim nga puna	Vendim nr.1511,date 01.06.2016	481,406	200,000	75,000	50,000	26,406
13	F. Q.	Magazinier e ne konvikt	Largim nga puna	Vendim nr.2610,dt.15. 09.2016	309,360		309,360		-
14	Xh. H.	Punonjese Nd.Ekono mike	Largim nga puna	Vendim nr.4499,dt.01. 11.2017	1,134,922		300,000	200,000	634,922
15	Y. G.	Puntor Mirmbajtes varrezash	Largim nga puna	Vendim nr.1399,dt.06. 05.2019	483,300			100,000	383,300
16	T. P.	F. Q.		Vendim nr.2610,dt.15. 09.2016	27,000	-	-		27,000
					7,404,784	**988,480**	**1,009,360**	**475,000**	**2,526,944**

Burimi Bashkia Skrapar

Aneksi 1/3. Pika B.1. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit. Vendimet e tjera gjyqësore me objekte të tjera të ndryshme si kompensim shpronësimi per interesa publike etj., trajtuar nga faqja 15 deri në faqen 19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nr	Emer mbiemer i paditësit	Objekti padisë	Nr. dhe data vendimit të Gj. Apelit	Vlera në lekë e dëmshpërblimit, sipas vendimit te Gjykates së Apelit	Pagesa e kryer gjatë vitit 2017	Pagesa e kryer gjatë vitit 2018	Pagesa e kryer gjatë vitit 2019	Detyrimi i ngelur në 31.12.2019 për tu zbatuar në vitin 2020 e në vazhdim
1	L. K.	Kompesim shpronesimi per interesa publike	Vendim nr.323,date 01.11.2001	1,090,000	80,000	100,000	50,000	250,000
2	G. K.	Kompesim shpronesimi per interesa publike	Vendim nr.323,date 01.11.2001	544,920		100,000		334,920
3	V. K.	Kompesim shpronesimi per interesa publike	Vendim nr.323,date 01.11.2001	545,080				-
4	F. K.	Kompesim shpronesimi per interesa publike	Vendim nr.323,date 01.11.2001	1,090,000		160,000	101,668	828,332
5	F. K.	Kompesim shpronesimi per interesa publike	Vendim nr.323,date 01.11.2001	1,090,000		100,000		990,000
6	Firma S.	Investim I pa financuar nga ish komuna Qender	Vendim nr.242,date 13.10.2003	1,903,680	-	-		1,903,680
7	F. H.	Kompesim-Mbartur	Vendim	525,000	-	130,000	150,000	205,000

		nga ish komuna Çepan	nr.596,date 07.06.2011					
8	N. N.	Kompesim-Mbartur nga ish komuna Çepan	Vendim nr.1357date 25.11.2010	227,562				227,562
9	D. SHPK	Detyrim per diference financimi Investimi nga ish komuna Vendreshe	Vendim nr.179,date 14.06.2006	1,137,854		250,000	100,000	787,854
10	T. G.	Tarif permbarimore	Vendim nr.179,date 14.06.2006	198,049				198,049
11	Q. H.	Kompesim Mbartur nga ish Komuna Çepan	Vendim nr.330,dt.18.11.2005	2,903,400	2,773,400	-		-
Shuma totale				**11,255,545**	**2,853,400**	**840,000**	**401,668**	**5,725,397**
Shuma totale e të gjitha vendimeve gjyqësore				**18,660,329**	**3,841,880**	**1,849,360**	**876,668**	**8,252,341**

Burimi Bashkia Skrapar

Aneksi 1/4. Pika B.1. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit
Tabela e detyrimeve të prapambetura në 31.12.2019 Bashkia Skrapar, trajtuar nga faqja 15 deri në faqen 19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në lekë

Entitet	*Min*	*Instit*	*Kap*	*EMERTIMI DETYRIMIT*	*Artikull*	*Gjendje DEBIE 31.12.2018*	*DEBI VITI 2019*	*KREDI VITI 2019*	*Gjendje 31.12.2019*
139	00	2139001	00	Vendime Gjyqesore	***4864100***	**8,119,041**	**783,300**	**650,000**	**8,252,341**
139	00	2139001	00	Sherbime	***4864200***	**363,211**	**388,537**	**280,292**	**471,456**
139	00	2139001	00	Mirmbajtje	***4864300***	**3,101,455**	**1,375,934**	**1,637,821**	**2,839,568**
139	00	2139001	00	Investime	***4864400***	**49,617,401**	**30,280,377**	**71,892,678**	**8,005,100**
139	00	2139001	00	Te tjera	***4864900***	**6,004,932**	**6,943,116**	**4,424,361**	**8,523,687**
				TOTALI	***486***	**67,206,040**	**39,771,264**	**78,885,152**	**28,092,152**
					467	**67,206,040**	**78,885,152**	**39,771,264**	**28,092,152**

Burimi Bashkia Skrapar

Pasqyra e Levizjes së Detyrimeve(VENDIMET GJYQESORE) VITI 2019PASQYRA PERFUNDIMTARE

Entitet	*Min*	*Instit*	*Kap*		*Artikull*		*Debi 31.12.2018*	*DEBI*	*KREDI*	*Gjendje 31.12.2019*	Objekti
139	00	2139001	00	00000	*4864100*	00000	300,000		50,000	250,000	*V.Gjyqi nr.323,dt.01.11.2001(L.K)*
139	00	2139001	00	00000	*4864100*	00000	334,920			334,920	*V.Gjyqi nr.323,dt.01.11.2001(G.P)*
139	00	2139001	00	00000	*4864100*	00000	283,334			283,334	*V.Gjyqi nr.323,dt.01.11.2001(K&G)*
139	00	2139001	00	00000	*4864100*	00000	181,666			181,666	*V.Gjyqi nr.323,dt.01.11.2001(S.K)*
139	00	2139001	00	00000	*4864100*	00000	181,666			181,666	*V.Gjyqi nr.323,dt.01.11.2001(SH.K)*
139	00	2139001	00	00000	*4864100*	00000	181,666			181,666	*V.Gjyqi nr.323,dt.01.11.2001(F.K)*
139	00	2139001	00	00000	*4864100*	00000	445,000			445,000	*V.Gjyqi nr.323,dt.01.11.2001(H.K)*
139	00	2139001	00	00000	*4864100*	00000	272,500			272,500	*V.Gjyqi nr.323,dt.01.11.2001(I.K)*
139	00	2139001	00	00000	*4864100*	00000	272,500			272,500	*V.Gjyqi nr.323,dt.01.11.2001 (D.K)*
139	00	2139001	00	00000	*4864100*	00000	96,500			96,500	*V.Gjyqi nr.1361,dt.25.11.2011(I.I)*
139	00	2139001	00	00000	*4864100*	00000	18,900			18,900	*V.Gjyqi nr.57,dt.24.01.2012(M.C)*
139	00	2139001	00	00000	*4864100*	00000	423,200			423,200	*V.Gjyqi nr.1257,dt.10.11.2011(D.D)*
139	00	2139001	00	00000	*4864100*	00000	150,400			150,400	*V.Gjyqi nr.1257,dt.10.11.2011(F.C)*
139	00	2139001	00	00000	*4864100*	00000	229,040			229,040	*V.Gjyqi nr.381,dt.12.03.2012(L.Q)*
139	00	2139001	00	00000	*4864100*	00000	118,142			118,142	*V.Gjyqi nr.1257,dt.25.11.2011(Z.P)*
139	00	2139001	00	00000	*4864100*	00000	1,903,680			1,903,680	*V.Gjyqi nr.242,dt.13.10.2003 (SH.S)*
139	00	2139001	00	00000	*4864100*	00000	419,134			419,134	*V.Gjyqi nr.1151,dt.10.09.2012(B.H)*
